



PUNIM I POLITIKAVE

Nr. 3/14 – Shtator 2014

Kosova në kontekstin e sigurisë dhe të mbrojtjes të Ballkanit Perëndimor

Ky projekt është përkrahur nga Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme



**NORWEGIAN MINISTRY
OF FOREIGN AFFAIRS**

Përmbajtja dhe pikëpamjet të shprehura në këtë botim janë të KIPRED-it, dhe nuk mund të merren si pikëpamje të donatorit.

Përgatitur nga: Lulzim Peci

Asistentë hulumtues: Gent Gjikolli, Blerim Murtezi dhe Jeanne-Alpais de Saint-Phalle

Përkthimi: Mentor Agani

Copyright © 2014, KIPRED. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk bën të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem rikthyes, apo të bartet, në çfarëdo qoftë forme dhe me çfarëdo qoftë pajisjesh, elektronike, mekanike, fotokopjuese, regjistruese, apo të tjera, pa lejen paraprake me shkrim nga botuesi. Luteni të kontaktoni: info@kipred.org apo: +381 38 227 778.

Botuar nga:



Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave

Rr. Rexhep Mala, Nr. 5A

10 000 Prishtinë, Kosovë

Telefoni dhe faksi: +381 38 227 778

www.kipred.org

Përmbajtja:

Përmbledhje ekzekutive	4
Rekomandime	6
Hyrje	8
1. Politikat e sigurisë kombëtare	9
1.1. Hyrje	9
1.2. Analizë e kërcënimeve të sigurisë	10
1.3. Interesat kombëtare dhe analiza e qëllimeve të sigurisë	18
2. Politikat e mbrojtjes dhe aftësitë ushtarake	27
2.1. Hyrje	27
2.2. Qëllimet e mbrojtjes dhe misionet e forcave të armatosura	28
2.3. Aftësitë ushtarake dhe buxhetet e mbrojtjes	35
2.4. Industritë e mbrojtjes dhe eksportet dhe importet ushtarake.....	40
2.5. Bazat ushtarake	45
3. Ndikimi i përfshirjes ushtarake të NATO-s dhe instrumentet integruese të sigurisë rajonale	49
3.1. Hyrje	49
3.2. Përfshirja ushtarake e NATO-s	51
3.3. Instrumentet bashkëpunuese dhe integruese të NATO-s në vendet e Ballkanit Perëndimor.....	53
4. Dilemat e sigurisë dhe sfidat e mbrojtjes të Kosovës	63
4.1. Hyrje	63
4.2. Dilema serbe e sigurisë e Kosovës	64
4.3. Rruga përpara marrëdhënieve mbrojtëse Kosovë–Serbi: Nga “Sulmi doktrinar” në bashkëpunimin mbrojtës	68
4.4. Çfarë tjetër: Ndërtimi i bashkëpunimit zyrtar të NATO-s me Kosovën	71
5. Përfundimet	74
6. Rekomandime	77
Aneksi 1	79
Burimet bibliografike të Tabelave	79
Bibliografia	89

Përmbledhje ekzekutive

Vendet e Ballkanit Perëndimor¹ kanë arritur një përparim të madh në reformimin e politikave të tyre të sigurisë dhe të mbrojtjes në pajtim me kërkesat e anëtarimit në NATO dhe në Programin e Partneritetit për Paqe. Megjithatë, duke u bazuar në dokumentet e sigurisë dhe të mbrojtjes kombëtare të këtyre vendeve, janë disa rreziqe kyçe që mund ta destabilizojnë rajonin dhe ta shkaktojnë rishfaqjen e konflikteve të armatosura, përfshirë këtu edhe reagimet konvencionale. Në mesin e tyre më kryesoret janë kërcënimet e natyrës politike – nacionaliste/etnike dhe fetare, ato të shtetformimit, si dhe të kufijve të kontestuar/të papërcaktuar. Në thelb, edhe përkundrejt përkushtimit formal të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor për marrëdhënie të mira fqinjësore dhe për të dhënë kontribut për stabilitetin dhe sigurinë rajonale, brenda tyre ende mbizotëron një nivel i caktuar i dukshëm i ankthit, në saje të një mungese të qartë të besimit lidhur me sjelljet e ardhshme të disa prej shteteve të tjera të rajonit.

Nga këndvështrimi i aftësive ushtarake, dhe të shpenzimeve e industrive mbrojtëse, Serbia dhe Kroacia janë dy vendet mbizotëruese në rajon. Aftësitë ushtarake të vendeve të tjera të rajonit janë marxhinale kur të krahasohen me ato të këtyre dyjave. Po ashtu, krijimi i mundshëm i Forcave të Armatosura të Kosovës nuk do ta ketë ndonjë ndikim domethënës në ndryshimin e balancit rajonal të fuqisë.

Përfshirja e NATO-s në Ballkan i ka patur katër rezultate kryesore. Së pari, përfshirja e saj ushtarake, si një forcë prapësuese dhe stabilizuese, i ka dekurajuar konfliktet e armatosura dhe e ka transformuar Ballkanin Perëndimor nga një rajon të shoqërive të dërrmuara nga lufta dhe me marrëdhënie fqinjësore armiqësore, në një që është relativisht stabil. Së dyti, NATO ushtroi një ndikim vendimtar në ndryshimin e strukturave të balancimit të fortë dhe të doktrinave të ushtrive masive që bazoheshin në mbrojtjen territoriale dhe në prapësim; kështu, forcat e armatosura kombëtare u shndërruan në ushtri profesionale, dhe aftësitë e tyre ofensive kundër fqinjëve u zvogëluan në një mënyrë domethënëse. Së treti, zgjerimi i NATO-s në Ballkanin Perëndimor e pati një rol thelbësor në përmbylljen përfundimtare të kufijve shtetërorë të vendeve individuale të rajonit. Së katërti, Partneriteti për Paqe i shoi të gjitha shpresat për ndonjë bashkëpunim kundërbalancues bilateral apo rajonal në fushën e mbrojtjes, duke e shndërruar bashkëpunimin ekskluzivisht përmes Brukselit në një çmim që duhet paguar për anëtarësim.

¹ Vendet e Ballkanit Perëndimor: Bosnja e Hercegovina, Kosova, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia dhe Shqipëria.

Një faktor ngatërrues për sigurinë rajonale, dhe, po ashtu, një çështje tejet brengosëse, është bashkëpunimi mbrojtës i Serbisë me Rusinë, që i përfshin tre komponente: Themelimin e Qendrës së Përbashkët Serbo-Ruse për Reagim ndaj Situatave të Emergjencës, që është e para e këtij lloji që Rusia e ka hapur në Evropë pas Luftës së Ftohtë; Manovrat e përbashkëta ushtarake, ku të parat janë të planifikuara të mbahen këtë vjeshtë; dhe Statusi i Serbisë i Vëzhguesit në Asamblenë Parlamentare të Aleancës Ushtarake Ndërqeveritare të udhëhequr nga Rusia – Organizata e Traktatit të Sigurisë Kolektive.

Duke e shfrytëzuar Serbinë si strehë për interesat dhe synimet e veta kundër Perëndimit, Rusia është duke e shtrirë sërish ndikimin e saj në Ballkanin Perëndimor, dhe këtë është duke e bërë përmes shfrytëzimit të marrëdhënieve të trazuara etno-nacionale të rajonit dhe të dobësive të shteteve që nuk janë anëtare të Unionit Evropian dhe të NATO-s, domethënë, të Bosnjes e Hercegovinës, Kosovës dhe të Maqedonisë. Rusia do ta ketë një tokë të plleshme për përmbushjen e synimeve të veta për aq kohë sa do të vazhdojë mbizotërimi i pavendosmërisë së Brukselit dhe mungesa e një udhëheqjeje të fuqishme të SHBA-ve lidhur me zgjerimin e mëtutjeshëm të NATO-s dhe të UE-së.

Kosova përballet me një mjedis të sigurisë dhe të mbrojtjes që është i favorshëm, por, po ashtu, edhe kompleks. Fqinjët e saj të drejtpërdrejtë, Shqipëria dhe Maqedonia, përjashtojnë çfarëdo kërcënimi të drejtpërdrejtë që do të mund të vinte nga Kosova, ndërkohë që Mali i Zi atë e sheh si një rrëfim të papërfunduar nga aspekti i stabilitetit dhe sigurisë rajonale; ndërkaq, Serbia, në të njëjtën kohë kur me Kosovën e ka synimin e përbashkët të anëtarësimit në Unionin Evropian, atë e projekton si një kërcënim të drejtpërdrejtë konvencional dhe një entitet belaxhi, në vend se si një fqinj me të cilin ende nuk i ka zgjidhur marrëdhëniet.

Ka shumë gjasë që Serbia tashmë ka planifikim ushtarak për situata të paparashikuara kundër Kosovës, gjë kjo që mund të supozohet nga politikat e saj armiqësore të sigurisë dhe të mbrojtjes kundër Prishtinës. Çfarëdo mundësie strategjike që Serbia mund ta shfrytëzojë nëse vendos ta sulmojë Kosovën, pos në rastin e ofensivës konvencionale për 'aneksimin' e territorit në veri të Ibrit, vështirë që do ta përcaktojë fituesin e luftës, dhe në ndonjë rast të tillë që të dyja palët mund ta pësojnë një cenueshmëri pak a shumë të njëjtë politike të brendshme dhe të jashtme në një konflikt të stërzgatur.

Prandaj, balancimi i fortë i Kosovës kundër Serbisë nuk është një opsion ekonomikisht dhe ushtarakisht racional që do ta siguronte mbrojtjen e saj të suksesshme dhe përmbajtjen e synimeve të mundshme ofensive të Beogradit. Vetëm normalizimi i marrëdhënieve të mbrojtjes midis Kosovës dhe Serbisë, përmes masave për krijimin e besimit, njësor si dhe anëtarësia e

Kosovës në Pfp, do ta hapnin mundësinë për një tërheqje të KFOR-it që do të linte pas vetes stabilitet dhe siguri në të tërë rajonin.

Rekomandime

- a) Modalitetet për dialogun e mundshëm midis Prishtinës dhe Beogradit për normalizimin e marrëdhënieve të mbrojtjes
- Dialogu duhet të ndihmohet nga UE-ja dhe NATO-ja bashkarisht.
 - Masat për ndërtimin e besimit midis dy vendeve mund të bazohen në modelin e OSBE-së për Masat për Ndërtimin e Besimit dhe të Sigurisë.
 - Demilitarizimi i Veriut të Kosovës, si dhe i Luginës së Preshevës, përderisa Kosova të mos e merr nga NATO-ja Planin Aksional për Anëtarësim, dhe Serbia të mos bëhet anëtare e UE-së.
 - Ndryshimet e politikave të sigurisë dhe të mbrojtjes së Beogradit ndaj Kosovës, të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë, dhe të Strategjisë së Mbrojtjes.
 - Përfaqësimi i serbëve të Kosovës në udhëheqjen e forcave të ardhshme të armatosura të Kosovës.
 - Anëtarësimi i plotë i Kosovës në Ministerialin e Mbrojtjes të Evropës Juglindore.
- b) Komponentet për dialogun e mundshëm struktural të NATO-s me Kosovën
- Asistimi dhe vlerësimi i Zhvillimit të Sektorit të Mbrojtjes të Kosovës, bazuar në Planin Aksional të Partneritetit të NATO-s (PAP) për Ndërtimin e Institucioneve të Mbrojtjes (DIB).
 - Asistimi dhe vlerësimi i zhvillimit të interoperabilitetit të forcave të ardhshme të armatosura të Kosovës, bazuar në Procesin e Planifikimit dhe të Shqyrtimit të Partneritetit të NATO-s (PARP).
 - Ngritja e Ekipit për Ndërlidhje dhe Këshillim të NATO-s dhe e Ekipit Këshillues të NATO-s në një Zyre të vetme Ushtarake për Ndërlidhje të NATO-s në Prishtinë, dhe themelimi i Zyres për Ndërlidhje të Kosovës në NATO.
 - Dialogu duhet të shihet si një masë e përkohshme për ndërtimin e marrëdhënieve midis NATO-s dhe Kosovës. Vetëm anëtarësimi i plotë në Pfp dhe në Këshillin Euro-Atlantik do t'ia mundësojnë Kosovës të bëhet pjesë e mekanizmit të udhëhequr nga NATO-ja për bashkëpunim në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes.
- c) Përmbajtja e synimeve armiqësore të Rusisë në Ballkanin Perëndimor
- NATO-ja dhe UE-ja Serbisë duhet t'ia caktojnë qartë vijat e kuqe lidhur me bashkëpunimin e saj ushtarak dhe të sigurisë me Rusinë.
 - Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s dhe shtetet anëtare përkrahëse duhet ta ndërmarrin një udhëheqësi të koordinuar për një anëtarësim të përsheptuar të Kosovës në Partneritetin për Paqe dhe në Këshillin Euro-Atlantik, si dhe për anëtarësimin e Maqedonisë, Malit të Zi dhe të Bosnjës e Hercegovinës në NATO.

d) Korniza ligjore për përfshirjen e forcave ushtarake të vendeve të Ballkanit
Perëndimor në luftën kundër terrorizmit

- Përfshirja e forcave ushtarake në luftën kundër terrorizmit duhet të përcaktohet në mënyrë të përpiktë me ligj, ashtu që të pamundësohet keqpërdorimi i tyre nga qeveritë kombëtare për qëllime politike, si dhe të parandalohet shkelja e të drejtave njerëzore dhe të pakicave kombëtare.

Hyrje

Ballkani Perëndimor është i vetmi nën-rajon i Evropës që në vend se ta merrte rrugën e tranzicionit për në demokraci, pas përfundimit të Luftës së Ftohtë hyri në luftra dhe në mizori, që përfunduan me shpërbërjen e fuqisë së tij mbizotëruese – Jugosllavisë – dhe me shfaqjen e mëpastajme të shtatë shteteve të reja. Si një rajon që nuk është i integruar në tërësi në NATO dhe në UE, ky është ende i prirur ndaj grindjeve dhe konflikteve ndër- dhe brenda-shtetërore të natyrës nacionaliste. Për shkak të asimetrisë së tashme të fuqisë midis aktorëve në dhe përreth Ballkanit Perëndimor, u takon fuqive të jashtme (NATO-s dhe/ose UE-së) që rajonin ‘ta shtyjë’ drejt një kompleksi (të pandarë) evropian të sigurisë,² që, si pasojë, do ta pamundësojë çfarëdo potenciali për rishfaqjen e konflikteve të hapura. Kriza e kohëve të fundit në Ukrainë, dhe ajo jo edhe aq e kohëve të fundit në Gjeorgji, janë mësim të mira për t’u mësuar nga Brukseli – dhe, në të vërtetë, edhe mjaft të vështira – për atë që kurfarë bashkëpunimi, pa anëtarësim të plotë në NATO dhe në UE, nuk mund ta garantojë mbrojtjen nga agresioni i jashtëm dhe/ose nga konfliktet ndërshtetërore.

Ky punim synon ta hetojë mjedisin e sigurisë dhe të mbrojtjes së Kosovës në kuadrin e Ballkanit Perëndimor. Për këtë qëllim, ky së pari analizon politikat kombëtare të sigurisë dhe të mbrojtjes të vendeve të rajonit,³ aftësitë e tyre ushtarake dhe shpenzimet e mbrojtjes, eksportet dhe importet ushtarake, si dhe shpërndarjen e bazave ushtarake, në një mënyrë të pavarur nga ndikimi i aktorit kyç të jashtëm të sigurisë dhe të mbrojtjes – Aleancës Veri-Atlantike. Po ashtu, kjo analizë përmban edhe një brez të gjerë të dhënash zyrtare lidhur me këto çështje. Së dyti, ky e analizon efektin e përfshirjes së NATO-s në sigurinë e rajonit, dhe kjo është bërë përmes analizave të përfshirjes ushtarake, të bashkëpunimit, dhe të mekanizmave të anëtarësimit. Së treti, ky i shqyrton dilemat e sigurisë dhe sfidat e mbrojtjes së Kosovës, përfshirë ato me Serbinë, si dhe perspektivat për një bashkëpunim zyrtar të mundshëm me NATO-n.

Së fundi, punimi ofron një grumbull rekomandimesh për modalitetet e dialogut të mundshëm mes Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve të mbrojtjes, për komponentet e dialogut të strukturuar të NATO-s me Kosovën, për përmbajtjen e synimeve armiqësore të Rusisë në Ballkanin Perëndimor, si dhe për rregullimin e përpiktë të luftës kundër terrorizmit nga ana e forcave ushtarake të vendeve të rajonit.

² Burry Buzan dhe Ole W’ver: *Regions and Powers: The Structure of International Security*, Cambridge Studies in International Relations, Cambridge University Press, 2004, fq. 377.

³ Për informata të hollësishme për dokumentet e sigurive kombëtare dhe të politikave mbrojtëse të vendeve të Ballkanit Perëndimor shih Aneksin 1: “Burimet Bibliografike të Tabelave.” Hulumtimi i këtyre dokumenteve është përfunduar më 30 qershor 2014.

1. Politikat e sigurisë kombëtare

1.1. Hyrje

Gjatë 15 viteve të fundit Ballkani Perëndimor ka përjetuar një transformim dramatik të rrethanave gjeopolitike, dhe të atyre të sigurisë e të mbrojtjes, duke filluar nga intervenimi i NATO-s kundër ish-Jugosllavisë (1995, 1999), dhe duke vazhduar, me Marrëveshjen e Ohrit (2001), pavarësinë e Malit të Zi (2006) dhe të Kosovës (2008), anëtarësimin e Shqipërisë dhe të Kroacisë në NATO (2009), dhe anëtarësimin e Kroacisë në UE. Si pasojë, vendet e rajonit kanë lëvizur nga lufta në paqe, nga paqja në detant, dhe nga detanti në bashkëpunim bilateral dhe multilateral. Marrëdhëniet midis Kosovës dhe Serbisë, që janë në fazat e hershme të detantit, janë një përjashtim nga kjo tendencë e përgjithshme.

Ndryshimi i këtyre rrethanave e ka patur një ndikim të madh në reformën e sektorit të sigurisë dhe në rishqyrtimin dhe përvetësimin e mëpastajmë të dokumenteve të reja lidhur me sigurinë kombëtare të vendeve individuale të rajonit. Qëllimet e këtyre dokumenteve në vendet demokratike janë institucionalizimi i udhëheqjes në nivelin kombëtar i çështjeve të sigurisë kombëtare, prezantimi në nivel të paklasifikuar para publikut kombëtar, dhe, në disa raste, edhe para publikeve të jashtme.⁴

Me qëllim të vlerësimit të mirëfilltë të sigurisë së rajonit, në një mënyrë të pavarur nga aktori kyç i jashtëm i sigurisë dhe i mbrojtjes – NATO – kjo pjesë do t'i analizojë gurët themeltarë të politikave të sigurisë kombëtare – vlerësimet e kërcënimeve të sigurisë, dhe interesat e objektivat kombëtare të sigurisë të vendeve individuale të Ballkanit Perëndimor nga këndvështrimi i publikut të jashtëm.⁵ Kjo analizë është fundamentale për vlerësimin e sigurisë së Kosovës në kontekstin e fqinjësisë së saj të drejtpërdrejtë, si dhe të perspektivave për një paqe dhe siguri të qëndrueshme në rajon.

⁴ Për qartësim të mëtejshme shih: Alan G. Stolberg: *How Nation States Craft National Security Documents*, Strategic Studies Institute (SSI) i US Army War College, Carlisle, tetor 2012, fq. 2-3.

- a) Këto shërbejnë si një kornizë e gjerë për departamentet apo ministritë e qeverisë (si dhe për trupat legjislativë dhe gjyqësorë), për të siguruar që ato e kuptojnë synimin (qasjen apo drejtimin) që udhëheqësia e zgjedhur e lartë e dëshiron në fushat e zgjedhura të sigurisë kombëtare.
- b) Këto mund të shërbejnë për ta informuar trupin ligjvënës brenda një demokracie (p.sh. parlamentin, kongresin) për kërkesat për resurse për strategjinë në fjalë, dhe kështu e ndihmojnë autorizimin (fiskal) dhe procesin e përvetësimit.
- c) E kanë mundësinë për të qenë një mjet strategjik për komunikime edhe për publikun vendës, edhe për atë të jashtëm. Këto publike i përfshijnë përbërësit vendës të një shteti demokratik – ata që merren kyç për zgjedhje e partisë në pushtet, të tillë si grupet apo sindikatat lobuese. Kjo, po ashtu, mund të jetë e drejtuar kah aktorë të tjerë në sistemin ndërkombëtar, të tillë si shtetet-kombe apo entitetet që janë kërcënime potenciale që merren si domethënëse për zhvillimin shtetëror të dokumentit.

⁵ *Ibid.*, shih pikën c).

1.2. Analizë e kërcënimeve të sigurisë

Kërcënimet e sigurisë, ashtu siç janë të specifikuara në dokumentet e sigurive kombëtare të vendeve individuale të Ballkanit Perëndimor, janë të përpunuara në një mënyrë të kufizuar dhe përballen me një mori problemesh në formulimin e tyre, që ndryshojnë nga mungesa e dallimit të qartë midis sfidave, kërcënimeve dhe rreziqeve, e deri te përcaktimi i prioriteteve të kërcënimeve⁶. Vlerësimet e kërcënimeve dhe të rreziqeve (ndikimi i vlerësuar negativ, përballë gjasës së tyre) mund të shfrytëzohen për t'i përcaktuar përgjegjësitë në menaxhimin e rrezikut,⁷ përfshirë këtu planifikimin për situatat e paparashikuara, si dhe përgjigjet në kuadrin e qeverive ekzekutive dhe të agjencioneve të tyre si dhe të ofruesve të shërbimeve publike. Për qëllim të një analize të përqendruar, këto janë të përmbledhura në kategoritë Konvencionale dhe Armët e Shkatërrimit në Masë, Jokonvencionale dhe Transnacionale, Qeverisja e Dobët dhe Emergjencat/Katastrofat.⁸

Vendet e Ballkanit Perëndimor kërcënimet konvencionale i shikojnë me të njëjtat syze, por thjerrëzat i kanë të ndryshme. Bosnja e Hercegovina dhe Maqedonia konsiderojnë se kërcënimet për konflikte të armatosura pothuaj nuk ka fare, Shqipëria dhe Kosova parashohin që do të ketë një rënie domethënëse të tyre, dhe që do të ketë shumë më pak gjasë që këto të ndodhin në të ardhmen e afërt, Kroacia dhe Mali i Zi këto i konsiderojnë si të reduktuara në masë të madhe, ndërkaq Serbia i trajton vetëm si të reduktuara. Megjithatë, asnjë nga këto vende konfliktin e armatosur nuk e përjashton në tërësi si një kërcënim, që do të mund të shkaktohej kryesisht nga përpjekjet për ndryshim të dhunshëm të kufijve (ashtu siç shihet nga Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia), mirëpo është e qartë (ashtu siç shihet nga Kroacia) që mundësia e ndonjë ofensive të suksesshme kundër të tjerëve në rajon është e vogël. Kësisoj, mund të përfundohet që rishfaqja e konflikteve të dhunshme në rajon, nga këndvështrimi i vlerësimit të kërcënimeve nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, është e largët, mirëpo, nëse kjo do të mund të ndodhte, atëherë nuk mund të përjashtohet mundësia e intervenimeve të kufizuara të armatosura.

Përhapja e Armëve për Shkatërrim në Masë (WMD) identifikohet nga të gjitha vendet e rajonit si një kërcënim i një natyre ushtarake, mirëpo reagimet ndaj tij nuk janë të parapara nga asnjëri nga to. Do të mund të supozohej që ky kërcënim është “importuar nga mirësjellja” nga dokumentet strategjike të NATO-s dhe të UE-së, në vend se të përftohet nga ndonjë vlerësim

⁶ Ky problem që është vërejtur nga botimi i DCAF-it: “Study on the Assessment of Regional Security Threats and Challenges in the Western Balkans,” i redaktuar nga István Gyarmati dhe Darko Stančić, <http://www.dcaf.ch/Publications/Study-on-the-Assessment-of-Regional-Security-Threats-and-Challenges-in-the-Western-Balkans>, Geneva, 2007, dhe ky është edhe më tutje në tërësi relevant.

⁷ Todor Tagerev: “The Art of Shaping Defence Policy: Scope, Components, Relationships (but no Algorithms),” Connections, Vëllimi V, Numri 1, Pranverë – Verë 2006, fq.33.

⁸ Shih Tabelën: Kërcënimet e sigurisë.

serioz i mundësisë dhe gjasës për përhapjen dhe shfrytëzimin e WMD-ve në rajon. Megjithatë, mund të pritët që nëse ndonjë kërcënim i tillë do të bëhet realitet, ky do të trajtohet së bashku me organizatat ndërkombëtare të sigurisë dhe mbrojtjes kolektive, të tilla si Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, NATO-ja, UE-ja dhe OSBE-ja.

Ashtu siç është ilustruar në tabelën përkatëse në fund të seksionit, rreziqet që mund ta destabilizojnë rajonin dhe ta shkaktojnë rishfaqjen e konflikteve të armatosura, përfshirë këtu edhe reagimet konvencionale, sipas dokumenteve të sigurisë dhe të mbrojtjes kombëtare të këtyre vendeve, janë kërcënimet e natyrës politike – nacionaliste/etnike dhe fetare, të shtetformimit dhe të kufijve të kontestuar/të papërcaktuar.

Që të gjitha shtetet e rajonit, me përjashtim të Malit të Zi dhe Serbisë, kërcënimet e kësaj natyre i paraqesin pa e përmendur ndonjë vend të veçantë si brengë apo kërcënim të drejtpërdrejtë. Ndërkohë që Mali i Zi zhvillimet e mëtejme lidhur me Kosovën i konsideron kyçe për sigurinë dhe stabilitetin e rajonit, Serbia e paraqet Kosovën, përfshirë këtu edhe Forcën e saj të Sigurisë (KSF), si një kërcënim të drejtpërdrejtë “ndaj strukturës ekzistuese rajonale të kontrollit të armatimit, që e kërcënon barazpeshën në rajon.” Fjalori që Beogradi e përdor lidhur me krijimin e Forcave të Armatosura të Kosovës është madje edhe më i vrazhdë.⁹ Projektimi i Kosovës si një kërcënim kaq i madh i sigurisë është një dëshmi e qartë lidhur me synimet e sigurisë dhe të mbrojtjes së Beogradit kundër Prishtinës.

Në një mënyrë ironike, Qeveria e Kosovës këto dëshmi i ka shpërfillur në Shqyrtimin e saj Strategjik të Sektorit të Sigurisë (2014). Për më tepër, kjo konsideron që “zbutja dhe normalizimi i marrëdhënieve midis Republikës së Kosovës dhe Serbisë ka filluar dhe është duke vazhduar në frymën e mos-konfrontimit dhe të integritimit evropian,”¹⁰ ndërkohë që në një mënyrë të nxituar e presupozon ndryshimin e të tërë politikës së Beogradit ndaj Kosovës. Ngjashëm me Qeverinë e Kosovës, lidhur me këto politika të Beogradit nuk ka patur kurfarë reagimesh as nga NATO-ja dhe UE-ja, dhe as nga shtetet e tyre anëtare. Shpërfillja e këtij problemi nuk është ilaçi i duhur për zgjidhjen e tij, pavarësisht nga prania e NATO-s në Kosovë dhe nga mandati i saj për ruajtjen e paqes, si dhe nga aftësia e saj e pamposhtshme siguroese.

Sa i përket kërcënimeve jo-konvencionale dhe transnacionale, që të gjitha vendet e rajonit i kanë të përbashkëta pak a shumë të njëjtat shqetësime. Vlerësimet e tyre mbizotërohen nga terrorizmi, krimi i organizuar, lëvizjet ekstremiste, trafikimi ilegal dhe krimet kibernetike.

⁹ Shih, për shembull, deklarin e Ministrit të Mbrojtjes së Serbisë, Bratislav Gasic: Vojska Kosova bi bila pretinja, http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2014&mm=07&dd=27&nav_category=640&nav_id=881519 News Agency B92, 27 korrik, 2014.

¹⁰ Analizë e Strategic Environment Review of the Republic of Kosovo, mars 2014, fq. 16. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Analysis_of_Strategic_Security_Sector_Review_of_RKS_060314.pdf

Trajtimi i efektshëm i këtyre kërcënimeve kërkon bashkëpunim ndërshtetëror në nivelin bilateral dhe multilateral, dhe atë para së gjithash në rajon, por, po ashtu, edhe me Vashingtonin dhe Brukselin. Për shkak të integritetit të papërfunduar të saj në bashkësinë ndërkombëtare, Kosova nuk e ka mundësinë e një bashkëpunimi të drejtpërdrejtë multilateral rajonal, mirëpo kjo kompensohet përmes kanaleve anësore të komunikimit, përmes UNMIK-ut, dhe bashkëpunimit të drejtpërdrejtë bilateral me vendet e rajonit (pos Serbisë dhe Bosnje-Hercegovinës), me SHBA-të dhe me vendet anëtare të UE-së që e kanë njohur shtetësinë e saj. Megjithatë, një çështje që e vështirëson këtë punë është qëndrimi armiqësor i Serbisë, që, ngjashëm si edhe të kërcënimet konvencionale dhe politike, Kosovën e projekton si burim të terrorizmit dhe të krimit të organizuar.

Kërcënimet e identifikuara lidhur me Qeverisjen e Dobët e pasqyrojnë tranzicionin e papërfunduar të shteteve të rajonit nga komunizmi dhe nga shoqëritë e dërrmuara nga lufta në shtete stabile demokratike me institucione të fuqishme, dhe me sisteme plotësisht funksionale të sundimit të ligjit. Korrupsioni, krimi i organizuar, problemet socio-ekonomike, institucionet e dobëta dhe papunësia i mbizotërojnë rendet e ditës dhe vlerësimet e kërcënimeve të këtyre vendeve. Këto po ashtu përkojnë me kriteret e zgjerimit të UE-së që duhen plotësuar nga vendet e veçanta të rajonit që e aspirojnë anëtarësinë, që janë kandidatë, apo që i kanë filluar bisedimet për antarësim.

Nga aspekti i vlerësimit të kërcënimeve të sigurisë të vendeve të veçanta të Ballkanit Perëndimor, mund të përfundohet që Kosova përballet me një mjedis të favorshëm, por që, njëkohësisht është edhe kompleks. Fqinjët e saj të drejtpërdrejtë, Shqipëria dhe Maqedonia e përjashtojnë mundësinë e çfarëdo kërcënimi të drejtpërdrejtë që do të mund të vinte nga Kosova, dhe Mali i Zi e sheh si një rrëfim të papërfunduar nga aspekti i stabilitetit dhe sigurisë rajonale; ndërkaq, Serbia atë e projekton si një kërcënim të drejtpërdrejtë konvencional dhe si një entitet shtetëror belaxhi, në vend se si një vend fqinj me të cilin ende nuk i ka rregulluar marrëdhëniet, në të njëjtën kohë kur me të i ka të përbashkëta synimet e anëtarësimit në Unionin Evropian. Në rrethana të tilla, është iluzore të parashihet ndonjë normalizim thelbësor i marrëdhënieve midis Prishtinës dhe Beogradit, si dhe ndonjë strategji kredible e tërheqjes së NATO-s, prania e të cilës mbetet vendimtare për mbrojtjen e Kosovës si dhe për sigurinë dhe stabilitetin e të tërë rajonit.

KËRCËNIMET E SIGURISË

Kërcëni met	Shqipëria	Bosnja e Hercegovina	Kroacia	Kosova	Maqedonia	Mali i Zi	Serbia
KONVENZIONALE DHE TË SHKATËRRIMIT NË MASË	Shtetet apo grupet e shteteve në konflikt kundër njëri-tjetrit, pritet të përjetojnë rënie domethënëse në një afat të shkurtër dhe të mesëm.	Nuk ka pothuaj kurfarë rreziku të agresionit të jashtëm në të ardhmen e afërt; Mirëpo, është një përqendrim relativisht i lartë i kapaciteteve ushtarake në rajon.	Rreziku i kërcënimit ushtarak në rajon është i reduktuar në masë të madhe.	Konfrontimet konvencionale midis vendeve brenda dhe përreth zonës Euroatlantike janë me më pak gjasë për të ndodhur në të ardhmen e afërt dhe të mesme.	Aktualisht nuk përballet me kërcënime të drejtpërdrejta konvencionale për sigurinë e vet kombëtare.	Rreziku nga kërcënimi ushtarak është i reduktuar në masë domethënëse si pasojë e reduktimit të aseteve ushtarake në rajon, por kjo nuk mund të përjashtohet në të ardhmen.	Kërcënimi i agresionit të armatosur është i reduktuar por jo edhe i përjashtuar.
	Ndryshimi i dhunshëm i kufijve shtetërorë, nacionalizmi ekstrem, konfrontimi i grupeve etnike, kulturore, ideologjike e fetare, përtej kufijve shtetërorë, mund të mbeten rrezik për sigurinë rajonale në vitet e ardhshme.	Përpjekjet për secesion, autonomi dhe pavarësi nga grupe të caktuara etnike, së bashku me përqendrimin relativisht të lartë të kapaciteteve ushtarake.	Krizat në zonat e veta fqinje si dhe ato brenda zonës më të gjerë, posaçërisht ato në Mesdheun Jugor/Afrikën Veriore, Lindjen e Afërt dhe në Kaukaz.	Mjetet e pashpërthyer/ /Pajisjet e improvizuara shpërthyes UXO/IED	Luftrat e gjeneratës së katërt (4GW) (Aktorët joshstetërorë).	Rifillimi i mundshëm i konflikteve multi-etnike dhe multi-fetare.	Kryengritja e armatosur , si një trajtë e veçantë e konfliktit të armatosur të nxitur nga aspiratat jokushtetuese dhe të dhunshme për ndryshimin e kufijve. Konfliktet me shfrytëzim të armëve mund të shpërthejnë si rezultat i përshkallëzimit të terrorizmit dhe të grindjeve kufitare, territoriale dhe të tjera.
	Përhapja e armëve të shkatërrimit në masë (WMD).	Sasi të tepërta të armatimeve dhe të municioneve të vendosura në objekte joadekuate.	Kapaciteti i ofenzivës së suksesshme kundër të tjerëve është i ulët.	Përhapja e armëve të vogla.		Teprica e armatimeve dhe municioneve të dala nga përdorimi.	Forca e Sigurisë së Kosovës paraqet një rrezik serioz për gjendjen ekzistuese të kontrollimit të armatimit dhe kërcënon balancin në rajon.
	Zhvillimi i kapaciteteve raketore ballistike në vendet jashtë NATO-s.	Prodhimi dhe shitja e pakontrolluar e armëve, përfshirë edhe WMD-të. Minat tokësore dhe pajisjet e pashpërthyer.	Përhapja e WMD-ve për qëllime terroriste; Minat dhe pajisjet shpërthyes.	Përhapja e WMD-ve të ndryshme dhe të atyre bërthamore.	Përhapja e WMD-ve.	Përhapja e WMD-ve.	Përhapja e WMD-ve.

Kërcëni met	Shqipëria	Bosnja e Hercegovina	Kroacia	Kosova	Maqedonia	Mali i Zi	Serbia
POLITIKE	Ndjenjat nacionaliste	Implementimi i ngadalshëm i Marrëveshjes Paqësore të Dejtonit.	Mbrojtja dhe të drejtat e pakicave kombëtare në vendet në rajon dhe zgjidhjet e njëanshme për këto çështje.	Ekstremizmi etnik dhe fetar.	Radikalizmi dhe ekstremizmi fetar.	Ngjarjet e kaluara dhe problemet e pazgjidhura, që mund të shkaktojnë jostabilitet në zona më të vogla.	Shpallja ilegale dhe unilaterale e pavarësisë së Kosovës.
	Problemet e pazgjidhura (historia komplekse).	Mbetjet e animoziteteve politike dhe shoqërore si rezultat i konfliktit 1992-1995, të përkrahura nga elementë që propagandojnë trajta të ndryshme të ekstremizmit nacionalist.	Çështjet kufitare që rezultuan në rënien e ish-Jugosllavisë.	Jostabiliteti rajonal politik.	Rajoni është ende i ngarkuar nga çështje të pazgjidhura dhe përballet me rreziqe komplekse të sigurisë.	Zhvillimet e ardhshme lidhur me Kosovën mbeten kyçe për stabilitetin dhe sigurinë e rajonit si dhe për perspektivën e tij evropiane dhe euroatlantike.	Shpallja e paligjshme dhe unilaterale e pavarësisë së Kosovës.
	Destabilizimi rajonal (nacionalizmi dhe konfliktet etnike).	Rreziku latent dhe problemet brenda vendeve të caktuara dhe në marrëdhëniet midis vendeve të rajonit.	Problemet në finalizimin e formimit të vendeve të reja.	Kufijtë e kontestuar/të papërcaktuar.	Burimet e jostabilitetit dhe të konflikteve potenciale do të vazhdojnë t'i kontribuojnë paparashikueshmërisë së mjedisit të sigurisë të zonës Euroatlantike, përfshirë edhe rajonin e Evropës Juglindore.		Statusi i pazgjidhur dhe situata e vështirë e refugjatëve, të personave të zhvendosur, dhe të të zhvendosurve të brendshëm.
		Lëvizjet për ta fituar autonominë-pavarësinë.	Konfliktet potenciale apo interesat e vendeve për ta fituar kontrollin mbi rrugët tranzitore të resurseve natyrore.				Procesi i papërfunduar i demarkacionit midis shteteve të ish-Jugosllavisë.
		Mostoleranca etnike, fetare, racore dhe politike.	Jostabiliteti, përshkallëzimi i pabarazive kombëtare, fetare dhe ekonomike.				Veprimi destruktiv i sekteve dhe kulteve të caktuara fetare.
							Kosova (veprimet e dhunës të nxitura etnikisht, pasiguria dhe frika në mesin e pjesëtarëve të popullit serb).

Kërcëni met	Shqipëria	Bosnja e Hercegovina	Kroacia	Kosova	Maqedonia	Mali i Zi	Serbia
JOKONVENZIONALE DHE TRANSNACIONALE	Konfrontimi midis shteteve dhe aktorëve joshitetërorë pritet të rritet në vitet e ardhshme. Këto mund të shkaktohen nga terrorizmi , lëvizjet ekstremiste, shtetet e dështuara, aktivitetet jolegale, apo krizat e ndryshme.	Terrorizmi	Terrorizmi	Terrorizmi	Terrorizmi	Terrorizmi	Terrorizmi (përfshirë terrorizmin dhe përhapjen e krimit të organizuar në Kosovë).
	Krimi i organizuar.	Shpërlarja e parave dhe financimi i veprimtarive terroriste.	Trafikimi ilegal i drogave, i armëve dhe i qenieve njerëzore si burim i financimit terrorist.	Krimi transnacional.	Krimi i organizuar transnacional.	Siguria mund të ndikohet negativisht nga krizat në rrethinën e afërt, por edhe në zonën më të gjerë (Lindja e Afërt, Kaukazi) dhe demonstrimi i kërcënimeve transnacionale dhe bartja e krizave drejt Evropës.	Aktivitetet e inteligjencave të jashtme brenda vendit.
	Trafikimi ilegal.	Pozita gjeostrategjike e rajonit, të vendosur në rrugët e rëndësishme midis Evropës dhe Azisë (që janë rrugë të transportimit të naftës dhe të gazit natyror, por, po ashtu, edhe për trafikimin ilegal të armëve, narkotikëve, skllëvërve të bardhë, etj. Ndikimi i ideologjive ekstreme.	Krimi i organizuar.	Krimi i organizuar.	Kryqëzimi i rrugëve kryesore don të thotë mundësi më të mëdha për terrorizëm, migrim ilegal, trafikim të drogave, njerëzve dhe armatimit si kërcënime të rregullta transnacionale.	Krimi i organizuar.	Krimi i organizuar (trafikimi i drogave, trafikimi i njerëzve dhe migrimet ilegale, si dhe në fushën ekonomike dhe financiare, përhapja e armëve konvencionale – me përqendrim të veçantë në Kosovë – dhe mundësia e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë.
	Krimi kibernetik.	Trafikimi (qeniet njerëzore dhe narkotikët).	Konfliktet e interesit lidhur me kontrollin mbi rrugët tranzitore, qasja në resurset e reja apo fitimi i ndikimit brenda zonave që janë burime të resurseve të tilla.	Pabarazia ekonomike në nivelin global.	Ripërtëritja e ngadalshme ekonomike dhe deficiti i lartë financiar për disa shtete anëtare të UE-së rezultojnë në shpërhapjen e jostabilitetit në rrethinën e tyre.	Kontrabanda e drogave narkotike, e armëve, migrimet ilegale, trafikimi i njerëzve.	Siguria energjetike.
	Siguria energjetike dhe resurset e pamjaftueshme.	Dallimet midis pjesëve të pasura dhe të varfëra të botës.	Rezultatet negative të shkaktuara nga procesi i globalizimit. Krizat e refugjatëve.	Lëvizjet ekstremiste.	Sulmet kompjuterike.	Pasojat e globalizimit; dallimet midis vendeve të pasura dhe të varfëra krahas me pasojat politike.	Krimi kibernetik dhe kërcënimet ndaj sistemeve informatike dhe telekomunikuese.
		Intensifikimi i migrimit të detyruar si pasojë e situatave ekstreme.	Mundësia e rrezikimit të sistemeve informatike.	Krimi kibernetik.		Krimet kibernetike.	

Kërcëni met	Shqipëria	Bosnja e Hercegovina	Kroacia	Kosova	Maqedonia	Mali i Zi	Serbia
QEVERISJA E DOBËT	Keqinformimi i opinionit publik e favorizon destabilizimin.	Krimi i organizuar që e përforcon jostabilitetin e qëndrueshëm në shtete të caktuara. Kufijtë poroz që e mundësojnë trafikimin (përfshirë këtu kriminelët dhe terroristët ndërkombëtarë).	Problemet e tranzicionit të vendeve në zonën e Evropës Lindore dhe Juglindore.	Krimet ekonomike.	Migrimi ilegal.	Korrupsioni.	Korrupsioni.
	Zhvillimi i pamjaftueshëm ekonomik.	Korrupsioni.	Problemet me funksionimin e sistemit juridik dhe ngadalësia e kryerjes së procedurave ligjore.	Mozhvillimi ekonomik.	Vendet jostabile dhe jofunksionale.	Vështirësitë ekonomike, shoqërore dhe politike që vijnë së bashku me procesin e tranzicionit.	Problemet e zhvillimit ekonomik.
	Zhvillimi i pamjaftueshëm i edukimit, shkencës dhe kulturës.	Dallimet në rritje në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror.	Papunësia.	Papunësia.		Problemet e tranzicionit.	Zhvillimi jo i njëtrajtshëm ekonomik dhe demografik.
	Imigrimi ilegal.	Pasojat shoqërore të papunësisë.	Kërcënimi i shembjes ekonomike.	Institucionet e dobëta të sigurisë/drejtësisë.			
	Institucionet e brishta qeveritare.	Jostabiliteti që rezulton nga tranzicioni në ekonominë e tregut përkeqësohet nga ngecja e rajonit në krahasim me vendet më të zhvilluara.	Trendet negative të popullatës.	Korrupsioni.			
	Migrimi i pakontrolluar.	Problemet e tranzicionit në ekonomi të tregut.	Disavantazhet e globalizimit dhe të zhvillimit ekonomik asimetrik.	Shtetet e dështuara.			
	Jostabiliteti i brendshëm politik.	Problemet e tranzicionit dhe jostabiliteti përbrenda shteteve.	Demokratizimi jo i plotë, problemet e tranzicionit.				

Kërcëni met	Shqipëria	Bosnja e Hercegovina	Kroacia	Kosova	Maqedonia	Mali i Zi	Serbia
URGIENCAT DHE KATASTROFAT	Faktorët natyrorë, industrialë dhe njerëzorë.	Sfidat mjedisore (përfshirë katastrofat natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu, problemet e menaxhimit të mbeturinave të ngurta dhe ushtarake, ndotja).	Katastrofat natyrore dhe teknike/teknologjike në vend dhe në rajon.	Katastrofat natyrore.		Katastrofat natyrore, të mjedisit, teknike dhe teknologjike.	Shpenzimi i pakontrolluar i resurseve natyrore dhe rrezikimi i mjedisit.
		Kërcënimet e qëndrueshme ndaj mjedisit si rezultat i zhvillimit industrial dhe teknologjik.	Përhapja e sëmundjeve infektive dhe epidemive.	Epidemitë.		Katastrofat kimmike, biologjike, bërthamore dhe radiologjike.	Katastrofat natyrore dhe fatkeqësitë teknike dhe teknologjike.
		Përhapja e sëmundjeve të ndryshme të pashërueshme.	Bombat potenciale të mjedisit (centralet bërthamore, instalimet e vjetruara industriale).	Katastrofat e shkaktuara nga faktori njerëzor.		Epidemitë.	Shfaqja dhe përhapja e sëmundjeve infektive të njerëzit dhe e sëmundjeve të shtazët.
						Kërcënimet ekologjike.	Varësia nga drogat.
							Ngrohja globale.

1.3. Interesat kombëtare dhe analiza e qëllimeve të sigurisë

Interesat kombëtare janë gurë themeltarë për formulimin e politikës së sigurisë kombëtare dhe shërbejnë si udhëzime për t'u përballur me kërcënimet e sigurisë dhe për t'i trajtuar mundësitë në dispozicion,¹¹ ndërkohë që qëllimet e sigurisë kombëtare shërbejnë si udhëzime për mbrojtjen dhe avancimin e interesave kombëtare. Në shumicën e dokumenteve të sigurisë kombëtare të vendeve të rajonit nuk bëhet, as qartësimi, dhe as dallimi i këtyre dy kategorive të sigurisë kombëtare.¹² Po ashtu, nuk bëhet, as kategorizimi i interesave kombëtare, dhe as specifikimi i intensiteteve të tyre, gjë kjo që analizën e tyre në këto rrethana e bën tejet të vështirë.

Kategorizimi i interesave kombëtare që mund të haset më së shpeshti në literaturë është i dhënë në Tabelën vijuese:¹³

Mbijetesesa	Interesi më i rëndësishëm i çdo shteti, dhe vetë thelbi i tij – mbrojtja e qytetarëve dhe institucioneve të tij nga sulmi nga armiqtë. Ky i adresohet kërcënimit të atypëratyshëm të sulmit dhe është një interes që nuk mund të komprometohet. Mospërmbushja e tij sjell kosto që është katastrofike, apo e përafërt me këtë. Për ta siguruar mbijetesën e shtetit, do të bëhet gjithçka që mund të bëhet, përfshirë këtu edhe shfrytëzimin e forcës ushtarake.
Jetike	Interesi jetik ekziston kur një çështje është aq e rëndësishme për mirëqenien e shtetit sa që udhëheqësia e tij mund ta komprometojë atë vetëm deri në një shkallë të caktuar. Përtej kësaj pike, kompromisi nuk është i mundur edhe më tutje, meqë dëmtimi potencial i shtetit nuk do të jetë edhe më tej i durueshëm. Nëse ky interes përmbushet, kjo do të sjellë përfitim të madh për shtetin; nëse jo, kjo do të mbart kosto që për shtetin do të jenë shumë të rënda, por jo edhe katastrofike. Kostot e tilla mund ta dëmtojnë rëndë, por jo edhe ta rrezikojnë, aftësinë e qeverisjes shtetërore për ta mbrojtur dhe rritur mirëqenien e popullatës së vet.
Të rëndësishme	Këto interesa janë domethënëse, por jo edhe vendimtare, për mirëqenien e shtetit. Këto mund të shkaktojnë brenga serioze dhe mund t'i dëmtojnë interesat e jashtme të shtetit, mirëpo, edhe pse pasojat mund të jenë mjaft të dhembshme, këto me shumë më tepër gjasë do të zgjidhen me kompromise dhe negociata, sesa me konfrontim. Vlera, njësoj si edhe humbja, potenciale e këtyre interesave, do të jenë mesatare, dhe jo shumë të mëdha.
Periferike	Këto interesa nuk përfshijnë, as kërcënime për sigurinë e shtetit apo për mirëqenien e popullatës së tij, dhe as nuk ndikojnë seriozisht në stabilitetin e sistemit ndërkombëtar. Këto janë gjendje të dëshirueshme, por të tilla që kanë fare pak ndikim të drejtpërdrejtë në aftësinë e shtetit për ta mbrojtur popullatën e vet.

¹¹ J. Boone Bartholomees, Jr. (Ed), *National Security Policy and Strategy*, Strategic Studies Institute (SSI) i US Army #ar College, Carlisle, korrik 2010, fq.5.

¹² Për njohuri më të thella shih burimet e Tabelës: Interesi kombëtar dhe Qëllimet e sigurisë, Aneksi 1, Burimet bibliografike të tabelave.

¹³ Tabela është marrë nga: J. Boone Bartholomees, Jr (red.), *National Security Policy and Strategy*, Strategic Studies Institute (SSI) i US Army #ar College, Carlisle, korrik 2010, fq. 8-9.

Mirëpo, kjo kornizë nuk është e zbatueshme për vlerësimin e interesave të sigurive kombëtare të vendeve të rajonit, për shkak të mangësive të sipërpërmendura në formulimin e tyre. Prandaj, për ta fituar një pamje më të qartë për një vlerësim në një kornizë krahasuese, interesat dhe objektivat e përcaktuara të sigurive kombëtare të vendeve të rajonit janë bashkëshkrirë së brendshmi dhe janë klasifikuar në katër grupe – Ekzistenciale, Fqinjëria dhe rajoni, Integrimet Euro-Atlantike dhe siguria ndërkombëtare, dhe Interesat dhe qëllimet e qeverisjes së brendshme.¹⁴

Interesat ekzistenciale të vendeve të rajonit mbulojnë mbrojtjen e sovranitetit dhe të pavarësisë, të karakterit të vendit (shumë-etnik apo kombëtar), dhe mbrojtjen e qytetarëve të tyre. Megjithatë, ka dallime në atë si shtetet e parashohin mbrojtjen dhe avancimin e këtyre interesave jashtë kornizës multilaterale, që e pasqyron gjendjen e tyre nga aspekti i aftësive dhe kufizimeve të tyre.¹⁵ Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia dhe Mali i Zi nuk i specifikojnë qartë qëllimet e sigurisë për mbrojtjen e këtyre interesave, Shqipëria dhe Kosova parashohin konsolidimin dhe zhvillimin e sigurisë (të institucioneve të mbrojtjes), ndërkohë që Kroacia thekson që do t'i shfrytëzojë të gjitha kapacitetet në dispozicion, përfshirë edhe shfrytëzimin e forcave të armatosura. Serbia, pos shfrytëzimit të këtyre kapaciteteve, synon të përdorë grumbullimin parandalues (të jashtëm) të të dhënave të inteligjencës (“identifikimin me kohë, grumbullimin e informatave dhe ndërmarrjen e veprimtarive për të parandaluar dhe zhdukur shkaqet e rreziqeve dhe të kërcënimeve ndaj sigurisë”), dhe masat parandaluese të sigurisë (“veprimin parandalues përmes implementimit të masave dhe veprimeve efektive”). Duke marrë parasysh pasqyrimin e Kosovës nga Serbia si një ndër kërcënimet kryesore të sigurisë së saj, mund të supozohet që veprimi i inteligjencës së Beogradit brenda territorit të Kosovës është intensiv. Po ashtu, është vështirë e besueshme që Serbia i përjashton edhe masat e tjera, përfshirë këtu edhe ato të natyrës ushtarake.

Këto vende sigurinë e tyre e shohin si të pandashme nga siguria dhe stabiliteti rajonal. Prandaj këto në parim janë të përkushtuara ndaj marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe për t'i kontribuar stabilitetit dhe sigurisë rajonale. Megjithatë, analiza e mëtejme do të tregojë që në këto vende ekziston një shkallë evidente e ankthit, që mund të merr trajta që nga zhvillimet e paparashikuara politike, e deri te një mungesë thelbësore e besimit për sjelljen e ardhshme të shteteve të tjera të rajonit.

Shqipëria bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore i sheh si prioritet. Kroacia pranon që “shkalla optimale e sigurisë kombëtare nuk mund të arrihet pa paqe dhe siguri në

¹⁴ Shih Tabelën: Interesat dhe qëllimet e sigurisë kombëtare.

¹⁵ Vetëm Kroacia dhe Serbia kanë në dispozicion forca ushtarake dhe forca të tjera të sigurisë që janë në gjendje të ofrojnë vetëmbrojtje nga agresioni i jashtëm, ndërkaq, vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor janë tejet të cënueshme (shih seksionin 3.5.).

kuadrin e rrethinës së drejtpërdrejtë,” mirëpo kjo nuk e mohon rëndësinë e kapaciteteve të kontrolluara ushtarake duke e trajtuar “Kontrollimin e armatimit dhe masat për ndërtimin e besimit dhe të sigurisë” si një komponentë të rëndësishme për rritjen e sigurisë rajonale. Maqedonia marrëdhëniet e mira fqinjësore i merr si “interes jetik kombëtar” që është e qartë, duke patur parasysh, së pari përbërjen e saj etnike, dhe, më pas, çështjet e saj të pazgjidhura, posaçërisht me Greqinë, Bullgarinë dhe Serbinë. Mali i Zi synon të krijojë dhe fuqizojë mekanizma të përshtatshëm të sigurisë në nivelin rajonal, ndërkohë që Serbia synon ta përmirësojë bashkëpunimin dhe të ndërtojë “kapacitete dhe mekanizma të përbashkëta për zgjidhjen e kundërthënive, mospajttimeve dhe të gjitha llojeve të sfidave, rreziqeve dhe kërcënimeve në nivelin rajonal.” Kosova e kupton realitetin dhe paaftësinë e vet aktuale institucionale dhe synon të “zhvillojë kapacitete për rritjen e bashkëpunimeve dhe partneriteteve rajonale” duke mbetur në një masë të madhe edhe më tutje e pintepruar në mekanizmat rajonale të bashkëpunimit në siguri dhe mbrojtje, kryesisht për shkak të kundërshtimit të Serbisë. Të dhënat për politikën e këtyre vendeve individuale na çojnë në përfundimin që siguria dhe stabiliteti afatgjatë të rajonit e paraqesin një çështje që ende nuk është mbyllur.

Pos kësaj, Shqipëria, Kroacia dhe Serbia e marrin rolin e vendit amë për anëtarë të etnive përkatëse që jetojnë jashtë kufijve të tyre shtetërorë. Këto vende kanë qasje të ndryshme për mbrojtjen e interesave të tyre. Shqipëria “çështjen shqiptare” e sheh si të hapur, dhe, duke synuar t’i mbrojë vlerat dhe të drejtat kombëtare të shqiptarëve, parasheh që kjo do të zgjidhet përmes integriteteve euroatlantike të vendeve të rajonit, dhe synon t’i mbrojë vlerat dhe të drejtat kombëtare të shqiptarëve. Kroacia shprehet që e ka një interesim të rëndësishëm që Bosnja e Hercegovina të jetë shtet stabil dhe demokratik, dhe i integruar në UE, meqë kroatët janë grup etnik përbërës i këtij vendi, por ajo nuk i përmend kroatët që jetojnë në vendet e tjera të rajonit. Për dallim nga Kroacia, Serbia synon t’i përparojë trajtat kulturore, ekonomike dhe “të tjera” të bashkëpunimit me serbët që jetojnë jashtë kufijve të saj, dhe ta ruaj identitetin e tyre kombëtar dhe kulturor, duke e projektuar kështu veten si epiqendër politike të serbëve të rajonit.

Shqipëria nuk sillet si vend amë për shqiptarët e Kosovës. Në vend të kësaj, Shqipëria dhe Kosova njëra-tjetrën e shohin si vende motra. Pavarësisht nga fakti që me Kushtetutë është e përcaktuar si një shtet multi-etnik, Kosova, si e veçantë, dhe së bashku me Shqipërinë, në praktikë e luan rolin e vendit amë për pakicat etnike shqiptare në ish-Jugosllavi.

Kësisoj, ndryshimet gjeopolitike të 25 viteve të fundit në Ballkanin Perëndimor, kanë krijuar qendra mono-polare të serbizmit dhe të kroatizmit, dhe një shqiptarizëm bipolar, me dy qendra. Shfaqja e këtyre qendrave pasqyron çështjet e hapura të pakicave kombëtare në

Ballkanin Perëndimor së bashku me veçantitë e tyre, si dhe zgjidhjet e dallueshme rezultuese që janë zbatuar deri më tash. Mirëpo, është një dallim midis kroatizmit dhe shqiptarizmit, nga njëra anë, dhe serbizmit, nga tjetra. Ndërkohë që Kroacia, Shqipëria dhe Kosova e inkurajojnë integrimin e kroatëve dhe shqiptarëve në vendet ku ata jetojnë, Serbia nuk e bën të njëjtën me serbët, dhe posaçërisht me ata në Bosnje e Hercegovinë dhe në Kosovë. Në këto dy vende Beogradi është duke shtyrë politika kundër-integruese së bashku me përcaktimin normativ të territoreve ku pakica etnike serbe paraqet shumicë. Nga aspekti i gjeopolitikës etnike në Ballkanin Perëndimor, çështjet e hapura të shqiptarizmit, kroatizmit dhe serbizmit janë faktorët kyç të (pa)sigurisë dhe të (jo)stabilitetit, dhe këto janë ende të ngarkuara me çështje të hapura të pakicave etnike dhe me marrëdhënie të brishta ndëretnike.

Interesat dhe qëllimet e qeverisjes së brendshme të vendeve të rajonit kanë të bëjnë me çështjet e ruajtjes së rendit kushtetues, të vlerave demokratike, të sundimit të ligjit, të sigurisë njerëzore dhe ekonomike, si dhe të reformës së brendshme, dhe këto janë të domosdoshme për integrimin euroatlantik. Këto vende synojnë të bëhen anëtare të UE-së (Kroacia tashmë është anëtare), dhe shumica e tyre të NATO-s (Shqipëria dhe Kroacia tashmë janë anëtare), me përjashtim të Serbisë që nuk ka ambicje për anëtarësim në Aleancën Veri-Atlantike dhe është e kufizuar në pjesëmarrjen në Partneritetin për Paqe.

Që të gjitha vendet e rajonit kanë ambicje, dhe e përkrahin paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, edhe pse Kosova ende duhet t'i zhvillojë aftësitë themelore për t'i kontribuar misioneve ndërkombëtare të kësaj natyre. Serbia, megjithatë, është vendi i vetëm në rajon që, në mbrojtjen e "vlerave të përbashkëta në pajtim me interesat e veta kombëtare," pos organizatave multilaterale përfshin edhe "fuqitë e mëdha," domethënë, SHBA-të, UE-në dhe Rusinë. Lidhur me këtë, burim i një shqetësimi të veçantë është bashkëpunimi i fuqizuar i sigurisë i Serbisë me Rusinë, që tash është duke lëvizur gjithnjë e më tepër drejt përplasjes me UE-në dhe me NATO-n. Duhet përmendur që në prill të vitit 2013, Serbia e fitoi Statusin Vëzhgues në Asamblenë Parlamentare të aleancës ndërqeveritare ushtarake të udhëhequr nga Rusia, e ashtuquajtura Organizata e Traktatit të Sigurisë Kolektive,¹⁶ që është në kundërshtim me qëllimin e deklaruar të Beogradit që Serbia të bëhet anëtare e UE-së, dhe, më pas, edhe pjesë e integruar e ESDP-së – Politikës Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje. Duke patur parasysh agresivitetin e politikës së tashme ruse të sigurisë dhe të mbrojtjes, që kulmoi me aneksimin ilegal të Krimesë dhe me politikën konfrontuese me NATO-n dhe me UE-në, politika e dyfishtë e Serbisë me Brukselin dhe me Moskën mund të ketë pasoja të zymta të sigurisë, si për rajonin, ashtu edhe për Kosovën. Lidhur me këtë, një shqetësim të veçantë e shkakton marrëveshja e

¹⁶ CSTO komunikatë për shtyp: "Parliamentary Delegations of Islamic Republic of Afghanistan and Republic of Serbia Granted Observer Status in Parliamentary Assembly of Collective Security Treaty Organization," Moskë, 12 prill, 2013. http://www.odkb-csto.org/news/detail.php?ELEMENT_ID=1776.

tetorit 2011 midis Beogradit dhe Moskës, për themelimin e Qendrës Serbo-Ruse për Reagim ndaj Situatave të Emergjencës në Nish.¹⁷

Në kundërshtim me vendimin e saj për të mbetur jashtë NATO-s dhe për të flirtuar me Rusinë në bashkëpunimin e sigurisë dhe të mbrojtjes, Serbia deri më tash nuk e ka kundërshtuar anëtarësimin e mundshëm të Bosnjes e Hercegovinës në NATO. Si pasojë e kësaj pozite të Beogradit, Republika Serbe nuk ka vënë veto në Planin Aksional për Anëtarësim të Bosnjes e Hercegovinës në NATO. Një herë kur Bosnja e Hercegovina të bëhet anëtare e NATO-s dhe e UE-së, (gjeo)politika e shtetit-komb etnik në Ballkanin Perëndimor mund të ndryshojë në mënyrë thelbësore. Kjo në një mënyrë të (pa)qëllimshme do ta mundësojë 'decentralizimin' e nacionalizmit etnik, do t'i fuqizojë identitetet e shteteve kombëtare, dhe do ta zvogëlojë nacionalizmin e roleve të vetëprojektuara të vendeve amë. Rezultate të ngjashme mund të fitohen edhe nga anëtarësimi i Kosovës dhe Maqedonisë në NATO dhe në UE.

¹⁷EurActive: Russia Opens "Humanitarian Base," 18 tetor, 2011, <http://www.euractiv.com/enlargement/russia-opens-humanitarian-base-s-news-508382>

INTERESAT KOMBËTARE DHE QËLLIMET E SIGURISË

	Shqipëria	BeH	Kroacia	Kosova	Maqedonia	Mali i Zi	Serbia
EKZISTENCIALE	<p>Sovraniteti, pavarësia dhe integriteti territorial i vendit.</p> <p>Prosperiteti dhe siguria e qytetarëve të tij.</p> <p>Paqja dhe siguria në vend.</p> <p>Konsolidimi i institucioneve dhe instrumenteve të sigurisë.</p> <p>Konsolidimi i Forcave të Armatosura.</p>	<p>Mbrojtja e rendit kushtetues dhe e të drejtave dhe lirive të garantuara me kushtetutë.</p>	<p>Mbijetesa e shtetit sovran, të pavarur dhe territorialisht të integruar me identitetin e vet kombëtar dhe me vlerat fundamentale, si dhe mbrojtja e jetëve dhe pronës së qytetarëve të vet.</p> <p>Shfrytëzimi i të gjitha mundësive dhe resurseve në dispozicion, përfshirë edhe i forcave të veta të armatosura po të jetë e domosdoshme, për mbrojtjen e interesave të veta jetike.</p> <p>Ndërtimi dhe mirëmbajtja e mekanizmave dhe resurseve efektive të sigurisë dhe përballja e suksesshme me çfarëdo sfidash, rreziqesh dhe kërcënimesh.</p>	<p>Pavarësia, sovraniteti dhe integriteti territorial.</p> <p>Jeta, mirëqenia, prona dhe siguria e qytetarëve të Kosovës.</p> <p>Mbrojtja e jetëve dhe pronës.</p> <p>Rritja e mirëqenies shoqërore për të gjithë qytetarët.</p> <p>Sigurimi i sigurisë së tërësishme për qytetarët.</p> <p>Konservimi dhe mbrojtja e sovranitetit dhe e integritetit territorial.</p> <p>Shfrytëzimi i mjeteve diplomatike në interesin e mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit.</p> <p>Zhvillimi i kapaciteteve të Sigurisë dhe Mbrojtjes (institucionet dhe instrumentet).</p> <p>Menaxhimi dhe kontrolli i integruar i kufijve shtetëror.</p>	<p>Pavarësia, sovraniteti dhe integriteti territorial dhe karakteri unitar i vendit si dhe karakteri i tij multi-etnik dhe multi-kulturor janë interesa të qëndrueshme të vendit.</p> <p>Mbrojtja dhe promovimi i paqes, sigurisë, shëndetit dhe sigurisë personale të qytetarëve.</p>	<p>Mbrojtja e sovranitetit, unitetit dhe integritetit territorial. Mbrojtja nga të gjitha trajtat e kërcënimeve konvencionale, jokonvencionale dhe asimetrike, posaçërisht nga kërcënimet e terrorizmit.</p> <p>Mbrojtja e jetëve dhe pronës së qytetarëve dhe e të mirave ekonomike.</p>	<p>Ruajtja e sovranitetit, pavarësisë dhe integritetit territorial, si dhe e identitetit kombëtar, kulturor, fetar dhe historik të popullit serb dhe të pakicave kombëtare.</p> <p>Mbrojtja e jetës dhe e pronës së qytetarëve, e lirive të tyre, barazisë, barazisë kombëtare dhe barazisë gjinore, drejtësia shoqërore, të drejtat njerëzore dhe të pakicave, dhe pacenueshmëria e pronës private dhe e trajtave të tjera të saj, janë vlera universale që pranohen si kombëtare.</p> <p>E drejta për t'u mbrojtur përfshin vendimin e lirë për trajtën dhe mënyrën e implementimit të sigurisë kombëtare, si dhe për pjesëmarrjen në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare të sigurisë, duke patur parasysh interesat e vendit.</p> <p>Forcimi i sigurisë kombëtare përmes identifikimit me kohë, grumbullimit të informatave dhe ndërmarrjes së veprimeve për t'i parandaluar dhe zhdukur shkaqet e rreziqeve dhe të kërcënimeve për siguri.</p> <p>Shfrytëzimi i të gjitha kapaciteteve në dispozicion për t'i mbrojtur interesat e veta kombëtare. Veprimi parandalues përmes implementimit të efektshëm të masave dhe veprimtarive.</p> <p>Përmirësimi i sigurisë së qytetarëve, shoqërisë dhe shtetit, dhe forcimi i institucioneve të sigurisë kombëtare.</p>

	Shqipëria	BeH	Kroacia	Kosova	Maqedonia	Mali i Zi	Serbia
FQINJËRIA DHE RAJONI	<p>Promovimi i një mjedisi rajonal të paqes, sigurisë dhe stabilitetit, vendosja e marrëdhënieve të singerta reciproke me vendet fqinje dhe, po ashtu, të drejtat dhe liritë e qytetarëve shqiptarë kudo qoftë, janë prioritet për sigurinë e vendit.</p> <p>Mbrojtja e vlerave dhe të drejtave kombëtare të shqiptarëve.</p> <p>Çështja kombëtare shqiptare do të zgjidhet përmes integrimi në UE dhe e atyre euroatlantike të vendeve të rajonit.</p> <p>Përkushtimi ndaj përkrahjes së paqes dhe sigurisë rajonale.</p>	<p>Kontributi për Bashkëpunimin Rajonal në Evropën Juglindore.</p> <p>Integrimi në strukturat kolektive të sigurisë.</p>	<p>Qëllimi rajonal i veprimtarive të sigurisë përfshihet nga fakti që vendi është një shtet relativisht i vogël dhe që problemet e sigurisë të botës bashkëkohore janë të shumta dhe komplekse.</p> <p>Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi i zhvilluar me shtetet fqinje janë themel, si dhe parakusht për integrimin e plotë në grumbullin evropian. Një shkallë optimale e sigurisë kombëtare nuk mund të arrihet pa paqe dhe siguri në kuadrin e rrethinës së drejtpërdrejtë.</p> <p>Bashkëpunimi rajonal është një komponentë e rëndësishme e politikave të sigurisë së vendeve.</p> <p>Për shkak të pozitës së vet gjeografike dhe faktit që kroatët janë një nga tre grupet konstitutive etnike të Bosnjes e Hercegovinës, Kroacia e ka një interes domethënës që ky vend të jetë një shtet stabil dhe demokratik, që është i aftë për një zhvillim të pavarur dhe të qëndrueshëm, dhe që, në të ardhmen e afërt, do të jetë në tërësi i integruar në grumbullin evropian.</p> <p>Bashkëpunimi rajonal është një komponentë e rëndësishme e politikave të sigurisë së vendeve</p> <p>Kontrollimi i armëve dhe masat për ndërtimin e besimit dhe të sigurisë.</p>	<p>Pjesëmarrja aktive në mekanizmat rajonal dhe ndërkombëtarë.</p> <p>Kontribuon për proceset e integritetit dhe bashkëpunimit rajonal, përqipet për anëtarësime me të drejta dhe obligime të plota dhe merr pjesë aktive në organizatat dhe nismat rajonale.</p> <p>Zhvillimi i kapaciteteve për të rritur bashkëpunimin dhe partneritetet rajonale.</p>	<p>Udhëheqja e një politike aktive të fqinjësisë së mirë dhe marrja pjesë në përmirësimin e bashkëpunimit rajonal.</p> <p>Kontributi për paqe dhe stabilitet në botë, në Evropë dhe në Rajonin e Evropës Juglindore.</p> <p>Zhvillimi dhe mbajtja e të gjitha formave të mundshme të bashkëpunimit me vendet fqinje, në përputhje me interesat jetike.</p> <p>Promovimi i politikës së marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe bashkëpunimi në nivel rajonal dhe global.</p>	<p>Bërja e përpjekjeve për të krijuar dhe fuqizuar mekanizma të përshtatshëm të sigurisë në nivelet rajonale dhe lokale, me të gjitha organizatat dhe shtetet e interesuara për arrijtjen e stabilitetit dhe të sigurisë.</p>	<p>Përmirësimi i bashkëpunimit me fqinjët dhe ndërtimi i kapaciteteve dhe mekanizmave të përbashkët për zgjidhjen e kundërtënieve, mospajtimeve dhe të gjitha llojeve të sfidave, rreziqeve dhe kërcënimeve në nivelin rajonal dhe global. Vendi i kontribuon krijimit të një mjedisi paqësor, stabil dhe të besueshëm të sigurisë.</p> <p>Mbajtja dhe fuqizimi i vazhdueshëm i lidhjeve të serbëve që jetojnë dhe punojnë jashtë me vendin amë, promovimi i bashkëpunimit kulturor, ekonomik dhe trajtave të tjera të bashkëpunimit me ta, dhe përkrahja e ruajtjes së identitetit të tyre kombëtar dhe kulturor.</p> <p>Respektimi i interesave të vendeve të tjera në rajon dhe në botën e tërë.</p> <p>Zhvillimi dhe promovimi i marrëdhënieve të mira fqinjësore, pjesëmarrja aktive në mbrojtjen e vlerave që i ka të përbashkëta me vendet e përfshira në procesin e integrimi evropian, me fuqitë e mëdha dhe me vendet e tjera të botës moderne, në pajtim me interesat e veta kombëtare.</p>

	Shqipëria	BeH	Kroacia	Kosova	Maqedonia	Mali i Zi	Serbia
TEGRIMET EURO-ATLANTIKE DHE SIGURIA NDËRKOMBËTARE	<p>Integrimi në bashkësinë Evropiane, Euro-Atlantike dhe globale.</p> <p>Përkushtimi ndaj përkrahjes së paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.</p> <p>Përkushtimi ndaj Konceptit CSDP dhe Strategjisë Evropiane të Sigurisë.</p> <p>Lufta kundër terrorizmit.</p>	<p>Kërkon anëtarësinë në NATO dhe në aleancat e tjera të sigurisë, sa më shpejtë që të jetë e mundur, si bazë për përzgjedhjen e partnerëve strategjikë bilateralë.</p> <p>Hyrja dhe anëtarësimi në sistemet e sigurisë kolektive.</p> <p>Integrimi në Unionin Evropian.</p> <p>Luftimi i terrorizmit, i krimit të organizuar dhe i trafikimit ilegal.</p>	<p>Integrimi në NATO është njëri nga qëllimet kryesore të politikave të jashtme dhe të sigurisë.</p> <p>Integrimi në Unionin Evropian dhe në Politikën Evropiane të Sigurisë dhe të Mbrojtjes (ESDP).</p> <p>Mjedis paqësor, stabil dhe i sigurtë. Zhvillimi i demokracisë dhe i vlerave dhe parimeve demokratike, në rajonin e afërt dhe më të gjerë.</p> <p>Ruajtja dhe zhvillimi i mëtutjeshëm i rendit ndërkombëtar bazuar në parimet e drejtësisë, respektimi i të drejtës ndërkombëtare, si dhe i barazisë politike dhe ekonomike.</p> <p>Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare.</p> <p>Kontributet për paqeruajtjen ndërkombëtare dhe për operacionet humanitare.</p>	<p>Anëtarësia dhe integrimi në institucionet evropiane, euro-atlantike dhe në ato globale, posaçërisht në NATO/UE/OSCE/KB.</p> <p>Përgatitja e kapaciteteve për të kontribuar në operacionet paqësore dhe humanitare dhe në misionet të tjera ndërkombëtare të NATO/OSCE/UE/KB.</p> <p>Kontributi për ndërtimin dhe mbrojtjen e stabilitetit rajonal dhe global.</p> <p>Zhvillimi, ndërtimi dhe forcimi i shërbimeve të inteligjencisë në interes të sigurisë, luftës kundër terrorizmit, krimit të korrupsionit.</p> <p>Zhvillimi i kapaciteteve kombëtare për t'u përballur me emergjencat kombëtare brenda dhe jashtë territorit të vendit.</p>	<p>Integrimi politik-mbrojtës në NATO.</p> <p>Integrimi politik, ekonomik dhe i sigurisë në UE.</p>	<p>Integrimi në NATO dhe në Unionin Evropian.</p> <p>Kontributi për stabilitet dhe paqe botërore përmes demonstrimit të solidaritetit të vet ndërkombëtar, pjesëmarrjes aktive në luftën kundër terrorizmit, përhapjes së armëve të shkatërrimit masiv, në deminime, në operacionet humanitare dhe paqeruajtëse, dhe duke lejuar mundësinë e shfrytëzimit të hapësirës së vet tokësore, ajrore dhe detare në përkrahje të misioneve të ndërmarra nga KB, NATO, UE dhe OSCE.</p> <p>Forcimi i kapaciteteve për ta luftuar terrorizmin, krimin e organizuar dhe korrupsionin, forcimi i sigurisë së kufijve.</p> <p>Forcimi i kapaciteteve dhe institucioneve përgjegjëse për drejtim në situata të emergjencës, të shkaktuara nga aksidentet natyrore, teknike-teknologjike (faktorin njerëzor), biologjike, kimike, bërthamore, radiologjike dhe të tjera.</p> <p>Përkrahja e qasjes multilaterale në zgjidhjen e çështjeve të sigurisë.</p> <p>Mbrojtja e paqes dhe sigurisë, në rajonin e saj të drejtpërdrejtë strategjikisht relevant dhe në Evropë.</p>	<p>Integrimi në strukturat evropiane dhe të tjera të sigurisë ndërkombëtare, dhe pjesëmarrja në programin e Partneritetit për Paqe të NATO-s.</p> <p>Pjesëmarrja në ndërtimin e një mjedisi të favorshëm të sigurisë dhe në integrimet evropiane si dhe në strukturat e tjera rajonale dhe ndërkombëtare.</p> <p>Mbajtja dhe zhvillimi i rendit ndërkombëtar, të bazuar në parimet e drejtësisë, respektimit të të drejtës ndërkombëtare dhe të barazisë politike dhe shtetërore. Si një anëtar i përgjegjshëm i bashkësisë ndërkombëtare, e respekton të drejtën ndërkombëtare, Kartën e KB-ve, Aktin Final të Helsinkit dhe obligimet e marra dhe e mbron zgjidhjen paqësore të grindjeve midis kombeve dhe shteteve.</p> <p>Mbajtja dhe zhvillimi i rendit ndërkombëtar, bazuar në parimet e drejtësisë, respektimit të të drejtës ndërkombëtare dhe të barazisë politike dhe shtetërore. Si anëtar i përgjegjshëm i bashkësisë ndërkombëtare, Republika e Serbisë e respekton të drejtën ndërkombëtare, Kartën e KB-ve, Aktin Final të Helsinkit dhe obligimet e supozuara dhe e mbron zgjidhjen paqësore të grindjeve midis kombeve dhe shteteve.</p> <p>Pandashmëria e sigurisë arrihet përmes kontributit aktiv për sigurinë e përgjithshme, si dhe përmes bashkëpunimit dhe partneritetit me subjektet e marrëdhënive ndërkombëtare.</p>

	Shqipëria	BeH	Kroacia	Kosova	Maqedonia	Mali i Zi	Serbia
QEVERISJA E BRENDSHME	<p>Zhvillimi i qëndrueshëm socio-ekonomik.</p> <p>Prosperiteti dhe siguria e qytetarëve të vet.</p> <p>Sundimi i ligjit dhe rendi demokratik dhe kushtetues.</p> <p>Konsolidimi i shoqërisë demokratike dhe vrojtimi i të drejtave njerëzore.</p> <p>Konsolidimi ekonomik.</p> <p>Përafrimi i legjisllacionit me standardet e UE-së.</p> <p>Mbrojtja e mjedisit dhe e resurseve natyrore.</p> <p>Respektimi i lirisë dhe i të drejtave fundamentale njerëzore dhe të pakicave.</p> <p>Harmonizimi i pjesëve të sistemit të sigurisë kombëtare dhe pranimi i implementimit të standardeve ndërkombëtare në fushën e sigurisë.</p>	<p>Mbrojtja e rendit kushtetues dhe e të drejtave dhe lirive njerëzore të garantuara në mënyrë kushtetutare.</p> <p>Arritja e rritës më të shpejtë ekonomike, e standardeve më të larta jetësore dhe zhvillimi i programeve dhe mekanizmave funksionale shoqërore për asistencën ekonomike për qytetarët.</p> <p>Zhvillimi i një ekonomie të vetëqëndrueshme si një parakusht për pavarësi, përmirësimi i standardeve jetësore, dhe hyrja në Unionin Evropian.</p>	<p>Liria, barazia, barazia kombëtare si dhe barazia gjinore, pacifizmi, të drejtat shoqërore, të drejtat njerëzore, prona e pacenueshme, mbrojtja e natyrës dhe e mjedisit, qeverisja e drejtësisë dhe e demokracisë.</p> <p>Ruajtja dhe zhvillimi i demokracisë dhe i zhvillimeve demokratike, një qeverisje e drejtë, prosperiteti ekonomik dhe drejtësia shoqërore.</p> <p>Vlerat demokratike të tilla si liria, të drejtat njerëzore dhe të pakicave dhe barazia paraqesin pjesë integrale të këtyre interesave.</p> <p>Ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit dhe e shëndetit dhe e mirëqenies të të gjithë qytetarëve të vet.</p> <p>Zhvillimi i parakushteve dhe konditave për zhvillim të lirë, të drejtë dhe stabil politik, ekonomik dhe shoqëror të shoqërisë në bashkëpunim me marrëveshjen e ndërsjellë me shtetet e tjera demokratike.</p> <p>Ruajtja e identitetit të vet kulturor dhe historik.</p>	<p>Rendi kushtetues.</p> <p>Ruajtja dhe forcimi i sundimit të ligjit dhe të rendit anembanë vendit.</p> <p>Respektimi i të drejtave dhe lirive njerëzore në pajtim me standardet dhe normat ndërkombëtare.</p> <p>Sigurimi i një sistemi të njëzuar dhe të pavarur gjyqësor.</p> <p>Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik.</p> <p>Zhvillimi i politikave për një treg të lirë dhe ekonomi stabile.</p> <p>Mjedis i favorshëm për investime të jashtme dhe vendëse.</p> <p>Bashkëpunimi ekonomik rajonal dhe ndërkombëtar.</p> <p>Forcimi i sundimit të ligjit, sistemi i pavarur gjyqësor dhe zbatimi dhe implementimi i ligjeve.</p> <p>Promovimi i një demokracie funksionale, për të zhvilluar më tutje pluralizmin politik, për të promovuar ekonominë e tregut të lirë dhe për të respektuar të drejtat njerëzore dhe ato të pakicave etnike.</p> <p>Zhvillimi i infrastrukturave të përshtatshme kombëtare për lëvizjen e lirë të njerëzve dhe të të mirave, dhe me vendet fqinje.</p> <p>Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve të përkujdesit shëndetësor për popullatën.</p> <p>Inkurajimi i zhvillimit të hulumtimit shkencor dhe zhvillimi dhe shfrytëzimi i teknologjive të reja.</p> <p>Investimi në edukim dhe shkollim.</p> <p>Harmonizimi i legjisllacionit në pajtim me standardet e UE-së dhe të NATO-s.</p>	<p>Promovimi i demokracisë multi-etnike dhe i marrëdhënieve multi-etnike.</p> <p>Ruajtja dhe përmirësimi i vlerave demokratike të shtetit: të drejtat dhe liritë njerëzore, sundimi i ligjit, pluralizmi politik, dialogu i hapur politik midis partive politike, parimi i ndarjes së pushteteve, mbrojtja e identitetit dhe trashëgimisë kulturore të të gjithë qytetarëve.</p> <p>Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të vendit bazuar në parimet e ekonomisë së tregut, pronës private dhe të ndërmarrësisë.</p> <p>Ndërtimi i një shteti shoqëror të drejtë nga aspekti i krijimit të mundësisë të barabarta për të gjithë qytetarët pavarësisht nga gjinia, raca, feja apo mjedisi i tyre politik apo etnik.</p> <p>Përmirësimi i stabilitetit të brendshëm të vendit, si parakusht për zhvillim të qëndrueshëm politik, ekonomik dhe shoqëror.</p> <p>Zhvillimi i një shoqërie moderne demokratike.</p> <p>Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit.</p> <p>Përmirësimi i standardit të jetesës së qytetarëve përmes ofrimit të cilësisë më të mirë të shërbimeve publike përmes edukimit të efektshëm, dhe sistemeve të mbrojtjes shëndetësore dhe sociale.</p>	<p>Forcimi i mëtejshëm i institucioneve demokratike dhe rritja e hapjes dhe transparencës në sektorin publik.</p> <p>Mbrojtja dhe forcimi i mëturshëm i sundimit të ligjit.</p> <p>Mbrojtja e të drejtave njerëzore dhe të pakicave.</p> <p>Mbrojtja e rendit kushtetues të shtetit.</p> <p>Forcimi i demokracisë, i sundimit të ligjit, mbrojtja e plotë e të drejtave njerëzore dhe të pakicave.</p> <p>Forcimi i pavarësisë, autonomisë dhe efektshmërisë së gjyqësorit, qasja autoritetive gjyqësore dhe besimi publik në gjyqësor.</p> <p>Siguria kombëtare në pajtim me dispozitat kushtetuese, me normat e të drejtës ndërkombëtare dhe obligimet ndërkombëtare.</p> <p>Forcimi i procesit të transparencës së sektorit të mbrojtjes dhe kontrollit civil i forcave të armatosura.</p> <p>Inkurajimi i hulumtimit, zhvillimit dhe shfrytëzimit të teknologjive të reja.</p> <p>Sigurimi i konditave të nevojshme për mbrojtjen e traditës, kulturës, gjuhës, identitetit dhe zakoneve kombëtare.</p> <p>Sigurimi i mbrojtjes së resurseve të informatave nga qasja apo modifikimi i paautorizuar gjatë ruajtjes, procesimit apo transferimi i saj, përfshirë masat për zbulim, dokumentim dhe eliminim të kërcënimeve.</p> <p>Ruajtja dhe mbrojtja e natyrës, e mjedisit të shëndetshëm dhe promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm.</p> <p>Ruajtja e sistemit demokratik shumëpartiak, shumetnik dhe shumëkonfesional të qeverisjes me respektim të plotë të vlerave demokratike.</p>	<p>Mbrojtja e jetës dhe pronës së qytetarëve, e lirisë, barazisë, barazisë kombëtare dhe barazisë gjinore të tyre, e të drejtave njerëzore dhe të pakicave, e pacenueshmërisë së pronës private dhe të formave të tjera të saj, janë vlera universale që pranohen si kombëtare.</p> <p>Ruajtja e stabilitetit të brendshëm, e sundimit të ligjit dhe zhvillimi i demokracisë dhe institucioneve demokratike dhe integrimi në Unionin Evropian dhe në strukturat e tjera ndërkombëtare.</p> <p>Zhvillimi ekonomik, me mbrojtjen mjedisore dhe të resurseve natyrore, është parakusht për prosperitetin e qytetarëve dhe të shtetit dhe mbrojtjen e vlerave kombëtare.</p> <p>Zhvillimi i një shoqërie politikisht dhe ekonomikisht stabile dhe prosperuese.</p> <p>Harmonizimi i pjesëve të sistemit të sigurisë kombëtare dhe pranimi dhe zbatimi i standardeve ndërkombëtare në fushën e sigurisë.</p>

2. Politikat e mbrojtjes dhe aftësitë ushtarake

2.1. Hyrje

E drejta natyrore e të gjitha shteteve për t'u vetëmbrojtur është përcaktuar qartë në Nenin 51 të Kartës së Kombeve të Bashkuara,¹⁸ që, si i tillë, nga kjo e drejtë nuk i përjashton shtetet joanëtare. Po ashtu, Karta e KB ndalon shfrytëzimin midis shteteve të forcave të armatosura (Neni 2.4),¹⁹ dhe në mënyrë eksplicite e mbron çdo shtet nga shfrytëzimi i jashtëm i forcës, pavarësisht nga ajo se a e njohin shtetet në fjalë njëri-tjetrin dhe anëtarësinë e tyre në KB (kjo ka të bëjë me “çdo shtet”).²⁰ Kësisoj, nga aspekti i të drejtës ndërkombëtare, këto dispozita janë tërësisht të zbatueshme për të gjitha vendet e rajonit, përfshirë edhe Kosovën, pavarësisht nga fakti që kjo nuk është ende anëtare e KB.

Prandaj, nuk është për t'u befusuar që pikënisja e përbashkët në përpilimin e politikave mbrojtëse dhe të doktrinave ushtarake të çdo shteti është e drejta natyrore për vetëmbrojtje. Komponente të tjera të këtyre politikave dallojnë nga shteti në shtet, për shkak të rrethanave të ndryshme të brendshme, fqinjësore, rajonale dhe globale, si dhe të ambicjeve të ndryshme kombëtare, dhe të aleancave dhe obligimeve ndërkombëtare. Lidhur me këtë, në formulimin e politikave mbrojtëse dhe të doktrinave ushtarake, vendet e Ballkanit Perëndimor nuk janë përjashtim nga ky rregull.

Për ta vlerësuar kontekstin e drejtpërdrejtë mbrojtës dhe ushtarak në të cilin ndodhet Kosova, në këtë pjesë të punimit do të analizohen politikat mbrojtëse, aftësitë ushtarake, projeksionet e buxheteve mbrojtëse, industritë ushtarake, eksportet dhe importet ushtarake, dhe bazat ushtarake të vendeve të veçanta të Ballkanit Perëndimor.

¹⁸ Neni 51 i Kartës së KB: “Asgjë në Kartën e këtushme nuk do ta dobësojë të drejtën e qenësishme për vetëmbrojtje individuale apo kolektive nëse një sulm i armatosur ndodh kundër ndonjë Anëtarë të Kombeve të Bashkuara, përderisa Këshilli i Sigurimit t'i ndërmerr masat e domosdoshme për ta mbajtur paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Masat e ndërmarra nga Anëtarët në ushtrimin e kësaj të drejte të vetëmbrojtjes do t'i raportohen menjëherë Këshillit të Sigurimit dhe në asnjë mënyrë nuk do ta ndikojnë autoritetin dhe përgjegjësinë e Këshillit të Sigurimit sipas Kartës së këtushme për ta ndërmarrë në çfarëdo kohe veprimin që e shih si të domosdoshëm për ta mbajtur apo rivendosur paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.”

¹⁹ Neni 2(4): “Të gjithë Anëtarët do të përmbahen në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare nga kërcënimi apo shfrytëzimi i forcës kundër integritetit territorial apo pavarësisë politike të **çdo shteti**, apo në çfarëdo mënyre që nuk është në pajtim me Qëllimet e Kombeve të Bashkuara.”

²⁰ Për shpjegime të mëtejshme shih: Dr. René Värk: The Legal Framework of the Use of Armed Force Revisited, *Baltic Security & Defence Review*. Vëll. 15, Numri 1, 2013.

2.2. Qëllimet e mbrojtjes dhe misionet e forcave të armatosura

Vetëmbrojtja është qëllim parësor mbrojtës i misionit të forcave të armatosura të çdo vendi të rajonit – mbrojtja dhe ruajtja e sovranitetit, e pavarësisë dhe e integritetit territorial të tyre. Për ta arritur këtë qëllim parësor, këto vende parashohin zhvillimin e sistemeve efektive të mbrojtjes kombëtare dhe kontrollin demokratik të tyre, integrimin në institucionet euro-atlantike dhe përkrahjen e autoriteteve civile.²¹ Po ashtu, të gjitha vendet e rajonit synojnë t'i kontribuojnë misioneve që kanë të bëjnë me paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

Pos kërkesave të mbrojtjes së pastër kombëtare, Shqipëria dhe Kroacia, në pajtim me obligimet që dalin nga anëtarësia e tyre në NATO, janë, po ashtu, të obliguara t'i zhvillojnë kapacitetet për mbrojtjen kolektive në kuadrin e kornizës planifikuese mbrojtëse të NATO-s. Bosnja e Hercegovina, Maqedonia dhe Mali i Zi, si vende aspiruese që e kanë marrë Planin Aksional të Anëtarësimit, synojnë të arrijnë interoperabilitet të plotë të forcave të tyre të armatosura me ato të NATO-s. Si një vend që e ka shpallur neutralitetin ushtarak dhe që nuk e aspiron anëtarësimin në NATO, Serbia ka qëllime që janë të kufizuara në interoperabilitetin me vendet anëtare të Partneritetit për Paqe të NATO-s,²² që, si i tillë, nuk e përjashton interoperabilitetin me NATO-n. Kosova, si një shtet që aspiron për t'u anëtarësuar në NATO, ende nuk i ka themeluar forcat ushtarake, dhe synon që Forcën e Sigurisë së Kosovës ta transformojë në forcë të armatosur – në Forcat e Armatosura të Kosovës – me mision të mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit të saj territorial. NATO-ja, as nuk e kundërshton, dhe as nuk e përkrah formalisht, krijimin e Forcave të Armatosura të Kosovës, por ky është kundërshtuar fuqishëm nga Serbia, madje edhe në nivelin e Këshillit të Sigurimit të KB.²³

Është interesante që Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia forcave të tyre të armatosura ia kanë përcaktuar edhe misionin për ta luftuar terrorizmin, ndërkohë që vendet e tjera të rajonit detyrat e tilla nuk i parashohin për forcat e armatosura. Përfshirja e forcave të armatosura në luftimin e terrorizmit brenda territoreve të shteteve përkatëse është në vetvete e rrezikshme për qeverisjen demokratike të sigurisë kombëtare dhe të institucioneve të drejtësisë, duke e patur parasysh mundësinë e projektimit të problemeve me minoritetet si probleme terroriste, në vend që këto të trajtohen si kërcënime politike dhe/ose shoqërore, çfarë këto mund të jenë në realitet. Përfshirja e forcave të armatosura, pos atyre policore, në trajtimin e problemeve me

²¹ Për vrojtme të hollësishme shih Tabelën: Qëllimet e mbrojtjes dhe misionet e forcave të armatosura.

²² Interoperabiliteti me vendet anëtare të Partneritetit për Paqe nuk përjashton interoperabilitetin me NATO-n, por ky është më pak se interoperabiliteti i plotë. Për shpjegime themelore të interoperabilitetit të forcave të armatosura të vendeve anëtare të NATO-s shih: Interoperability: Connecting NATO Forces, http://www.nato.int/cps/ar/natohq/topics_84112.htm?

²³ Apel i Presidentit Nikolic për Këshillin e Sigurimit të KB, uebsajti zyrtar i Presidentit të Serbisë <http://www.predsedinik.rs/en/press-center/press-releases/appeal-president-nikolic-un-security-council>, 27 maj, 2014.

minoritetet kombëtare është dëshmuar shkatërrimtare për ish-Jugosllavinë, duke shkaktuar luftra qytetare dhe ndër-etnike me pasoja katastrofike.

Çështja më shqetësuese këtu është që asnjëri nga vendet e rajonit nuk e ka ndonjë ligj të veçantë që e rregullon përfshirjen e forcave ushtarake në luftimin e terrorizmit brenda kufijve kombëtarë,²⁴ edhe pse kjo, në thelb, është një çështje e sundimit të ligjit. Nëse përfshirja e forcave ushtarake është e domosdoshme, për shkak të përgatitjes së pamjaftueshme të agjencioneve të tjera të sundimit të ligjit, atëherë duhet të përcaktohet me përpikëri se si kjo çështje duhet të rregullohet, ashtu që të shmanget keqpërdorimi për përfitime politike të brendshme, në hesap të të drejtave njerëzore dhe politike. Kësisoj, është e domosdoshme që ky lloj i përfshirjes së mundshme të forcave ushtarake kombëtare të përcaktohet me përpikëri nga ligji, ashtu që të pamundësohet keqpërdorimi i këtyre forcave nga qeveritë kombëtare për qëllime politike, si dhe të parandalohet shkelja e të drejtave njerëzore dhe të atyre të pakicave kombëtare.

Pos kësaj, Serbia është i vetmi vend në rajon që synon ta shfrytëzojë prapësimin për mbrojtjen e interesave të veta të mbrojtjes nga rreziqet dhe kërcënimet që mund t'i sfidojnë ato,²⁵ përfshirë këtu terrorizmin dhe separatizmin. Lidhur me këtë, përcaktimi i kërcënimeve të sigurisë nga ana e Serbisë është tejet problematik, duke patur parasysh që, si Kosova, ashtu edhe FSK-ja, merren si kërcënime separatiste, terroriste dhe ushtarake.²⁶ Rrjedhimisht, pavarësisht nga ajo se a çon metodologjia që mund të shfrytëzohet për planifikim mbrojtës në një planifikim që bazohet në kapacitete, kërcënime apo në skenare,²⁷ ajo që është thënë më sipër na imponon supozimin që Serbia tashmë ka planifikim për situata të paparashikuara kundër Kosovës. Ky fakt e vë në dyshim mbrojtjen që Kosovës i jipet sipas të Drejtës

²⁴ Përfshirja e forcave ushtarake të Shqipërisë nuk parashihet nga asnjë ligj, dhe është specifikuar dobët nga një vendim qeveritar: <http://www.asp.gov.al/pdf/kunder%20krimit%20te%20organizuar%20trafikeve%20dhe%20terrorizmit.pdf>;

Bosnja e Hercegovina nuk ka ndonjë ligj të veçantë, edhe pse kjo detyrë urdhërohet nga Ligji për Mbrojtje <http://www.ohr.int/ohr-dept/legal/laws-of-bih/pdf/014%20-%20ARMY%20LEGISLATION/BH%20Law%20on%20Defence%20of%20Bosnia%20and%20Herzegovina%2088-05.pdf>;

Kroacia parasheh vetëm rolin e Agjencisë së Inteligjencës të Sigurisë Ushtarake përmes Aktit për Sistemin e Inteligjencës së Sigurisë https://www.soa.hr/UserFiles/File/Zakon_o_sigurnosno-obavjestajnom_sustavu_RH_eng.pdf;

Kosova rolin e KSF-së në luftimin e terrorizmit e ka specifikuar dobët në Strategjinë Kombëtare dhe Planin Aksional Kundër Terrorizmit, http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Strategy_for_Counter_Terrorism_2012-2017_eng.pdf

Maqedonia nuk e ka ndonjë ligj të veçantë, edhe pse kjo detyrë mandatohet me Ligjin për Mbrojtje: <http://www.refworld.org/pdfid/3f549185d.pdf>;

Mali i Zi mbrojtjen anti-terroriste e parasheh vetëm në Ligjin për Forcat e Armatosura: <file:///C:/Users/Studio/Downloads/Law%20on%20the%20Armed%20Forces%20of%20Montenegro.pdf>;

Serbia mbrojtjen anti-terroriste e parasheh vetëm përmes Policisë Ushtarake të Forcave të Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes: <http://www.voamod.gov.rs/documents/law-on-the-saf.pdf>.

²⁵ Shih Tabelën: Misionet e forcave të armatosura.

²⁶ Shih Tabelën: Kërcënimet e Sigurisë – shtylla për Serbinë.

²⁷ Për shpjegime të mëtejme rreth planifikimit mbrojtës të bazuar në kapacitete, kërcënime dhe skenare, shih: *NATO Handbook on Long Term Defence Planning*, RTO/NATO, St. Joseph Print Group Inc., Ottawa, Canada, April 2003.

Ndërkombëtare (Karta e KB), që vështirë se do të respektohej në rrethanat e sotme nga Beogradi.

Këto synime të politikave mbrojtëse të Serbisë, të kombinuara me aftësitë e saj ushtarake e paraqesin një kërcënim të drejtpërdrejtë për Kosovën, dhe si të tilla e sfidojnë paqen dhe stabilitetin e Ballkanit Perëndimor. Ky fakt e përshkruan mungesën e evidente të një paqeje dhe stabiliteti të qëndrueshëm, që, aktualisht, është pothuaj e pamundur të ruhen pa praninë dhe pa zbatimin e paqes nga ana e NATO-s në Kosovë.

QËLLIMET E MBROJTJES

Shqipëria	Bosnja dhe Hercegovina	Kroacia	Kosova	Maqedonia	Mali i Zi	Serbia
<p>Garantimi i sovranitetit, pavarësisë dhe integritetit territorial, mbrojtja e popullatës gjatë paqes, krizës dhe kohës së luftës, dhe mbrojtja e interesave kombëtare.</p> <p>Reformat në fushën e mbrojtjes përqendrohen në krijimin e një force të armatosur të vogël, por më operacionale dhe profesionale, të aftë për t'i përbushur misionet e veta kushtetuese dhe të jetë interoperabile me ushtritë e vendeve të Aleancës.</p> <p>Zhvillimi i paketit të vet të Qëllimeve në Aftësi në përkrahje të mbrojtjes kolektive të Aleancës.</p> <p>Përkushtimet brenda vendit për mbrojtjen dhe përkrahjen e autoriteteve civile dhe të popullit shqiptar.</p> <p>Vënia në dispozicion e aftësive të veta në pajtim me planet për situata të paparashikuara për emergjencë kombëtare.</p> <p>Përkushtimi ndaj përkrahjes së paqes dhe sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare.</p> <p>Të kontribuojë me aftësitë e veta për menaxhimin e krizave dhe përkrahja e misioneve dhe aktiviteteve jo-luftarake, të tilla si asistencë trajnuese dhe rolet këshilluese, ndërtimi i kapaciteteve në kuadrin e programeve të mbrojtjes dhe të bashkëpunimit ushtarak.</p>	<p>Një barazpeshë e forcave dhe aftësive brenda Bosnjes dhe Hercegovinës, nën-rajonit të drejtpërdrejtë dhe Evropës Juglindore.</p> <p>Modernizimi i forcave për ta përfshirë zhvillimin e interoperabilitetit edhe brenda Forcave të Armatosura të Bosnjes dhe Hercegovinës, edhe me NATO-n.</p> <p>Kontrolli demokratik, civil i ushtrisë me mbikëqyrje parlamentare.</p> <p>Integrimi në strukturat euro-atlantike të sigurisë kolektive.</p> <p>Bashkëpunimi në fushën e kontrollimit të armatimit dhe të masave të ndërtimit të besimit dhe të sigurisë, për ta përfshirë pjesëmarrjen në strukturat dhe protokolet e strukturave të sigurisë të Evropës Juglindore.</p> <p>Standardizimi dhe interoperabiliteti në Partneritetin për Paqe/NATO.</p>	<p>Detyra parësore e sistemit të mbrojtjes është siguri i aftësive për vetëmbrojtje.</p> <p>Sistemi i mbrojtjes duhet të zhvillohet drejt ofrimit të përkrahjes së drejtpërdrejtë të sigurisë dhe politikës së jashtme.</p> <p>Forcat e Armatosura do t'i zhvillojnë, po ashtu, aftësitë për detyrat për përkrahjen e institucioneve civile nën kërcënim të drejtpërdrejtë dhe në situata të tjera të krizave.</p> <p>Në kuadrin e zhvillimit të sistemit të mbrojtjes, Forcat e Armatosura duhet të bëhen një forcë ushtarake moderne dhe e pajisur mirë; Forcat e Armatosura duhet të jenë themeli i interoperabilitetit me forcat e shteteve anëtare të NATO-s.</p> <p>Duhet të njihon se cilat elemente të industrisë së vet ushtarake duhen ruajtur dhe zhvilluar më tutje, dhe cilat të zhvillohen në bashkëpunim me partnerët e vet.</p> <p>Sistemi i mbrojtjes është i bazuar në parimet e kontrollit demokratik të Forcave të Armatosura dhe të transparencës së aftësive, planeve, programeve dhe resurseve mbrojtëse.</p>	<p>Mbrojtja e atdheut.</p> <p>Pjesëmarrja në operacionet e reagimeve ndaj krizave, përfshirë edhe operacionet e përkrahjes së paqes; asistimi i autoriteteve civile në reagimin ndaj katastrofave natyrore dhe emergjencave, përfshirë gatishmërinë për reagim rajonal apo ndërkombëtar; bën heqjen e pajisjeve eksplozive; dhe i asiston autoritetet civile në detyrat e operacioneve të mbrojtjes së qytetarëve.</p> <p>Standartet e NATO-s të interoperabilitetit dhe së fundi edhe anëtarësia.</p> <p>Kontributi për ndërtimin dhe mbrojtjen e stabilitetit rajonal dhe global.</p> <p>Përparimi dhe themelimi i sistemit mbrojtës të sigurisë kombëtare me kapacitetet e domosdoshme të sigurisë në fushat e diplomacisë, të shërbimeve të inteligjencës, mbrojtjes dhe sigurisë.</p> <p>Funksionimi i institucioneve të mbrojtjes dhe të sigurisë në konceptet e "përbashkëta," ndër-agjencionale dhe shumëkombëshe, me një pjesëmarrje të gjerë të kapaciteteve ushtarake dhe civile, si dhe të agjencive qeveritare dhe joqeveritare.</p>	<p>Mbrojtja dhe ruajtja e integritetit territorial dhe pavarësisë dhe zhvillimi i kapaciteteve për ta mbrojtur vendin.</p> <p>Zhvillimi i kapaciteteve të MM për menaxhimin e efektshëm të resurseve dhe proceseve mbrojtëse.</p> <p>Kompletimi, zhvillimi dhe mbajtja e kapaciteteve ushtarake të ARM.</p> <p>Integrimi në strukturën politike, mbrojtëse dhe ushtarake të NATO-s dhe pjesëmarrja në mbrojtjen kolektive të NATO-s.</p> <p>Pjesëmarrja dhe kontribuimi për Politikën Evropiane të Sigurisë dhe të Mbrojtjes.</p> <p>Ofrimi i kontributit të vazhdueshëm për përkrahjen e operacioneve për paqen ndërkombëtare.</p>	<p>Zhvillimi dhe mbajtja e kapacitetit të vet kredibil për ta ruajtur dhe mbrojtur sovranitetin dhe territorin e vet, hapësirën e vet ajrore dhe detare, dhe popullatën e vet kundër kërcënimeve dhe shfrytëzimit të forcës së një madhësie strategjike.</p> <p>Zhvillimi i kapaciteteve interoperabile për pjesëmarrjen në aktivitetet për përkrahjen e paqes në botë.</p> <p>Një nivel i gatishmërisë që mund t'i përshtatet zhvillimeve të ndryshme dhe forca interoperabile të afta për të vepruar bashkarisht me forcat e shteteve të tjera.</p> <p>Kontributi në ndërtimin e një mjedisi stabil të sigurisë.</p> <p>Zhvillimi i partneritetit dhe bashkëpunimit me vendet e tjera demokratike.</p> <p>Zhvillimi i aftësive që kërkohen për t'u bashkangitur NATO-s dhe UE-së.</p> <p>Implementimi i konceptit strategjik të mbrojtjes në mënyrën si në vijim:</p> <p>a) në paqe: përmes themelimit të partneriteteve dhe aleancave të sigurta si dhe duke dhënë kontribut në themelimin e një mjedisi më të favorshëm të sigurisë,</p> <p>b) në kohë lufte: përmes mbrojtjes së vendosur të territorit të vet, e përkrahur nga partnerët dhe aleatët.</p>	<p>Sistem efektiv i mbrojtjes,</p> <p>Paqe dhe një mjedis i favorshëm i sigurisë, dhe,</p> <p>Integrimi në strukturat evropiane dhe të tjera ndërkombëtare të sigurisë dhe pjesëmarrja në Programin e Partneritetit për Paqe të NATO-s.</p> <p>Sistem i efektshëm i mbrojtjes, paqes dhe mjedisit të favorshëm të sigurisë dhe integrimi në strukturat evropiane dhe të tjera ndërkombëtare të sigurisë.</p> <p>Transformimi dhe profesionalizimi i FAS. Ndërtimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të FAS.</p> <p>Reforma dhe ndërtimi i kapaciteteve të institucioneve të mbrojtjes civile.</p> <p>Menaxhimi i efektshëm i sistemit të mbrojtjes.</p> <p>Pjesëmarrja në operacionet shumëkombëshe që synojnë ndërtimin dhe mbajtjen e paqes në rajon dhe në mbarë botën, si dhe ofrimi i përkrahjes autoriteteve civile në luftimin e kërcënimeve të sigurisë, janë po ashtu aspekte domethënëse të angazhimit të resurseve mbrojtëse.</p>

Shqipëria	Bosnja dhe Hercegovina	Kroacia	Kosova	Maqedonia	Mali i Zi	Serbia
<p>Përkrahja e qëllimeve të politikave të jashtme të qeverisë, posaçërisht për integrimin e vendit në strukturat euroatlantike dhe promovimi i paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.</p> <p>Përkushtimet ndaj Konceptit dhe Strategjisë Evropiane të Sigurisë të CSDP-së.</p>	<p>Dëshiron të zhvillojë marrëdhënie partneriteti në fushat në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Komandimi dhe kontrollimi, përfshirë sistemet e komunikimit dhe të informimit, sistemet e navigimit dhe identifikimit, interoperabiliteti, procedurat dhe teknologjia; • Buxhetimi i planifikimit të mbrojtjes dhe menaxhmenti i resurseve, dhe; • Konceptet, planifikimi dhe aspektet operative të operacioneve për ruajtjen e paqes. <p>Është e gatshme të zhvillojë bashkëpunim në fushat e tjera, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Deminimi humanitar; • Edukimi, trajnimi dhe doktrina ushtarake; • Armët e vogla dhe të lehta; • Studimi i gjuhëve të huaja; • E drejta humanitare ndërkombëtare; • Planifikimi i emergjencave civile; • Politika dhe strategjia e mbrojtjes; • Gjeografia ushtarake; • Infrastruktura ushtarake; • Kontrollimi dhe menaxhimi i hapësirës ajrore, dhe • Lufta kundër terrorizmit, krimin të organizuar dhe trafikimit njerëzor. <p>Programet bilaterale dhe multilaterale të bashkëpunimit mbrojtës.</p>	<p>Qëllimet e kapaciteteve ushtarake:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vendosja e strukturës organizative dhe të personelit të FAK. 2. Pajisja e FAK me armatimin dhe pajisjet ushtarake të nevojshme. 3. Rritja e pjesëmarrjes në operacionet ushtarake ndërkombëtare. <p>Qëndrimet normative doktrinare:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vendosja e sistemit të synuar të trajnimit dhe edukimit. 2. Përshtatja e rregulloreve legjislative dhe të tjera për konceptin e ri të mbrojtjes, përvetësimi i dokumenteve të kërkuara doktrinare. <p>Qëllimet që synojnë në rritjen e efektshmërisë të FAK:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Plotësimi i FAK me vullnetarë (personel profesional ushtarak, ushtarë të trajnuar dhe anëtarë të rezervës me kontratë). 2. Arritja e vendosjes së planifikuar të njëjseve në objekte moderne. 3. Kujdesi i plotë për sifcitetin, për armatimin dhe pajisjet ushtarake të vjetëruara dhe me të meta. 	<p>Transformimi gradual i FSK-së në një organizatë me mision të mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës.</p> <p>Si një nga parimet bazë të një vendi demokratik, institucionet e sigurisë së vendit janë në pajtim me parimin e kontrollit civil dhe demokratik të autoriteteve ashtu siç është paraparë me Kushtetutë dhe me ligje si dhe me të gjitha aktet ligjore ndërkombëtare.</p>	<p>Ministria do t'i zhvillojë dhe do t'i rrisë kapacitetet e planifikimit civil-ushtarak për:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Politikën dhe planifikimin e mbrojtjes; – Komunikimet strategjike; – Zhvillimin e aftësive dhe të kapaciteteve; – Menaxhimin e resurseve njerëzore; – Vlerësimin dhe përgjegjësinë për rezultatet e arritura; – Përkrahjen e operacioneve ndërkombëtare; – Pjesëmarrjen në planifikimin mbrojtës të NATO-s; – Bashkëpunimin ndërkombëtar në mbrojtje dhe diplomacinë mbrojtëse. <p>Transformimin në organizata efektive, të efektshme dhe që funksionojnë siç duhet, të gatshme për t'u përballur me sfidat e shekullit 21.</p> <p>Zhvillimin, arritjen dhe vendosjen e kapaciteteve dhe të aftësive më të mëdha kombëtre stregegjike dhe operacionale, që synojnë arritjen e nivelit të duhur të iterooperabilitetit, të efikasitetit dhe të efektshmërisë dhe të fleksibilitetit me NATO-n, dhe me forcat e armatosura rajonale dhe partnere.</p> <p>Modernizimi i aftësive të mbrojtjes për kontrollimin komandues, për komunikime, kompjuterë dhe inteligjencë.</p>		<p>Përfshirja në aktivitetet e Politikës Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje</p> <p>Përfshirja në programin e Partneritetit për Paqe të NATO-s.</p> <p>Arritja e interoperabilitetit me sistemet mbrojtëse të shteteve anëtare në programin e Partneritetit për Paqe të NATO-s.</p> <p>Kapacitetet e elementeve të sistemit mbrojtës do të ndërrohen për t'i kryer obligimet në kuadër të Politikës Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje.</p> <p>Aplikimi i sistemit të mbrojtjes totale, përmes një angazhimi të aktorëve mbrojtës dhe të kapaciteteve mbrojtëse. Koncepti e vlerëson plotësisht nevojën për forcimin e partneritetit dhe të bashkëpunimit multilateral me vendet e tjera dhe organizatat dhe institucionet ndërkombëtare në mbrojtjen dhe ruajtjen e interesave të mbrojtjes.</p> <p>Varësisht nga tipat dhe intensitetit i sfidave, rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë, do t'i mbrojë interesat e veta mbrojtëse para së gjithash përmes përmbytjes, duke e shfrytëzuar një sistem mbrojtës të përbashkët dhe efektiv.</p>

Shqipëria	Bosnja dhe Hercegovina	Kroacia	Kosova	Maqedonia	Mali i Zi	Serbia
	<p>Kontributi për bashkëpunimin rajonal në Evropën Juglindore.</p> <p>Arranzhimet e veçanta (NATO, UE).</p> <p>Qëllimi përfundimtar i Sistemit të Menaxhimit të Resurseve të Përbashkëta Mbrojtëse është që ta arrijë shkallën më të lartë të sigurisë me koston më të ulët, ndërkohë që përdoren resurset e pakëta të mbrojtjes në një mënyrë të efektshme dhe efektive për nga kostoja për t'i adresuar ato detyra ushtarake që janë më kritiket për sigurinë e shtetit.</p>	<p>Niveli i parë i prioritetit (I): i jipet projekteve dhe detyrave që i ndikojnë drejtpërdrejt arritjet e aftësive kyçe operacionale të FAK për t'i përbushur misionet dhe detyrat.</p> <p>Niveli i dytë i prioritetit (II): i jipet projekteve dhe detyrave që, ose e përkrahin drejtpërdrejtë organizimin e angazhimit doktrinar, konceptual dhe normativ për FAK, ose e ndikojnë drejtpërdrejtë dinamikën dhe cilësinë e arritjes së aftësive ushtarake.</p> <p>Niveli i tretë i prioritetit (III): i jipet projekteve dhe detyrave që e ndikojnë rritjen e efikasitetit dhe shfrytëzimit racional të resurseve.</p>		<p>Transformimi i sistemit të menaxhimit të resurseve njerëzore për punësim, mbajtje dhe nxitje të personelit ushtarak dhe civil me kualifikim dhe përkushtim të lartë;</p> <p>Kontributi për operacionet në një spektër të gjerë të misioneve të udhëhequra nga KB, NATO dhe UE;</p> <p>Përshtatja dhe përmirësimi i trajnimit ashtu që të përbushen misioni, qëllimet dhe detyrat e ARM-së;</p> <p>Përmirësimi i infrastrukturës së mbrojtjes.</p>		<p>Një partneritet dhe bashkëpunim i besueshëm në ndërtimin e një mjedisi të favorshëm të sigurisë i kontribuon në mënyrë domethënëse mbrojtjes së interesave mbrojtëse dhe një mbrojtjeje të vendosur të kombit nga vetë forcat tona dhe me përkrahjen e partnerëve.</p>

MISIONET E FORCAVE TË ARMATOSURA

Shqipëria	Bosnja dhe Hercegovina	Kroacia	Kosova	Maqedonia	Mali i Zi	Serbia
<p>Të mbrojnë integritetin territorial të vendit, ta ndalojnë çdo pushtim të territorit të vendit dhe ta rivendosin kontrollimin e territorit dhe të kufijve kombëtarë.</p> <p>T'i bëjnë operacionet mbrojtëse kundër kërcënimeve, ta mbrojnë popullatën e vendit.</p> <p>Ofrimi i gatishmërisë luftarake për mbrojtje.</p> <p>Vëzhgimi dhe mbikëqyrja e detit, ajrit dhe hapësirës territoriale tokësore.</p> <p>Pjesëmarrja në operacionet e ndihmës humanitare në rastin e fatkeqësive apo katastrofave mjedisore në përkrahje të strukturave civile.</p> <p>Lufta kundër terrorizmit.</p> <p>Pjesëmarrja në operacionet e përkrahjes së paqes.</p> <p>Pjesëmarrja në bashkëpunimin e sigurisë në kohë paqeje (të përbashkëta, bilaterale, multilaterale, NATO/PfP).</p> <p>Parandalimi dhe menaxhimi i dëmit mjedisor.</p> <p>Mbrojtja e drejtpërdrejtë e popullatës në raste të kërcënimeve, incidenteve, aksidenteve, apo fatkeqësive natyrore dhe katastrofave mjedisore.</p> <p>Përkrahja e mbrojtjes së rendit kushtetues (përmes angazhimit në një rol të përkrahjes të strukturave civile) në luftën kundër trafikimit ilegal dhe terrorizmit.</p> <p>Parandalimi i trafikimit ilegal të armëve konvencionale (dhe të WMD).</p>	<p>Ta sigurojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të saj, pavarësinë politike, dhe personalitetin ndërkombëtar.</p> <p>T'i promovojnë qëllimet e politikës së jashtme të saj.</p> <p>T'i mbrojnë qytetarët e vendit.</p> <p>Ta bëjë trajnimin ushtarak për luftë dhe për format e tjera të mbrojtjes ushtarake.</p> <p>Ta sigurojë gatishmërinë për luftë.</p> <p>Ta ofrojë mbrojtjen ushtarake të shtetit në rast të sulmit.</p> <p>T'i asistojë autoritetet e mbrojtjes civile në reagimin ndaj fatkeqësive dhe aksidenteve natyrore.</p> <p>T'i përmbushë obligimet ndërkombëtare të vendit.</p>	<p>Mbrojtja e vendit dhe e aleatëve.</p> <p>Kontributi për sigurinë ndërkombëtare.</p> <p>Pjesëmarrja në operacionet e përkrahjes së paqes, në operacionet e reagimit ndaj krizave, në operacionet humanitare dhe në aktivitetet e tjera të jashtme.</p> <p>Ofrimi i asistencës në mbrojtjen e shteteve aleate në rast të sulmit të armatosur kundër njërit apo më shumë prej tyre në pajtim me marrëveshjet e arritura ndërkombëtare.</p> <p>Pjesëmarrja në përpjekjet e përbashkëta të Unionit Evropian, në frymën e solidaritetit nëse një anëtar është bërë viktimë e ndonjë sulmi terrorist apo e ndonjë fatkeqësie dhe e veprimtarive të shkaktuara nga njeriu.</p> <p>Asistimi i autoriteteve të institucioneve civile, i organizatave dhe agjencioneve të përpiluara për mbrojtje dhe shpëtim, dhe i popullatës në raste të fatkeqësive, të gjurmimit dhe shpëtimit, të transportit të të lënduarve apo të të vdekurve.</p> <p>Përkrahja e institucioneve civile.</p>	<p>Mbrojtja e sovranitetit dhe e integritetit territorial.</p> <p>Mbrojtja e qytetarëve, e pronës së tyre, dhe e interesave të vendit.</p> <p>Përkrahja e autoriteteve civile dhe e komuniteteve.</p> <p>Pjesëmarrja në operacionet e reagimeve ndaj krizave, përfshirë operacionet e përkrahjes së paqes.</p> <p>Kontributi për ndërtimin dhe mbrojtjen e stabilitetit rajonal dhe global.</p>	<p>Mbrojtja dhe ruajtja e integritetit territorial dhe e pavarësisë.</p> <p>Mbrojtja e popullatës nga kërcënimet e jashtme.</p> <p>Kontributi për mbrojtjen kolektive të NATO-s. Kontributi për një spektër të gjerë të operacioneve të përkrahjes së paqes të udhëhequra nga KB, NATO, UE apo koalicionet miqësore.</p> <p>Mbikëqyrja dhe mbrojtja e hapësirës ajrore kombëtare. Pjesëmarrja në arranzhimet ndërkombëtare (multilaterale, rajonale dhe bilaterale) për ruajtjen ajrore të hapësirës ajrore kombëtare.</p> <p>Përkrahja e policisë dhe e institucioneve të tjera shtetërore në mbrojtjen e infrastrukturës kritike kombëtare dhe në përkrahjen e trajtimit të pasojave në rast të ndonjë sulmi terrorist. Inteljencë dhe zbulim i efektshëm ushtarak në përkrahje të operacioneve e ekspeditës të ARM.</p> <p>Përkrahja e institucioneve shtetërore në rastin e fatkeqësive natyrore, të epidemive dhe të situatave të rrezikshme teknike-teknologjike dhe të atyre të krizave.</p>	<p>Mbrojtja e pavarësisë, e integritetit territorial dhe e sovranitetit të vendit.</p> <p>Arritja e nivelit të kërkuar të interoperabilitetit të forcave të veta me aleatët dhe partnerët.</p> <p>Përkrahja e kombit vendës.</p> <p>Pjesëmarrja në operacionet dhe misionet ndërkombëtare.</p> <p>Kontrolli i armëve në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare.</p> <p>Pjesëmarrja në bashkëpunimin ndërkombëtar ashtu që të zhvillohet besimi dhe partneriteti.</p> <p>Përkrahja e institucioneve civile në fatkeqësitë natyrore dhe të atyre të shkaktuara nga njeriu.</p> <p>Përkrahja e policisë në luftën kundër terrorizmit.</p> <p>Përkrahja e operacioneve për gjurmim dhe shpëtim.</p>	<p>Përmbajtja e kërcënimeve të armatosura.</p> <p>Përmbajtja e shkeljes së integritetit territorial.</p> <p>Mbrojtja e hapësirës ajrore.</p> <p>Pjesëmarrja në bashkëpunimin ushtarak ndërkombëtar.</p> <p>Pjesëmarrja në operacionet shumëkombëshe.</p> <p>Asistenca e autoriteteve civile në luftimin e kërcënimeve të brendshme të sigurisë, të terrorizmit, separatizmit dhe të krimeve të organizuara.</p> <p>Asistenca e autoriteteve civile në reagimin ndaj fatkeqësive natyrore, aksidenteve teknologjike dhe të fatkeqësive të tjera.</p>

2.3. Aftësitë ushtarake dhe buxhetet e mbrojtjes

Gjatë dekadës së fundit, forcat e armatosura të vendeve të rajonit kanë përjetuar një transformim rrënjësor si pasojë e integritimeve euro-atlantike, të natyrës së ndryshuar të kërcënimeve të sigurisë, si dhe të ambicjeve kombëtare të sigurisë. Forcat e armatosura të këtyre vendeve e kanë përvetësuar konceptin e ushtrive profesionale dhe kanë hequr dorë nga rekrutimi dhe doktrina e mbrojtjes territoriale e Luftës së Ftohtë. Pos kësaj, në pajtim me qëllimet e tyre të mbrojtjes, këto synojnë të arrijnë interoperabilitet me NATO-n, përkatësisht me vendet e Partneritetit për Paqe.

Nga aspekti i aftësive ushtarake, ka shpërputhje shumë të mëdha midis vendeve të rajonit sa i përket personelit, armatimit dhe buxheteve.²⁸ Në rajon, vetëm Kroacia dhe Serbia kanë aftësi ushtarake kredibile sa i përket mbrojtjes dhe kapaciteteve për të luftuar. Këto dy vende janë të vetmet që kanë aviacion ushtarak²⁹ dhe forca serioze të mbrojtjes kundërajrore dhe të asaj tokësore. Forcat ajrore të Shqipërisë, Bosnjës e Hercegovinës, Maqedonisë dhe Malit të Zi e kanë një numër modest të helikopterëve ushtarakë, dhe këto nuk kanë aeroplanë ushtarakë, ndërkohë që Kosova nuk ka, as helikopterë, dhe as aeroplanë ushtarakë. Sa i përket mbrojtjes kundërajrore, hapësira ajrore e Shqipërisë varet në tërësi nga NATO-ja, ndërsa hapësirat ajrore të vendeve të tjera janë praktikisht të pambrojtura. I njëjti model mund të haset edhe në forcat tokësore të vendeve të rajonit: Shqipëria dhe Mali i Zi i kanë kapacitetet më të vogla, ndërsa Kosova këto nuk i ka fare.³⁰

Sa i përket buxheteve mbrojtëse,³¹ Kroacia e ka buxhetin më të lartë në rajon, dhe kjo planifikon që këtë ta rrisë në dy vitet e ardhshme (nga 609,49 në 624,23 milionë €). Buxheti mbrojtës i Serbisë është i dyti, dhe planifikohet që ky të rritet në vitin 2015 (nga 495,00 në 501,14 milionë €). Buxhetet mbrojtëse të Kroacisë dhe të Serbisë, si të veçantë, janë më të lartë se të gjitha buxhetet mbrojtëse të të gjitha vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor së bashku. Këto dy vende janë mbizotëruese në rajon sa i përket shpenzimeve mbrojtëse dhe aftësive ushtarake dhe këto mund ta kundërbalancojnë njëra-tjetrën. Vendet e tjera të rajonit nuk kanë kapacitete individuale për t'u shtyrë me këto dyjat në ndonjë të ardhme të parashikueshme.

Pas Kroacisë dhe Serbisë, Maqedonia është në vendin e tretë sa i përket shpenzimit për mbrojtje, dhe kjo e ka planifikuar rritjen më të madhe të buxhetit për dy vitet e ardhshme (nga

²⁸ Shih Tabelat: Aftësitë Ushtarake dhe Buxhetet e Mbrojtjes.

²⁹ *The Military Balance 2014*, International Institute for Strategic Studies, London, Janar 2014, fq. 132-133 "Serbia e ka në shërbim një numër të vogël aeroplanësh luftarakë, dhe ka synuar ta sigurojë një ose dy skuadronë të tipave modernë të roleve të shumëfishta. Shtrëngimet në fonde kanë bërë që këto projekte të shtyhen. Shërbimi i tyre dhe disponueshmëria e platformës do të jenë probleme për forcat ajrore."

³⁰ *Ibid.*

³¹ Shih Tabelën: Buxhetet e Mbrojtjes.

156,06 në 202,95 milionë €). Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Kosova kanë planifikuar rritje të vogla të buxheteve të tyre të mbrojtjes (nga 147,04 në 150,15, nga 43,14 në 47,21, dhe nga 42,03 në 45,50 milionë €, përkatësisht), ndërkohë që Shqipëria planifikon që buxhetin e vet mbrojtës ta mbajë në të njëjtin nivel (101,75 milionë €), pavarësisht nga aftësitë e saj tejet të kufizuara ushtarake.


Sa i përket buxhetit të planifikuar për kokë banori, Kroacia është vendi udhëheqës në rajon, dhe kjo vijohet nga Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Shqipëria, Bosnja e Hercegovina dhe Kosova. Përkundrajt pritjeve, buxhetet e planifikuara të mbrojtjes, si vlerë për kokë banori, për Shqipërinë dhe Kosovën nuk shkojnë me ambicjet e tyre mbrojtëse. Shpenzimi i planifikuar mbrojtës i Shqipërisë, si një anëtare e re e NATO-s, është i vogël dhe nuk ofron perspektivë të forcimit të aftësive të saj ushtarake.

Projeksionet e shpenzimeve mbrojtëse të Kosovës janë simbolike dhe nuk u përgjigjen nevojave të transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forcat e Armatosura të Kosovës, duke e dhënë kështu përshtypjen e një simbolike politike, në vend se atë të ndërtimit të kapaciteteve ushtarake në pajtim me interesat kombëtare dhe me ambicjet mbrojtëse të vendit. Prandaj, krijimi i Forcave të Armatosura të Kosovës nuk do ta ketë ndonjë rol domethënës sa i përket balancit rajonal ushtarak, dhe si i tillë nuk e paraqet ndonjë kërcënim ushtarak për cilindo nga fqinjët e Kosovës.


AFTËSITË USHTARAKE					
Shteti	Popullata	Forcat aktive	Forcat rezervë	Njësitë kryesore tokësore	Njësitë kryesore ajrore
Shqipëria	3,011,405	14,250		Forcat speciale 1 rgt lft Manovruese E lehtë: 1 (reagim i shpejtë) bgd lht kmb Përkrahja në luftë 1 btn art, 1 bgd lft, 1 spec intl Përkrahja e shërbimeve të luftës 1 btn logj	Helikopterë 5 AS-532AL 6 helikopterë të lehtë AS-532 7 helikopterë Bell-205/UH-1H 7 helikopterë të lehtë Bell-206/OH-58
B&H	3,875,723	10,500		Manovruese E lehtë: 3 bgd kmb (1 nj zbl, 3 btn kmb, 1 btn art) Përkrahja e luftës 1 bgd prkr lft (1 btn tk, 1 btn inxh, 1 EOD btn, 1 btn kmb, 1 MP btn), 1 EOD btn, 1 CBRN coy Përkrahja e shërbimeve të luftës 1 kmd logj (5 btn logj)	Helikopterë 1 skdr me Bell, me Bell 205; Mi-17 Hip H 1 skdr me Mi-8 Hip; Mi-8MTV Hip 1 skdr me Mi-8 Hip; SA342H/L Gazelle (HN-42/45M) Mbrojtja kundërajrore 1 AD btn
Kroacia	4,475,611	16,550		Forcat speciale 1 SF btn Manovruese E blinduar: 1 bgd blnd E lehtë: 1 bgd mot kmb Të tjera: 1 rgjmt kmb cak Përkrahja e luftës 1 regj art/MRL, 1 rgjm AT, 1 rgjm ADA 1 rgjm inxh, 1 btn int, 1 MP rgjm, 1 btn NBC, 1 rgjm spec intl Përkrahja e shërbimeve të luftës 1 rgjt logj	Luftues/Sulme ndaj tokës 1 skdr (përz) me MiG-21bis/UMD Fished Transportues 1 skdr me An-32 Cline Trajnues 1 skdr me PC-9M; Z-242L 1 skdr hel me Bell 206B Jet Ranger II Lufta kundër zjarrit 1 skdr me AT-802FA Fire Boss; CL-415 Helikopterë transportues 2 skdr me Mi-8MTV Hip H; Mi-8T Hip C; Mi-171Sh
Kosova	1,859,203	2,500	800		
Maqedonia	2,087,171	8,000	4,850	Forcat speciale 1 (Për qëllime speciale) SF regt (1 btn SF, 1 btn Ranger) Manovruese E blinduar: 1 btn tk E mekanizuar: 1 bgd mek kmb Përkrahja e luftës 1 (mixed) rgjmt art, 1 nj AD 1 btn inxh, 1 btn MP, 1 nj NBC, 1 btn spec intl	Transportues 1 skdr (VIP) me An-2 Colt Trajnues 1 skdr me Bell 205 (UH-1H Iroquois) 1 skdr me Z-242 Helikopterë sulmues 1 skdr me Mi-24K Hind G2; Mi-24V Hind E Helikopterë transportues 1 skdr me Mi-8MTV Hip; Mi-17 Hip
Mali i Zi	653,474	2,080		Forcat speciale 1 bgd SF Manovruese Gjurmuese 1 nj zbl E lehtë: 1 bgd mot kmb (1 nj SF, 2 rgjmt kmb (1 btn kmb, 1 btn mal), 1 bat art, 1 nj prkr lft, 1 pl KBRN, 1 pln int) Përkrahja e luftës 1 nj inxh 3 pln int 1 nj MP	Trajnues 1 skdr (përz) me G-4 Super Galeb; Utva-75 (jo-operacional) Helikopterë transportues 1 skdr me SA341/SA342L Gazelle

Serbia	7,243,007	28,150	50,150	<p>Forcat speciale 1 bgd SF (1 btn CT, 1 btn kom, 1 btn prsht, 1 btn logj)</p> <p>Manovruese E mekanizuar 1 bgd (e para) (1 btn tk, 2 btn mek kmb, 1 btn kmb, 1 btn art SP, 1 btn MRL, 1 btn AD, 1 btn inxh, 1 btn logj) 3 bgd (e dyta, e treta & e katërta) (1 btn tk, 2 btn mek kmb, 2 btn kmb, 1 btn art SP, 1 btn MRL, 1 btn AD, 1 btn inxh, 1btn logj)</p> <p>Përkrahja e luftës 1 bgd art (përz) (4 btn art, 1 btn MRL, 1 btn prkr) 2 btn prkr urëzues 1 btn NBC 1 btn spec int 2 btn MP</p>	<p>Luftues 1 skdr me MiG-21 bis Fishbed; MiG-29 Fulcrum</p> <p>Luftues/Sulme ndaj tokës 1 skdr me G-4 Super Galeb*; J-22 Orao; Isr; 2 flt me IJ-22 Orao 1*; MiG -21R Fishbed H*</p> <p>Transportues 1 skdr me An-26; Do-28; Yak-40 (Jak-40); 1 PA-34 Seneca V</p> <p>Trajnues 1 skdr me G-4 Super Galeb* (caqe/sulm tok); SA341/342 Gazelle; Utva-75 (caqe bazike)</p> <p>Helikopterë sulmues 1 skdr me SeA341/342L Gazelle; (HN-42/45); Mi-24 Hind</p> <p>Helikopterë transportues 2 skdr me Mi Hip; Mi-17 Hip H</p> <p>Mbrojtja kundërajrore 1 bde (5bn) 2msl, 3SP msl) me S-125 Neva (SA-3 Goa); 2K12 Kub (SA-6 Gainful); 9K32 Strela-2 (SA-7 Grail); 9K310 Iгла - 1 (SAP-16 Gimlet) 2 btn radar (për paralajmërim dhe raportim të hershëm)</p> <p>Përkrahja e luftës 1 spec int</p> <p>Përkrahja e luftës 1 btn mrrmb</p>
---------------	-----------	--------	--------	---	--

BUXHETET E MBROJTJES						
Vendi	2014		2015		2016	
	Buxheti i mbrojtjes (milionë €)	Buxheti i mbrojtjes për kokë banori (€)	Buxheti i mbrojtjes (milionë €)	Buxheti i mbrojtjes për kokë banori (€)	Buxheti i mbrojtjes (milionë €)	Buxheti i mbrojtjes për kokë banori (€)
Shqipëria	101.75	33,69	101.75	33,69	101.75	33,69
BeH	147.04	37,98	148.82	38,44	150.15	38,78
Kroacia	609.49	136,34	613.77	137,29	624.53	139,70
Kosova	42.03	22,61	44.00	23,67	45.50	24,47
Maqedonia	156.06	74,61	180.73	86,40	202.95	97,03
Mali i Zi	43.14	66,37	45.84	70,52	47.21	72,63
Serbia	495.00	68,66	501.14	69,51	472.97	65,60



Buxheti i mbrojtjes (milionë €)



Buxheti i mbrojtjes për kokë banori (milionë €)

2.4. Industrinë e mbrojtjes dhe eksportet dhe importet ushtarake

Në këtë pjesë do t'i analizojmë industrinë e mbrojtjes, si dhe eksportet e importet ushtarake, të vendeve të Ballkanit Perëndimor, me qëllim që ta fitojmë një pamje gjithëpërfshirëse të njohurive të tyre në prodhimin e armatimit ushtarak, si dhe të aftësive të tyre eksportuese në këtë lloj profesioni. Po ashtu, shqyrtimi i importeve ushtarake ka për qëllim ta japë një pamje të 'orientimit politik' të vendeve individuale të rajonit lidhur me furnizimin me armatim ushtarak.

Serbia është deri më tash vendi udhëheqës në industrinë e mbrojtjes, dhe kjo prodhon një brez të gjerë të armatimit ushtarak, përfshirë sistemet raketore, armatimin artilerik, granatahedhësit, aeroplanët trajnues ushtarak, dhe kjo ka kapacitete për riparim kapital të aeroplanëve MIG 21, MIG 29, Galeb, Super Galeb dhe Orao, si dhe të aeroplanëve transportues dhe të helikopterëve (të lehtë dhe transportues).³² Kroacia ka zhvilluar një industri mbrojtëse që kryesisht i mbulon nevojat e forcave të veta të armatosura, dhe kjo prodhon një brez më të ngushtë të armatimit në krahasim me Serbinë. Sidoqoftë, kjo ka kapacitete vendëse për të prodhuar, mes tjerash, raketa kundërajrore, sisteme informatike dhe naviguese të fushëluftës, mbrojtje ballistike, tanke luftarake, sisteme raketore shumëtytëshe, granatahedhës, dhe anije ushtarake.³³ Maqedonia dhe Bosnja e Hercegovina kanë kapacitete fare të kufizuara të industrisë mbrojtëse, ndërkohë që kapacitetet e Shqipërisë janë simbolike, dhe Kosova të tilla nuk ka fare.³⁴

Serbia është vendi udhëheqës i rajonit edhe në eksportet ushtarake. Kjo i ka trashëguar pjesërisht konsumatorët e ish-Jugosllavisë socialiste, dhe armatimet e prodhuara nga ajo në ditët e sotme shfrytëzohen edhe nga misionet e NATO-s, si ai në Afganistan.³⁵ Eksportet ushtarake të vendeve të tjera të rajonit janë simbolike, dhe këto janë më parë rezultat i shitjes së armatimit dhe të pajisjeve të shfrytëzuara, se sa i kapaciteteve të industrive të tyre ushtarake.³⁶

Importet ushtarake të vendeve individuale të rajonit kanë modele të ndryshme.³⁷ Importet ushtarake të Shqipërisë vijnë kryesisht nga vendet e NATO-s, Bosnja e Hercegovina importon nga vende të ndryshme, që nga Kina, Rusia e Lindja e Mesme, e deri te SHBA-të, importet kroate dhe maqedonase vijnë kryesisht nga vendet e NATO-s/UE-së, por, po ashtu, edhe nga vendet e ish-blokut sovjetik, ndërkohë që armatimi që e importon Serbia vjen kryesisht nga

³² Shih Tabelën: Industria Mbrojtëse.

³³ *Ibid.*

³⁴ *Ibid.*

³⁵ BBC Ne#s: Serbia arms industry boom time detonates NATO debate [Koha e shpërthimit të industrisë së armatimit të Serbisë e shpërthen dëbimin mbi NATO-n], <http://www.bbc.com/news/world-europe-13731608>, 10 June 2011.

³⁶ Shih Tabelën: Eksportet Ushtarake 1992-2013

³⁷ *Ibid.*

Rusia dhe Ukraina. Nuk ka dëshmi të regjistruara të çfarëdo armatimi të importuar nga Kosova dhe Mali i Zi.

Prandaj, mund të përfundohet që, sa i përket industrive mbrojtëse dhe eksporteve ushtarake, Serbia është, deri më tash, vendi udhëheqës në Ballkanin Perëndimor. Kroacia qëndron menjëherë pas Serbisë në industrinë mbrojtëse, por kjo ka eksporte mjaft të kufizuara ushtarake, Bosnja e Hercegovina, Maqedonia dhe Mali i Zi kanë industri mbrojtëse të vogla dhe eksporte ushtarake simbolike, dhe industria mbrojtëse dhe eksportet e Shqipërisë janë simbolike. Kosova nuk e ka asnjërin nga këto kapacitete, dhe aftësitë e saj janë inekzistente.

Importet ushtarake të vendeve të Ballkanit Perëndimor janë rezultat i trashëgimive të tyre të luftrave për pavarësi të dekadës së fundit të shekullit 20, si dhe të qasjeve të tyre ndaj anëtarësimit në NATO. Shqipëria dhe Kroacia kanë qenë të orientuara kryesisht kah tregjet ushtarake të vendeve Perëndimore. Bosnja e Hercegovina e ka një historik të importeve ushtarake që vijnë që nga Lindja e Mesme, e deri te SHBA-të dhe Rusia. Maqedonia forcat e veta të armatosura i ka furnizuar nga vendet Perëndimore dhe Ukraina, ndërsa importet ushtarake të Serbisë vijnë kryesisht nga ish vendet e ish-Bashkimit Sovjetik. Kosova dhe Mali i Zi nuk kanë importe të regjistruara ushtarake.

INDUSTRIA E MBROJTJES

Shqipëria	Bosnja dhe Hercegovina	Kroacia	Maqedonia	Mali i Zi	Serbia
<p>Pistoleta të tipit "Makarov Parabellum" të kalibrit 19 mm.</p> <p>Prodhimi i shërbimeve për industrinë e mbrojtjes me makinat e veta të precizitetit të lartë; riparimi, trajtimi me nxemje dhe emalimi i sipërfaqeve.</p> <p>Dinamit</p> <p>Municion</p> <p>Barut i zi</p> <p>Kapsolla të sigurisë</p> <p>TNT</p> <p>DNT</p> <p>RDX</p> <p>Shtytësa (NG/NC) me baza të vetme dhe çifte Nitrocelulozë.</p>	<p>Fishekë 40 mm.</p> <p>Kapsolla</p> <p>Granata dore</p> <p>Perkusion i pushkëve dhe kapsolla elektrike</p> <p>Mina anti-tanke</p> <p>Pushkë dhe obusë</p> <p>Mortaja, pushkë me prapsje</p> <p>Raketahedhës</p> <p>Pushkë automatike</p> <p>Të gjitha llojet e kapsollave me goditje për municionin e armëve të lehta, kapsolla, helmeta dupleks dhe me çartje, elemente të vonesës, kapsolla elektrike për fuza, fishekzjarre elektrike, ndezës, tipa të ndryshëm të eksplozivëve ndezës dhe të municionit kimik.</p> <p>Sharzherë municioni për armë të lehta 5.56 – 7.9 mm.</p> <p>Municion të kalibrit 12.7 mm.</p> <p>Municion për gjueti dhe sportiv.</p> <p>Ndërlidhje metalike për municion.</p> <p>Municion mortajash, municion artilerik.</p> <p>Municion tankist dhe anti-tankist.</p> <p>Raketa</p> <p>Municion për armë të këmbësorisë</p> <p>Bomba ajrore</p> <p>Riparimi i makinave dhe veglave.</p>	<p>Pajisje shenjimi</p> <p>Mirëmbajtje aeroplanësh</p> <p>Municion</p> <p>Raketa kundërajrore</p> <p>Bartës të blinduar personal</p> <p>Asistues digjital të artilerisë</p> <p>Sisteme kontrolluese të zjarrit artilerik</p> <p>Çanta ushtarake</p> <p>Mbrojtje ballistike</p> <p>Sisteme informatike dhe të navigimit të fushëbetejës.</p> <p>Zgjidhje komunikuese</p> <p>Makina për deminim</p> <p>Pajisje zhytëse</p> <p>Pajisje elektrike</p> <p>Caqe fluturuese</p> <p>Fuza</p> <p>Shërbime gjeoinformatike</p> <p>Granatahedhës</p> <p>Granata dore</p> <p>Helmeta</p> <p>Tanke luftarake</p> <p>Anije ushtarake</p> <p>Konsola multifunktionale</p> <p>Sisteme raketore shumëtytëshe</p> <p>Mbrojtja NBK</p> <p>Dylbi nate</p> <p>Revole</p> <p>Radio transmetues</p> <p>Aktivizues lazerik të minave të largëta</p> <p>Mitrolozë</p> <p>Anije gjurmuese dhe të shpëtimimit</p> <p>Simulatorë</p> <p>ATGW</p> <p>Simulues fluturimi</p> <p>MANPADS</p> <p>Softuer, siguruës të IT-së.</p> <p>Mjete ajrorje pa njerëz.</p>	<p>Pajisje të mbrojtjes balistike për mbrojtje personale balistike të tilla si:</p> <p>helmeta balistike, jelekë balistike, pllaka balistike, mburoja balistike dhe pajisje të tjera të ngjashme.</p> <p>Raketahedhës të kalibrave të ndryshëm të tillë si: 64 mm, 90 mm dhe 120 mm.</p> <p>Raketahedhës</p> <p>Helmeta balistike</p> <p>Maskë helmetash</p> <p>Jelekë balistike</p> <p>Pllaka balistike</p> <p>Mburoja balistike</p> <p>Mburoja transparente (Antinot)</p> <p>Çanta bartëse balistike</p> <p>Kuti të bashkangjitura balistike</p> <p>Thasë fjetjeje</p> <p>Mburojë e shuarjes së shpërthimit dhe unaza përmbytëse të shpërthimit</p> <p>Gëzhoja mortajash</p> <p>Magazina të pushkëve automatike 7.62 (Kalashnikov)</p> <p>Bajoneta</p> <p>Shkopinj</p> <p>Pajisje shtesë</p> <p>Hermelin TM 170</p> <p>Humvee - HMMÉV M1114</p>	<p>Sisteme elektronike dhe telekomunikuese</p> <p>Piro-fishekë</p> <p>Makina raketore</p> <p>Detonatorë</p> <p>Industri metalike</p> <p>Galvanizimi dhe shtypja</p> <p>Eksplzivë jo-ushtarakë</p> <p>Fuza dhe elektrodetonatorë</p> <p>Hidraulikë dhe pneumatikë, pompa, distributorë të valvuleve.</p>	<p>Artileri fillestare, klasike, dhe sisteme të reja raketore, armatim për tregun civil dhe për paraprocesimin material.</p> <p>Të gjithë tipat e nitro-celulozave, të barutit për pushkë, mbushje baroti, nitroglicerinë dhe të përzierjeve të fuqishme.</p> <p>TNT</p> <p>Oktoqjen</p> <p>Eksplzivë ANFO</p> <p>Antifriz dhe metil-ester</p> <p>Makina çitëse, ushtruese, të nënkalibrit artilerik dhe të municionit "ekologjik".</p> <p>Municion aeroplanësh, kundërajror, tankesh dhe artilerik.</p> <p>Granatahedhës si dhe armatim për tregun civil</p> <p>Armë automatike të kailbrave 5.56 dhe 7.62 mm</p> <p>Granatahedhës</p> <p>Pushkë snajperike</p> <p>Mitrolozë</p> <p>Topa të kalibrit 20 dhe 30 mm.</p> <p>Zhvillimi i pushkëve gjysmëautomatike snajperike, të mitrolozëve të rëndë dhe të granatahedhësve të nënkalibrit në kalibrin e NATO-s.</p> <p>Riparimet kapitale të aeroplanëve supersonikë MIG-21 dhe MIG-29, aeroplanëve reaktivë Super Galeb, Galeb dhe Orao, të aeroplanëve transportues AN-26, AN-2, të aeroplanit me pistonë Utva-75, të helikopterëve të lehtë Gazela dhe Mi-2, të helikopterëve transportues Mi-8.</p> <p>Riparimi kapital i makinave me pistonë, me turbo-helikë dhe me turbo-bosht; i makinave OTO dhe atyre dizel; riparimi i mesëm i sistemeve raketore KUB dhe NEVA; riparimi i mesëm i sistemeve radarike PRV-16, P-12, P-15; riparimi i raketave V-V: R-3R, R-13M, R-60M/MK, R73E, R-27, AGM65B.</p> <p>Mirëmbajtja teknike dhe riparimi i armatimit dhe i pajisjeve ushtarake, përfshirë sistemet, gjeneratorët dhe pajisjet e duhura të ndërlidhura.</p> <p>Riparimi i mjeteve luftarake: makinave me shiritë hekuri apo me rrota, i armëve artilerike dhe raketore, i armëve të vogla, i mjeteve të komunikimit, i pajisjeve optike dhe optoelektronike, i rezervave të energjisë dhe i teknikës raketore.</p> <p>Lasta 95</p> <p>Cobac</p>

EKSPORTET USHTARAKE

Shqipëria	Bosnja e Hercegovina	Kroacia	Mali i Zi	Serbia
<p>Burkina Faso : 12 mortaja M-43 120mm</p>	<p>Afghanistan : 60 mitrolozë të bartur D-30 122mm</p> <p>Cameroon : 31 vetura të blinduara AML-60/90</p>	<p>Guinea : 40 mortaja UBM-52 120mm</p>	<p>Armenia : 16 mitrolozë të bartur D-30 122mm</p> <p>Egypt : 70 raketa anti-anije P-15M/SS-N-2C Styx 5 FAC Project-205/Osa</p> <p>Serbia : 16 SPAAG BOV-3 6 aeroplanë trajnues/luftarak G-4 Super Galeb</p>	<p>Bangladesh : 18 mitrolozë të vetë-lëvizur B-52 NORA 155mm</p> <p>Myanmar : 30 mitrolozë të vetë-lëvizur B-52 NORA 155mm 36 mitrolozë të bartur M-101A1 105mm 54 mitrolozë të bartur M-56 105mm</p> <p>Cambodia : 60 tanke T-55</p> <p>Ethiopia : 64 mitrolozë të bartur D-30 122mm</p> <p>Iraq : 20 aeroplanë të lehtë Lasta-95</p> <p>Sudan : 12 aeroplanë të lehtë Utva-75</p> <p>Pakistan IFV</p>

IMPORTET USHTARAKE

Shqipëria	Bosnja dhe Hercegovina	Kroacia	Maqedonia	Serbia
<p>Kina : 1 sistem për mbrojtjen e bregdetit HY-2 CDS 15 raketa anti-anije HY-2/SY-1A/CSS-N-2</p> <p>Franca : 5 helikopterë AS-532AL</p> <p>Gjermania: 6 helikopterë të lehtë AS-532</p> <p>Italia : 7 helikopterë Bell-205/UH-1H 7 helikopterë të lehtë Bell-206/OH-58</p>	<p>Kina : 10 shkatërrues tankesh WZ-91/Type-92 300 raketa anti-tanke Red Arrow-8</p> <p>Egjypti : 10 tanke T-55 12 mitrolozë të bartur D-30 122mm 12 mitrolozë të bartur M-46 130mm</p> <p>Irani : 1 lansues mobil SSM Nazeat N-10</p> <p>Katari : 25 makina për luftimin e këmbësorisë AMX-10P</p> <p>Rumania : 18 MRL APR-40 122mm të vetëlëvizura 8 mitrolozë të bartur M-46 130mm</p> <p>Rusia : 1 helikopter i lehtë Mi-34S/Hermit</p> <p>Emiratet e Bashkuara Arabe : 41 makina të blinduara AML-60/90 36 tanke AMX-30B 36C mitrolozë të bartur Model-56 105mm</p> <p>SHBA : 15 helikopterë Bell-205/UH-1H 80 APC M-113</p>	<p>Republika Çeke : 5 aeroplanë trajnues Z-142/Z-242L</p> <p>Finlanda : 126 APC AMV 2 FAC Helsinki</p> <p>Norvegjia : 80 APC Kupola mbrojtëse</p> <p>Rusia : 30 helikopterë Mi-8MT/Mi-17/Hip-H</p> <p>Suedia : 126 makina dizel (AV) DI-12</p> <p>Kanadaja : 20 turbopropë PT-6</p> <p>Italia : 10 APV M-65E LMV 4 radarë gjurmues deti Falcon-2</p> <p>Kirgistani : 4 aeroplanë luftarakë MiG-21PFM/ Fishbed-F</p> <p>Gjermania : 25 makina dizel BT-6L</p> <p>Polonia : Aeroplanë luftarakë</p> <p>Zvicra : Aeroplanë trajnues</p> <p>Bashkimi Sovjetik 1 AK-630 30 mm</p> <p>Ukraina 5 MiG- 21 bis/Fishbed-N</p> <p>SHBA 10 helikopterë të lehtë</p> <p>Vende të panjohura 2 Aeroplanë transportues 5 Helikopterë luftarakë 10 Helikopterë luftarakë 100 Raketa anti-tanke 10 SAM 50 Raketa anti-tanke</p>	<p>Bullgaria : 94 tanke T-55 8 mitrolozë të bartur D-20 152mm 108 mitrolozë të bartur M-30 122mm</p> <p>Franca : 62 raketa anti-tanke MILAN 20 radarë tokësorë RATAC</p> <p>Republika Çeke : 4 aeroplanë trajnues Z-142/Z-242L</p> <p>Gjermania : 60 APC BTR-70 115 APC TM-170 Hermelin</p> <p>Greqia : 2 helikopterë Bell-205/UH-1H 10 APC 4K-7FA</p> <p>Irlanda : 4 helikopterë të lehtë Bell-206/OH-58</p> <p>Ukraina : 4 sisteme mobile SAM Strela-10/SA-13 12 helikopterë luftarakë Mi-24V/Hind-E 4 aeroplanë për sulme në tokë Su-25/Frogfoot-A 4 helikopterë Mi-8MT/Mi-17/Hip-H 22 APC BTR-80 11 makina për luftimin e këmbësorisë BMP-2 31 tanke T-72 6 MRL BM-21 Grad 122mm të vetëlëvizura 100 SAM Strela-10/SA-13 Gopher</p> <p>Kazakistani : 12 APC BTR-80</p> <p>Rusia : 4 helikopterë Mi-8MT/Mi-17/Hip-H</p> <p>Italia : 30 APC M-113</p> <p>Serbia : 22 mortaja UBM-52 120mm</p> <p>SHBA : 1 helikopter Bell-412 1 aeroplan i lehtë Cessna-337/O-2 1 APV UMMWV i blinduar 36 mitrolozë të bartur M-101A1 105mm</p>	<p>Kazakistani : 226 SAM Igla-1/SA-16 Gimlet portable</p> <p>Mali i Zi : 16 SPAAG BOV-3 6 aeroplanë trajnues/luftarakë G-4 Super Galeb</p> <p>Ukraina : 2 helikopterë luftarakë Mi-24V/Hind-E 2 helikopterë Mi-8MT/Mi-17/Hip-H 31 tanke T-72</p> <p>SHBA : 1 aeroplan i lehtë transportues PA-34 Seneca</p> <p>Rusia : 2 helikopterë Mi-8MT/Mi-17/Hip-H 650 raketa anti-tanke 9M14M/AT-3 Sagger 150 SAM Strela-2/SA-7 Grail portable</p>

2.5. Bazat ushtarake

Të gjitha vendet e rajonit kanë rrjete të zhvilluara mirë të bazave/kazermave ushtarake të forcave tokësore.³⁸ Po ta shikojmë shpërndarjen gjeografike të këtyre bazave, do të shohim që, në rastin e Kroacisë, këto janë më të përqendruara kah Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, dhe që ato të Serbisë janë më të përqendruara kah Kosova dhe Bosnja e Hercegovina. Vendet e tjera nuk kanë ndonjë përqendrim të veçantë të bazave ushtarake kah fqinjët e tyre.

Sa i përket bazave ajrore,³⁹ Kroacia dhe Serbia i kanë kapacitetet më të larta në rajon dhe këto janë të shpërndara shumë mirë nga aspekti strategjik. Pas tyre është Maqedonia, që vijohet nga Bosnja e Hercegovina dhe Shqipëria.⁴⁰ Kosova e ka një bazë ajrore kryesore në Prishtinë, dhe një rezervë në Gjakovë,⁴¹ dhe këto aktualisht janë duke u shfrytëzuar nga KFOR-i. Sa i përket bazave detare, Kroacia është vendi udhëheqës në rajon, dhe kjo vijohet nga Shqipëria dhe Mali i Zi. Edhe Kroacia, edhe Serbia e kanë nga një bazë lundruese lumore.⁴²

Është interesante që një e treta e bazave të forcave tokësore të Serbisë janë të përqendruara në rrethinën e Kosovës, dhe që dy nga to janë në zonën e gjerë të Luginës së Preshevës. Kjo është jo vetëm e rrezikshme, por edhe ironike, jo vetëm kur të merret parasysh e kaluara e përfshirjes së institucioneve të sigurisë së Serbisë në Kosovë, por, po ashtu, edhe ngulmimi i saj që Forcat e Sigurisë së Kosovës të mos vendosen në komunat veriore të saj. Pos kësaj, një çështje tejet brengosëse është ajo e Qendrës së Përbashkët Serbo-Ruse për Reagim ndaj Situatave të Emergjencës, që është themeluar në tetor të vitit 2011.⁴³ Kjo Qendër është e para e këtij lloji që Rusia e ka hapur në Evropë pas Luftës së Ftohtë. Me deklarata, kjo Qendër planifikohet të shndërrohet në një qendër rajonale për t'i menaxhuar reagimet ndaj katastrofave natyrore dhe teknologjike,⁴⁴ mirëpo, sipas Kryeministrit të atëhershëm, Daçiq, po ashtu, edhe ato ndaj terrorizmit.⁴⁵ Kjo bazë mund ta luajë, po ashtu, edhe rolin e sigurimit të gypave të gazit të Rrjedhës Jugore të Rusisë, që planifikohet të kalojnë përmes Serbisë, në afërsi të qytetit të Nishit.⁴⁶ Këtu ia vlen të nënvizohet që 51% e Rrjedhës Jugore Serbia është në pronësi të Gazpromit, dhe 49% në pronësi të Srbijagas-it.⁴⁷

³⁸ Shih Hartën: Bazat e forcave tokësore.

³⁹ Shih Hartën: Bazat e forcave ajrore dhe detare.

⁴⁰ *Ibid.*

⁴¹ *Ibid.*

⁴² *Ibid.*

⁴³ EurActive: Russia Opens "Humanitarian base", 18 tetor, 2011,

<http://www.euractiv.com/enlargement/russia-opens-humanitarian-base-s-news-508382>

⁴⁴ Balkanopen report: No Russian Military Base in Serbia, 18 tetor, 2011

<http://www.balkanopen.com/article.php?id=365>

⁴⁵ <http://www.srbija.gov.rs/vesti/vest.php?id=60064>

⁴⁶ Gazprom South Stream, <http://www.gazprom.com/about/production/projects/pipelines/south-stream/>

⁴⁷ *Ibid.*

Për më tepër, ambicjet ruse për të vendosur prani të veten ushtarake, nuk janë të kufizuara vetëm në Serbi. Në mesin e dhjetorit 2013, Rusia kërkoi nga Mali i Zi që ta themelonte bazën e vet detare në portin e Tivarit. Për dallim nga Beogradi, Podgorica e refuzoi kërkesën e Kremlinit,⁴⁸ pavarësisht nga varësia e saj e konsiderueshme ekonomike nga Rusia. Për më tepër, Rusia është duke i shfrytëzuar marrëdhëniet e trazuara etno-nacionale të rajonit dhe dobësitë e shteteve që nuk janë anëtare të plota të Unionit Evropian dhe të NATO-s, domethënë, të Bosnjes e Hercegovinës, Kosovës dhe të Maqedonisë. Rusia do ta ketë një terren të përshtatshëm për t'i përmbushur qëllimet e veta përderisa të vazhdojnë të mbisundojnë, pavendosshmëria e Brukselit, dhe mungesa e një udhëheqjeje të fuqishme të SHBA-ve lidhur me zgjerimin e mëtutjeshëm të NATO-s dhe të UE-së.⁴⁹

Përmes flirtimit dhe lidhjes me Rusinë, Serbia në një mënyrë të qartë është duke zbatuar një strategji të balancimit të butë me SHBA-të dhe Evropën Perëndimore. Përmes balancimit të butë me Vashingtonin dhe Brukselin – edhe pse kjo ende nuk e ka arritur nivelin e ndonjë aleance formale – dhe përmes një ndërtimi jo-ofendues, por kundërshtues, dhe rast pas rasti, të koalicionit me Rusinë, Serbia synon ta neutralizojë mosbalancin e pakapërcyeshëm me të cilin është e ballafaquar përballë Perëndimit, pavarësisht nga qëllimet e veta deklarative për integrim në UE. Bashkëpunimi i forcuar mbrojtës me Rusinë është një veprim shqetësues i këtij modeli të politikës së Beogradit. Pas krizës në Ukrainë, Serbia është i vetmi vend në Evropë që në trevën e vet do të mbajë manovra të përbashkëta me trupat ushtarake ruse. Gjatë kësaj vjeshte pritet të zhvillohen manovrat e përbashkëta të Brigadës elite Speciale të Ushtrisë Serbe (të bazuar në Pançevë dhe në Nish) me Divizionin 106 të Trupave Ajrore të Rusisë.⁵⁰

Në një mënyrë ironike, ndërkohë që është në drejtimin e një përplasjeje të rëndë me Rusinë, Brukseli nuk e pati as edhe një reagim të vetëm publik kundër bashkëpunimit të fuqizuar ushtarak të Serbisë me Rusinë. Në një mënyrë evidente, politika e Brukselit ndaj Beogradit ka qenë, edhe ta zvogëlojë mundësinë e shfrytëzimit të aftësisë së Serbisë për të krijuar konflikte, edhe ta integrojë atë në Unionin Evropian. Veçse, kjo politikë mund të dëshmohej si katastrofike, nëse Brukseli nuk vë vija të qarta të kuqe për bashkëpunimin aventurier të mbrojtjes dhe të sigurisë të Serbisë me Rusinë. Për më tepër, duke patur parasysh që, edhe Beogradi, edhe Moska, konsiderojnë që Kosova është burim i terrorizmit, nuk është e vështirë të supozohet që në rast të çfarëdo ndryshimi të rrethanave ndërkombëtare kjo Qendër mund të

⁴⁸ Montenegro Rejects Russian Request to open military base in Bar, <http://www.balkaninside.com/montenegro-rejects-russian-request-to-open-military-base-in-bar/>, 19 dhjetor, 2013.

⁴⁹ Edward P. Joseph dhe Janusz Bugajski "Long March to Brussels: Why NATO and EU Must Reopen their Doors to the Balkans", Foreign Affairs, <http://foreignaffairs.com/print/138680>, 26 qershor, 2014

⁵⁰ Ruski Padobranci na vezbi u Srbiji [Parashutistët rusë në ushtrime në Serbi], <http://www.politika.rs/rubrike/Drustvo/Ruski-padobranci-na-vezbi-u-Srbiji.lt.html>, Politika Online, 17 korrik, 2014

kthehet në një kërcënim serioz për Kosovën dhe për rajonin, nëse Beogradi në ndërkohë nuk i ndryshon politikat e veta ndaj Brukselit dhe Prishtinës.



**Bazat Ushtarake
të Forcave Tokësore**



**Bazat e Mbrojtjes
Kundërajrore dhe të
Forcave Ajrore**



**Bazat Ushtarake
të Forcave Detare**

3. Ndikimi i përfshirjes ushtarake të NATO-s dhe instrumentet integrale të sigurisë rajonale

3.1. Hyrje

Shembja e Bashkimit Sovjetik dhe kriza në ish-Jugosllavi i ndryshuan perceptimet e kërcënimeve nga ana e NATO-s, gjë kjo që çoi në Konceptet Strategjike, fillimisht të vitit 1991, dhe, në fund, në ato të vitit 1999. Potenciali ushtarak i Rusisë, si kërcënimi kryesor konvencional për NATO-n shkoi duke u zbehur, edhe pse, teknikisht, potenciali bërthamor i Moskës mbetet kërcënimi më i madh i sigurisë. Sidoqoftë, shqetësimet lidhur me zhvillimet politike në Rusi dhe me rishfaqjen e mundshme të politikës së saj agresive, në veçanti ndaj asaj që Moskë e ka përcaktuar si jashtëmja e afërt, vazhdojnë ta ndikojnë madje edhe sot mënyrën e mendimit lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen të Aleancës Atlantike.

Nga ana tjetër, ngjarjet e viteve 1990 njëkohësisht e transformuan gjeopolitikën e Ballkanit dhe të NATO-s të pas-Luftës së Ftohtë. Në fillim të viteve 90, konfliktet dhe lufta që shpërthyen në ish-Jugosllavi treguan potencial për përshkallëzim, gjë kjo që e rrezikoi stabilitetin evropian dhe ndërkombëtar. Është mjaft interesante ajo që në atë kohë oficerët e lartë të NATO-s e kundërshtonin mundësinë e intervenimit ushtarak të Aleancës në ish-Jugosllavi, madje edhe po të arrihej pajtimi politik, për shkak të mangësive logjistike,⁵¹ duke treguar kështu që përballëshin me kapacitete të pamjaftueshme për ta projektuar një forcë të pamposhtshme madje edhe në fqinjësinë e vet të drejtpërdrejtë. Reagimet politike-ushtarake ndaj këtij kërcënimi brenda NATO-s mbetën të paqarta praktikisht deri në shpërthimin e luftës së Kosovës, kur Aleanca, për herë të parë në historinë e vet 50-vjeçare, e zhvilloi një luftë kundër një shteti të pavarur, “jashtë fushës së vet.” Kriza në ish-Jugosllavi ishte një nga faktorët kyç që e nxitën transformimin e NATO-s nga “e vjetra” në “të rene,” të aftë që, në mjedisin e ri të sigurisë ndërkombëtare që u shfaq pas Luftës së Ftohtë, t’i zhvillojë, edhe operacionet e “Nenit V,” edhe ato jashtë “Nenit V.”

Paralelisht me reformat e veta strukturore të brendshme, NATO-ja u përqendrua edhe në zgjerimin e vet, si një proces evoluues ky, që duhej t’i sillte më afër ish-vendet komuniste. Më 1993, Administrata e SHBA e filloi një debat të brendshëm lidhur me mundësitë e zgjerimit të NATO-s. Rezultatet e këtij debati ishin, propozimi për zhvillimin e Programit të Partneritetit për Paqe, që synonte ta ndihmonte bashkëpunimin ushtarak midis shteteve të NATO-s dhe të atyre që nuk ishin anëtare, gjë kjo që filloi në Samitin e Brukselit të janarit 1994, si dhe vendimi, në

⁵¹ Henning A. Frantzen, *NATO and Peace Support Operations 1991 – 1999: Policies and Doctrines*, Taylor and Francis Group, USA and Canada, 2005, fq. 61.

parim, për ta hapur Aleancën për anëtarët e rinj. Në vitin 1995 NATO-ja e filloi “Studimin për zgjerimin e NATO-s” që i përcaktoi parimet për udhëheqjen e këtij procesi, si dhe implikimet e përfshirjes eventuale të anëtarëve të rinj, për aleancën, si dhe për vetë ata anëtarë të rinj.⁵²

Vendet e para të Ballkanit Perëndimor që ju bashkangjitën Partneritetit për Paqe ishin Shqipëria (1994) dhe Maqedonia (1995). Edhe pse Kroacia ishte e etur për t’u bashkangjitur në PfP, ftesa e NATO-s për të u shty deri në vitin 2000, kur kjo i bëri hapat kyç në demokratizim, ndërmarrja e të cilëve ishte e mundur vetëm pas vdekjes së Presidentit Tugjman. Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia ju bashkangjitën PfP-së në vitin 2006. Ngjarjen më të rëndësishme pas intervenimeve ushtarake të NATO-s në Ballkanin Perëndimor e paraqitën ftesat e Samitit të Bukureshtit të NATO-s të prillit të vitit 2008 për Shqipërinë dhe Kroacinë për t’iu bashkangjitur Aleancës. Që të dyja vendet u bënë zyrtarisht anëtare të NATO-s më 1 prill 2009.

Pas pranisë ushtarake të NATO-s në Ballkanin Perëndimor, ndikimin kryesor në rritjen e sigurisë dhe të stabilitetit rajonal e ka patur anëtarësimi i Shqipërisë dhe i Kroacisë në Aleancë. Po ashtu, Maqedonia (1999) dhe Mali i Zi (2010) janë bashkangjitur në Planin Aksional për Anëtarësim (MAP – Membership Action Plan), dhe Bosnës e Hercegovinës i është bërë ftesa për t’u bashkangjitur në MAP po ashtu (2010). Serbia është i vetmi vend në Ballkanin Perëndimor që nuk synon t’i bashkangjitet Aleancës, ndërkohë që Kosova, edhe përkundrejt aspiratave të veta, mbetet i vetmi vend në zonën më të gjerë euroatlantike që nuk është bashkangjitur as në PfP, dhe atë kryesisht për shkak të mosnjohjes nga 4 anëtarë të NATO-s (Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja).

⁵² Barret J., “NATO's Year of Study: Results and Policy Implications”, në David G. Haglund red. *Will NATO Go East?*, The Center for International Relations, Queen's University, Kingston, Ontario, 1996, fq. 95.

3.2. Përfshirja ushtarake e NATO-s

Edhe përkundrejt faktit që mizoritë që u kryen në ish-Jugosllavi dhe kriza rezultuese e refugjatëve që shpërtheu në të, ishin më të rëndat në territorin e Evropës që nga Lufta e Dytë Botërore, përfshirja e NATO-s në krizë nuk ishte e menjëhershme, por graduale. Përfshirja e NATO-s në këtë territor filloi në verën e vitit 1992, me operacionet mbikëqyrëse “Mbikëqyrësi Bregdetar” [Maritime Monitor],⁵³ dhe “Mbikëqyrësi Qiellor” [Sky Monitor].⁵⁴ Intervenimi ushtarak i NATO-s në Bosnje e Hercegovinë e arriti kulmin e vet pas tre vitesh, në verën e vitit 1995, me Operacionin “Forca e Paramenduar” [“Deliberate Force”], që e përfshinte bombardimin e forcave serbe të Bosnjes dhe ndërmarrjen, në fundin e po të njëjtit vit, të operacionit të parë paqeruajtës të NATO-s, “Forca Implementuese” [“Implementation Force”], IFOR.⁵⁵ Në këtë operacion fillimisht morën pjesë 60.000 trupa nga 16 vende anëtare, dhe nga 17 të tjera që nuk ishin anëtare të NATO-s. Një vit më vonë, ky operacion u shndërrua në operacionin “Forca Stabilizuese,” SFOR [Stabilization Force]. Që të dyja këto operacione vepronin sipas rregullave të veprimit për vendosjen e paqes, të mandatuara nga Këshilli i Sigurimit i KB.⁵⁶ Misioni i NATO-s e dha një forcë që e përmbante rishfaqjen e armiqësive dhe të kërcënimeve ndaj paqes në Bosnje e Hercegovinë. Veças heqjes së mundësive për konflikt të brendshëm të armatosur në Bosnje e Hercegovinë, Misioni SFOR i shoi mundësitë për rishfaqjen e konfliktit të armatosur midis Beogradit dhe Zagrebit për territoret e Bosnjes e Hercegovinës të banuara me serbë dhe kroatë. Misioni SFOR përfundoi në fund të vitit 2004 kur në pushtet erdhi Misioni Paqësor i ESDP-së, EUFOR.

Reagimi i NATO-s ndaj konfliktit të Kosovës ishte më i shpejtë krahasuar me atë në Bosnje e Hercegovinë. Ky filloi me Operacionin e mandatuar nga KS KB “Syri i Shqiponjës” [Eagle Eye],⁵⁷ në vjeshtën e vitit 1998, dhe zgjati deri kur filloi Lufta e NATO-s kundër Jugosllavisë, në fund të marsit 1999. Pas refuzimit të Federatës Jugosllave për ta pranuar Marrëveshjen Paqësore të Rambujesë, NATO zhvilloi fushatë ajrore 78-ditëshe, Operacionin “Forca Aleate” [Allied Force], që përfundoi më 20 qershor 1999, pas arritjes së Marrëveshjes Ushtarake-Teknike me Beogradin, më 9 qershor 1999.⁵⁸ Fushata ajrore e NATO-s kundër Jugosllavisë ishte lufta e parë

⁵³ Me mandat për ta mbikëqyrur në Detin Adriatik respektimin nga ana e palëve ndërluftuese në ish-Jugosllavi të embargos në armatime të KS KB. Shih NATO’s Operations 1949 – present:

<http://www.aco.nato.int/resources/21/NATO%20Operations,%201949-Present.pdf>.

⁵⁴ Me mandat për ta mbikëqyrur “Zonën pa fluturime” [No Fly Zone] mbi Bosnje e Hercegovinë.

⁵⁵ Në dhjetor 1996 IFOR u shndërrua në Forcën Stabilizuese – SFOR.

⁵⁶ [UN Security Council Resolution 1088](#) – Sipas dispozitivave të Kapitullit VII të Kartës së KB.

⁵⁷ Gjatë kësaj periudhe aeroplanët e NATO-s bënë mbikëqyrje ajrore të situatës në Kosovë për të verifikuar respektimin serb të rezolutave të KB lidhur me armëpushimin, si dhe të marrëveshjes NATO-Serbi lidhur me reduktimin e forcave në Kosovë. Shih: NATO’s Operations 1949 – present,

<http://www.aco.nato.int/resources/21/NATO%20Operations,%201949-Present.pdf>

⁵⁸ Shih: Military – Technical Agreement between the International Security Force (KFOR) and the Government of the Federal Republic of Yugoslavia and Republic of Serbia,

<http://www.nato.int/kosovo/docu/a990609a.htm>

e zhvilluar nga Aleanca, edhe pse pa ndonjë mandat të veçantë nga KS KB. Operacioni i Zbatimit të Paqes, i udhëhequr nga NATO-ja – Forca e Kosovës (KFOR) – hyri në Kosovë më 12 qershor 1999, me autorizimin e Rezolutës 1244 (1999) të KS KB, të 10 qershorit 1999.⁵⁹ KFOR-i fillimisht kishte 50.000 trupa,⁶⁰ dhe me përmirësimin e situatës së sigurisë ky numër u zvogëluar gradualisht deri në 4.900 trupa.⁶¹ Prania ushtarake e NATO-s në Kosovë i ka zhdukur mundësitë e ndonjë konflikti të armatosur ndër-etnik në vend, dhe, në praktikë, kjo është garancë e integritetit territorial të Kosovës që problematizohet nga Serbia. Nga aspekti i sigurisë ushtarake, prania e NATO-s është faktori thelbësor kundër shpërthimit të ndonjë konflikti të armatosur midis Kosovës dhe Serbisë, dhe kjo shërben, po ashtu, edhe si forca që e përmban shfrytëzimin e mundshëm të forcave të armatosura të Beogradit kundër Kosovës. Për më tepër, menaxhimi paqësor i Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe zhvillimi i saj stabil nuk kanë mundur as të paramendohen pa praninë e NATO-s në terren. Edhe përkundrejt faktit që nuk ishte formalisht e përfshirë në procesin e pavarësimit të Kosovës, NATO-ja në praktikë ishte faktori kyç që e bëri të mundshëm jetësimin e kësaj pavarësie. Po ashtu, ndërkohë që UE-së, në një mënyrë zemërgjerë, i është dhënë merita për arritjen e marrëveshjes midis Kosovës dhe Serbisë të 19 prillit 2014, kjo marrëveshje, në instancë të fundit, është bërë e mundshme vetëm përmes përfshirjes së NATO-s një herë pasi që Serbia kërkoi garanca që FSK-ja nuk do të vendoset në komunat veriore të Kosovës.

Pos në Bosnje e Hercegovinë dhe në Kosovë, NATO-ja u përfshi, në një nivel mjaft të kufizuar, edhe në konfliktin e brendshëm të Maqedonisë, midis Qeverisë së Shkupit dhe Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK) të shqiptarëve etnikë, dhe atë me operacionet “Prodhimi Thelbësor” [Essential Harvest], në verën e vitit 2001, “Dhelpra e Qelibartë” [Amber Fox], që zgjati nga fundi i shtatorit 2001 deri në mesin e dhjetorit 2002, dhe “Harmonia Aleate” [Allied Harmony], që zgjati nga dhjetori 2002 deri në fund të marsit 2003. Këto misione e patën rolin e çarmatosjes dhe të tërheqjes së UÇK-së, dhe të përkrahjes së mbikëqyrësve të OSBE-së dhe të UE-së, që e mbikëqyrën zbatimin nga ana e palëve në konflikt, të Marrëveshjes së Ohrit⁶² të 13 gushtit 2001.⁶³ Përfshirja e NATO-s ishte thelbësore për përfundimin e armiqësive dhe për transformimin demokratik të Maqedonisë.

Përfshirja ushtarake e NATO-s në Ballkanin Perëndimor, si një forcë prapësuese dhe stabilizuese, i ka shkurajuar konfliktet e armatosura dhe e ka transformuar zonën nga një me

⁵⁹ Rezoluta 1244 (1999) e KS KB, 10 qershor, 1999

<http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N99/172/89/PDF/N9917289.pdf?OpenElement>.

⁶⁰ Shih: NATO's role in Kosovo: http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_48818.htm.

⁶¹ Shih: KFOR Troop Numbers & Contributing Nations:

<http://www.aco.nato.int/kfor/about-us/troop-numbers-contributions.aspx>.

⁶² Shih tekstin e plotë të Marrëveshjes së Ohrit: <http://www.ucd.ie/ibis/filestore/Ohrid%20Framework%20Agreement.pdf>.

⁶³ Shih: NATO's Operations 1949 – present:

<http://www.aco.nato.int/resources/21/NATO%20Operations,%201949-Present.pdf>.

shoqëri të dërrmuara nga lufta, dhe që kanë marrëdhënie fqinjësore armiqësore, në një rajon stabil, vendet e të cilit i aspirojnë integrimet euroatlantike. Veçse, prania ushtarake e NATO-s në Kosovë mbetet kyçe për stabilitetin dhe sigurinë e Ballkanit Perëndimor, përderisa të mos arrihet normalizimi i plotë i marrëdhënieve midis Prishtinës dhe Beogradit.

3.3. Instrumentet bashkëpunuese dhe integruese të NATO-s në vendet e Ballkanit Perëndimor

Ndërkohë që shqetësimi i SHBA lidhur me Rusinë e pati ndikimin kryesor për fillimin e Partneritetit për Paqe (Samiti i Brukselit, janar 1994), si një proces evoluues për Zgjerimin e NATO-s, dhe si instrument për ndërtimin e marrëdhënieve të reja të sigurisë me ish-vendet komuniste të Evropës,⁶⁴ zgjerimi i Aleancës “nuk do të ndodhte kurrë pa përpjekjen gjithëpërfshirëse, dhe, përfundimisht, të suksesshme, të NATO-s për ta ndalur luftën shkatërruese në Bosnje.”⁶⁵ Kësisoj, intervenimi i NATO-s në Bosnje e Hercegovinë ishte thelbësor për sjelljen në jetë të vizionit të arkitekturës së re evropiane të sigurisë të pas-Luftës së Ftohtë.

Partneriteti për Paqe, si mjet për bashkëpunimin e ndërlidhur me mbrojtje midis shteteve të NATO-s dhe atyre që nuk janë anëtare të saj, u drejtohet të gjitha shteteve të OSBE-së që janë të afta dhe të gatshme për t’i kontribuar këtij programi. Ky shërben si mjet për zgjerimin dhe intensifikimin e bashkëpunimit politik dhe ushtarak anembanë Evropës, dhe për zvogëlimin e kërcënimeve ndaj paqes, për ndërtimin dhe fuqizimin e marrëdhënieve përmes promovimit të frymës së bashkëpunimit praktik, dhe të përkushtimit ndaj parimeve demokratike, që janë në themel të Aleancës. Nga ana tjetër, ky po ashtu shërben si mjet për anëtarësimin e shteteve të reja aspiruese. Përmes mekanizmit të vet politik të konsultimeve, Partneriteti për Paqe u dëshmuar si program i ‘mbrojtjes parandaluese’ që synon krijimin e kushteve për paqe, duke minimizuar kësaj mundësinë e luftës.⁶⁶ Meqë të dyjat, PfP dhe NATO, thërrasin për konsultime sipas Nenit IV të traktatit, atëherë, nëse konsultimet bëjnë punë, NATO nuk do të duhet ta përdorë asnjë herë Nenin V.⁶⁷

Programi i Partneritetit për Paqe e ka ndihmuar tranzicionin e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, përmes reformimit të forcave ushtarake, të marrëdhënieve civile-ushtarake, dhe

⁶⁴ Për shpjegim të mëtejshëm, shih: Ronald D. Asmus: *Opening NATO's Door: How the Alliance remade itself for a New*, Columbia University Press, New York, 2002, fq. 48-57.

⁶⁵ *Ibid.*, fq. 124

⁶⁶ Perry. J. W., “Keeping the Door Open? [Mbjtja e derës hapur?],” në S. Serfaty red. *NATO at 50, What now, What next, What else? [NATO në të 50-at, Çfarë tash, Çfarë më pas, Çfarë tjetër?]*, 10 shkurt, 1999, Center for Strategic and International Studies, fq. 3.

⁶⁷ Kipp, fq. 16.

doktrinës dhe ushtrimeve paqeruajtëse me kombet e NATO-s, duke demonstruar në praktikë si mund t'i përkrahë ushtria institucionet demokratike. Lidhur me këtë, një vlerë të spikatur e kishin Programet e hollësishme Individuale të Partneritetit që u implementuan pasi që për to ishte arritur marrëveshja. Pfp e ka patur një ndikim mbresëlënës në trajtësimin e kulturave të politikave të jashtme të shumë prej shteteve të Evropës Qendrore dhe Lindore, përmes promovimit të marrëdhënieve të mira fqinjësore, të transparencës lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe të konsultimeve përmes Brukselit.

Sa i përket zgjerimit dhe operabilitetit, i një interesi të veçantë është Procesi i Planifikimit dhe Shqyrtimit të Partneritetit (PARP – Planning and Review Process of the Partnership). Ashtu siç është parashtruar në dokumentin kornizë të Pfp-së, PARP duhet të ofrojë themel për procesin e identifikimit dhe të vlerësimit të forcave dhe të kapaciteteve që mund të jenë në dispozicion nga partnerët, për trajnimet, ushtrimet dhe operacionet multilaterale që bëhen së bashku me forcat e Aleancës. PARP përqendrohet në fushat që i kontribuojnë interoperabilitetit, të tilla si komunikimet, standardet e pajisjeve, procedurat e operacioneve dhe aftësitë operacionale. Me një theks gjithnjë e më të madh ndiqen edhe qëllime të tjera të rëndësishme të PARP-it, për t'i përfshirë edhe promovimin e kontrollit demokratik të forcave të armatosura në vendet partnere, dhe për t'i njohur ato me planifikimin e mbrojtjes kolektive, në përputhje me praktikatat e NATO-s.

Për më tepër, meqë nevojat mbrojtëse të Aleancës janë të klasifikuara, dhe nuk mund të ndahen me vendet candidate para se këto ta nënshkruajnë Traktatin e Vashingtonit, është e mundur që PARP t'i japë indikacionet e përgjithshme të pritjeve të NATO-s nga anëtarët e rinj, meqë PARP i cakton hapat që këto vende duhet t'i ndërmarrim për ta përmirësuar interoperabilitetin e tyre.⁶⁸ Më e rëndësishmja, nga aspekti i reformimit të kulturave strategjike⁶⁹ dhe të politikave të jashtme të vendeve aspiruese, Pfp u dha fund të gjitha shpresave për bashkëpunim mbrojtës bilateral apo rajonal, duke e shndërruar, kësisoj, bashkëpunimin ekskluzivisht përmes Brukselit në një çmim që vendet aspiruese duhet ta paguajnë për anëtarësim.⁷⁰

⁶⁸ Gallis, P., "NATO Enlargement: The Process and Allied Views" ["Zgjerimi i NATO-s: Procesi dhe pikëpamjet aleate"], CRS Report for Congress, 1 korrik 1997, <http://www.fas.org/man/crs/gprime.htm>, fq. 15.

⁶⁹ Shih Përcaktimin themelor të kulturës strategjike: "Kultura strategjike është një numër besimesh, normash dhe idesh të përbashkëta brenda një shoqërie, që krijojnë pritje të veçanta rreth preferencave dhe veprimeve të komunitetit përkatës në politikën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Në këtë kontekst, identiteti i sigurisë dhe i mbrojtjes së komunitetit, i shprehur përmes preferencave dhe modeleve në sjellje, përftohen nga përvojat e përbashkëta dhe narrativet e pranura të veçanta për një komunitet të veçantë të sigurisë." Cituar nga: Heiko Biehl, Bastian Giegerich dhe Alexandra Jonas (red.), *Strategic Cultures in Europe, Security and Defence Policies Across the Continent*, Springer VS, Postdam, 2013, fq. 12.

⁷⁰ *Ibid.*, fq. 34.

Kriza e Kosovës e tregoi në praktikë vlerën e Pfp gjatë operacioneve të zbatimit të paqes. Shqipëria dhe Maqedonia luajtën role kyçe në suksesin e tërësishëm të sulmeve ajrore të NATO-s kundër Jugosllavisë, duke reaguuar ndaj spastrimit etnik – deportimit të njerëzve – nga ana e Beogradit, si dhe në vendosjen e mëpastajme të vrullshme të trupave të NATO-s në Kosovë. Nga ana tjetër, pas ‘pushtimit’ spektakular rus të aeroportit të Prishtinës, Bullgaria dhe Rumania, duke vepruar politikisht me të njëjtin qëndrim si NATO-ja, morën pjesë në ‘pacifikimin’ vijues të Moskës, përmes tjerash, duke refuzuar kërkesën e Kremlinit për shfrytëzimin e hapësirës së tyre ajrore. Përvoja e Kosovës i kontribuoi forcimit të kategorisë së ‘meritave,’ si një që është kyçe për anëtarësim në NATO.⁷¹ Veçse, edhe pse në këtë drejtim mund të bëhet përparim më i madh, ashtu siç pranohet gjerësisht, prapëseprap, çmimi strategjik i Nenit V mbetet garancë përfundimtare e stabilitetit. Kjo është ajo që Partneriteti për Paqe, pavarësisht nga mënyra si është fuqizuar dhe institucionalizuar, dështon ta ofrojë,⁷² një fakt ky që e kanë dëshmuar aneksimet e kohëve të fundit nga ana e Rosisë, e pjesëve të territorit të Gjeorgjisë (2008) dhe të Ukrainës (2014).

Në vitin 1999, pas raundit të parë të zgjerimit të pas Luftës së Ftohtë (1997), NATO-ja u përpoq që procesin e vlerësimit ta bënte më të strukturuar dhe më rigoroz, përmes paraqitjes së Planit Aksional të Anëtarësisë (MAP – Membership Action Plan), që nxori shumë nga mësimet e fituara gjatë këtij raundi të zgjerimit. MAP nuk i ndryshoi kriteret e anëtarësimin, dhe nuk krijoi ndonjë grumbull gjithëpërfshirës të përkushtimeve legale të cilave do të duhej t’u nënshtroheshin anëtarët perspektiv, por ky kërkonte nga çdo shtet aspirues që ta përpilonte dhe dorëzonte një Program Vjetor Kombëtar ku do t’i jipte në hollësi përgatitjet e veta për anëtarësim në NATO në pesë fusha kyçe: politike dhe ekonomike, mbrojtëse/ushtarake, në atë të resurseve (për t’i përmbushur përkushtimet si anëtarë), në siguri (për t’i mbrojtur informatat e NATO-s), dhe në fushën legale (arranzhimet legale për ta udhëhequr bashkëpunimin me NATO-n).⁷³ Ky po ashtu ofronte resurse shtesë për anëtarët kandidatë që, përmes paraqitjes së një programi aksional praktik, të individualizuar dhe të orientuar kah anëtarësia në NATO, kishin shprehur gatishmëri për një marrëdhënie më përmbajtësore me NATO-n se ajo që ofrohej nga anëtarësia në Pfp.⁷⁴ Megjithatë, duhet qartësuar që MAP nuk e zëvendëson programin Pfp. Në fakt, pjesëmarrja në Pfp mbetet thelbësore për vendet aspiruese. Pfp-ja e shtuar dhe Nisma e Aftësive Mbrojtëse (DCI – Defence Capabilities Initiative) i zbatojnë procedurat PARP për forcat e armatosura të të gjithë partnerëve të MAP.⁷⁵ Për më tepër,

⁷¹ Shih Komunikatën e Samitit të Washingtonit dhe Security Issues Digest Nr. 124, Misioni i SHBA në NATO, 29 qershor 1999, Ambasadori Vershbo# A., <http://usa.grmbi.s19990629g.htm>.

⁷² Hunter, Robert, *Strategic Survey 1996/97*, International Institute for Strategic Studies, Oxford: Oxford University Press, 1997, fq. 118.

⁷³ Membership Action Plan (MAP, Press Release, NAC-S (99) 66, 24 prill, 1999.

⁷⁴ Petre. Z., “A view from Lithuania”, në, Simon Serfaty red., *NATO at 50, What Now, What Next, What Else?*, Raport i Konferencës së Studimeve Evropiane të CSIS, 10 shkurt, 1999, CSIS, #ashington D.C, fq. 24.

⁷⁵ Simon J. “Partnership for Peace: After the Washington Summit and Kosovo,” Forumi Strategjik i NDU-së, Nr. 167, gusht 1999,

vendet aspiruese kanë mundësinë të kërkojnë Programe Individuale të përshtatura të Partneritetit (IPP – Individual Partnership Programmes), që pjesëmarrjen e tyre në PfP e përqendrojnë më mirë dhe më drejtpërdrejtë në çështjet që në mënyrë thelbësore janë të ndërlidhura me vetë anëtarësinë e tyre.⁷⁶

Ngjashëm me studimin për Zgjerimin e NATO-s, MAP vendeve aspiruese nuk u ofron ndonjë grumbull kriteresh për anëtarësim. Për më tepër, madje as pjesëmarrja e suksesshme në program nuk e paragjykon vendimin e Aleancës për ta bërë ftesën për fillimin e bisedimeve për bashkangjitje. Vendimi për ftesën për anëtarësim merret duke u bazuar në rastin e veçantë, dhe duke i marrë parasysh konsideratat politike, të sigurisë dhe ato ushtarake.⁷⁷ Për më tepër, përmbushja e kualifikimeve për anëtarësim nga NATO-ja konsiderohet si ‘kusht i domosdoshëm,’ dhe jo si ‘kusht i mjaftueshëm’ – i cili do të përcaktohet nga Aleanca – dhe anëtarësimi duhet t’u “shërbejë interesave të tërësishme politike dhe strategjike të Aleancës, ta forcojë efektshmërinë e saj dhe ta shtojë sigurinë dhe stabilitetin e tërësishëm evropian.” Kjo don të thotë që anëtarësimi në NATO i vendeve aspiruese të Ballkanit Perëndimor nuk është i garantuar, madje edhe në rastin e plotësimit të kushteve. Veçse, mund të ndodhë edhe e kundërta, domethënë, mund të bëhet ftesa për anëtarësim edhe pa plotësimin e tërësishëm të kushteve për të, nëse kjo është në interesin strategjik të NATO-s.

NATO i ka zhvilluar marrëdhëniet me vendet e Ballkanit Perëndimor që nga krijimi i Këshillit të Bashkëpunimit Veri-Atlantik (NACC – North Atlantic Cooperation Council, 1992), që më vonë, me prezantimin e Partneritetit për Paqe (1994) dhe të Planit Aksional për Anëtarësim (1999), u riemërua në Këshillin e Partneritetit Euro-Atlantik (EAPC – Euro-Atlantic Partnership Council, 1997).

Shqipëria ishte vendi i parë i rajonit që ndërtoi marrëdhënie formale me NATO-n, duke iu bashkangjitur NACC-ut më 1992, dhe PfP-së më 1994, dhe kjo u vijua nga Maqedonia që PfP-së iu bashkangjit në po të njëjtin vit. Kroacia iu bashkangjit PfP-së në vitin 2000, ndërkaq, Bosnja e Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia kësaj iu bashkangjitën në vitin 2006. Shqipëria dhe Kroacia ishin vendet më të suksesshme të rajonit, duke iu bashkangjitur Aleancës në vitin 2009. Edhe pse Maqedonia i ka plotësuar kriteret, anëtarësimi i saj në NATO mbetet pezull për shkak të çështjes së pazgjidhur që kjo e ka me Greqinë rreth emrit të vet. Mali i Zi MAP-in e fitoi në vitin 2010, ndërkaq, çështja e MAP-it për Bosnjën e Hercegovinën mbetet pezull që nga viti 2012, për shkak të çështjes së pazgjidhur të regjistrimit të pronës së patundshme mbrojtëse si pronë shtetërore.

<http://www.nyu.edu/globalbeat/nato/NDU0899.htm>, fq. 4.

76 Membership Action Plan [Plani Aksional i Anëtarësisë], Defence/Military Issues [Çështjet Mbrojtëse/Ushtarake], pika 3a.

77 Klaiber K.P., “The Membership Action Plan: Keeping NATO’s Door Open”, *NATO Review*, Vol 47, Nr. 2, Verë 1999, fq. 25.

Serbia është i vetmi vend i rajonit që e ka zgjedhur “neutralitetin ushtarak” dhe kjo nuk ka ambicje për t’iu bashkangjitur Aleancës, edhe përkundrejt marrëdhënieve intenzive që i ka me NATO-n, përfshirë këtu edhe themelimin e Qendrës Trajnuese dhe Edukuese të Partneritetit – Qendra për Trajnimin Biologjik, Radiologjik dhe Bërthamor (CBRN – the Chemical, Biological, Radiological and Nuclear Training Centre) në Krushevac.⁷⁸

Pavarësisht aspiratave të saj për anëtarësim në NATO, Kosova është i vetmi vend në zonën më të gjerë euro-atlantike që nuk ka marrë ofertë për të marrë pjesë në Partneritetin për Paqe. Izolimi i Kosovës nga instrumentet konsultative të NATO-s – EAPC dhe PfP – është në vetvete një sfidë për përmbartimin e arkitekturës së sigurisë të rajonit, si dhe të Evropës si të tërë, dhe posaçërisht për shkak të mospajtimeve që kjo i ka me Beogradin, si dhe të institucioneve të papërfunduara të saj të mbrojtjes kombëtare.

Megjithatë, perspektivat e zgjerimit të PfP-së dhe të NATO-s kanë patur ndikimin vendimtar në trajtësimin e politikave të mbrojtjes dhe të sigurisë së shteteve ballkanike. Këto i kanë dërrmuar të gjitha ëndërrat që elitat politike ekstremiste të vendeve të rajonit mund t’i kenë patur menjëherë pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, për kthimin e rajonit në një gjendje të ngjashme me atë të Luftërave Ballkanike. Konflikti në ish-Jugosllavi, i shkaktuar nga ambicja e Beogradit për krijimin e ‘Serbisë së Madhe’ mbi hirin e luftërave të viteve 90, tregoi qartë se në çfarë drejtimi ka mundur të shkojë rajoni po të mos ishte përfshirja e NATO-s. Për më tepër, mekanizmat e NATO-s për bashkëpunim dhe integrim e patën ndikimin vendimtar në reformat rrënjësore të politikëbërjes mbrojtëse të vendeve të rajonit. Modelet e balancimit të rëndë dhe doktrinat e ushtrive masive të bazuara në mbrojtje territoriale dhe në prapësim, u shndërruan në asi të ushtrive profesionale, në të njëjtën kohë kur aftësitë ofensive kundër fqinjëve u zvogëluan në një masë domethënëse.

Po ashtu, PfP vendeve të rajonit u ndihmoi për t’u shndërruar në ofrues të sigurisë, përmes pjesëmarrjes në misionet paqeruajtëse të udhëhequra nga NATO, si dhe nga KB dhe UE. Kroacia është deri më tash vendi që prin në rajon sa i përket kontributit për misionet ndërkombëtare paqeruajtëse, përfshirë këtu ato të udhëhequra nga NATO, KB dhe UE, mirëpo kjo nuk ka marrë pjesë në operacionin Liria e Irakut [Iraqi Freedom], të udhëhequr nga SHBA. Shqipëria dhe Maqedonia kanë marrë pjesë në të gjitha misionet e udhëhequra nga NATO, dhe në misionin në Irak të udhëhequr nga SHBA, si dhe në një numër misionesh të udhëhequra nga KB dhe UE. Bosnja e Hercegovina merr pjesë në misionin ISAF, në Afganistan, të udhëhequr nga NATO, si dhe në një mision tjetër, të udhëhequr nga KB. Pjesëmarrja e Malit të Zi dhe Serbisë në misionet paqeruajtëse është e kufizuar në misionet paqësore të udhëhequra nga KB dhe UE.

⁷⁸ Partnership Training and Education Centers: <https://www.act.nato.int/ptecs>

Kosova është i vetmi vend në rajon që nuk ka marrë pjesë në asnjë mision paqësor ndërkombëtar.

Për më tepër, ftesat përkatëse për anëtarësim të NATO-s për Shqipërinë dhe Kroacinë, si dhe Shpallja e Pavarësisë së Kosovës e vitit 2008, e kanë patur një efekt thelbësor në përmbylljen e kufijve ndërshtetërorë të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Anëtarësimi në NATO i ka shuar ambicjet e një pjese të elitave etnike shqiptare në Kosovë për t'u bashkuar me Shqipërinë, dhe të një pjese të elitave etnike kroate në Bosnje e Hercegovinë për t'u bashkuar me Kroacinë.

Këtu duhet theksuar atë që rasti i unifikimit gjerman në vitin 1990 e ka ndërtuar një precedent brenda Aleancës sa i përket bashkimit të dy vendeve të pavarura, në rastin kur njëri prej tyre është anëtar i NATO-s. Këtu u desht që të gjithë anëtarët e NATO-s së pari ta jipnin miratimin për bashkimin e Republikës Federale Gjermane me Republikën Demokratike Gjermane, dhe vetëm pas kësaj e mirëpritën Gjermaninë e Bashkuar në NATO, gjë kjo që nuk do të kishte qenë e mundur pa përpjekje shumë të mëdha të Administratës së SHBA-ve.⁷⁹

Nëse këtë e zbatojmë në, të themi, rastin hipotetik të bashkimit të Shqipërisë me Kosovën, atëherë për këtë do të kërkohet miratimi i të gjithë anëtarëve të NATO-s, arritja e të cilit, e qartë, është me fare pak gjasa. Kjo don të thotë që, në rrethanat ekzistuese, bashkimi i Shqipërisë me Kosovën nuk është i mundshëm pa një vendim paraprak të Tiranës për t'u çantarësuar nga NATO-ja, gjë kjo që, më tutje, është në kundërshtim me interesat më të larta të sigurisë, si të Shqipërisë, ashtu edhe të Kosovës. Nga ana tjetër, kjo tregon që, pavarësisht nga anëtarësia e saj në Partneritetin për Paqe, Serbia do të vazhdojë që, deri në një masë, të jetë shfrytëzuese falas e sigurisë, dhe që busolla e saj do të vazhdojë të luhetet midis Moskës dhe Brukselit. Dhe kjo, më tutje, don të thotë që siguria e rajonit, dhe posaçërisht ajo e Bosnjes e Hercegovinës, do të vazhdojnë të sfidohen, përderisa vendet e Ballkanit Perëndimor të mos bëhen anëtare të NATO-s. Kësisoj, me qëllim të tejkalimit të paqartësive lidhur me situatën e sigurisë në rajon, është e domosdoshme që NATO-ja ta hapë rrugën për një anëtarësim të shpejtë të Maqedonisë dhe të Malit të Zi, që ta ofrojë MAP-in për Bosnjen e Hercegovinën, dhe PFP-në për Kosovën.

⁷⁹ Për një shpjegim më të thellë, shih: Michael Cox dhe Steven Hurst, "His finest hour: George Bush and the Diplomacy of German Unification", *Diplomacy & Statecraft*, Vol. 13, Nr. 4, Frank Cass, London, dhjetor, 2002.

MISIONET PAQERUAJTËSE

Shqipëria	Bosnja dhe Hercegovina	Kroacia	Kosova	Maqedonia	Mali i Zi	Serbia
<p>ISAF (Afganistan). KFOR (Kosovë). ALTHEA (Bosnje e Hercegovinë) . Liria e Irakut [Irraqi Freedom]. MINURCAT (Misioni i Kombeve të Bashkuara në Republikën Qendrore Afrikane dhe Çad). UNOMIG (Misioni Mbikëqyrës i Kombeve të Bashkuara në Gjeorgji).</p>	<p>ISAF (Afganistan). Misioni i KB në Kongo.</p>	<p>UNAMSIL (Misioni i Kombeve të Bashkuara në Sierra Leone). UNMEE (Misioni i Kombeve të Bashkuara në Etiopi dhe Eritrea). UNMOGIP (Grupi Ushtarak Observues i Kombeve të Bashkuara në Indi dhe Pakistan). MINURSO (Misioni i Kombeve të Bashkuara për Referendum në Saharanë Perëndimore). ISAF (Forca Ndërkombëtare për Asistencë të Sigurisë, Afganistan) UNMISSET (Misioni i Kombeve të Bashkuara për Përkrahje në Timorin Lindor). UNMIL (Misioni i Kombeve të Bashkuara në Liberi) MINUSTAH (Misioni Stabilizues i Kombeve të Bashkuara në Haiti) UNOCI (Operacioni i Kombeve të Bashkuara në Bregun e Fildishtë). UNFICYP (Forca Paqeruajtëse e Kombeve të Bashkuara në Qipro). UNOMIG (Misioni Mbikëqyrës i Kombeve të Bashkuara në Gjeorgji). UNMIS (Misioni i Kombeve të Bashkuara në Sudan). UNIOSIL (Zyra e Integruar e Kombeve të Bashkuara në Sierra Leone). UNMIN (Misioni i Kombeve të Bashkuara në Nepal). UNIFIL (Forca e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Liban). BINUB (Zyra e Integruar e Kombeve të Bashkuara në Burindi). UNDOF (Forca Mbikëqyrëse e Shkëputjes e Kombeve të Bashkuara). EUFOR (Forca e Unionit Evropian) MINURCAT (Misioni i Kombeve të Bashkuara në Republikën Qendrore Afrikane dhe Çad). EU NAVFOR (Forca Detare e UE, Somali). KFOR (Forca e Kosovës). Operacioni Mbrojtësi i Njësuar (NATO, Libi).</p>		<p>ISAF (Afganistan). Liria e Irakut [Irraqi Freedom]. ALTHEA (Bosnje e Hercegovinë). UNIFIL (Liban). KFOR (Kosovë).</p>	<p>UNIFIL (Liban). UNOMIG (Gjeorgji). MONUC (Kongo). UNMIL (Liberi). UNMIT (Timor - Lester).</p>	<p>MONUSCO (RD e Kongos). UNMIL (Liberi). UNOCI (Bregu i Fildishtë). UNFICYP (Qipro). UNIFIL (Liban). UNTSO (Lindje e Mesme). EUTM (Somali). EUNAVFORS (Somali).</p>

MARRËDHËNIET E NATO-S ME BALLKANIN PERËNDIMOR

Shqipëria	Bosnja dhe Hercegovina	Kroacia	Kosova	Maqedonia	Mali i Zi	Serbia
<p>1992 – Shqipëria i bashkangjitet Këshillit të sapokrijuar për Bashkëpunim Veri-Atlantik, që më 1997 riemërohet në Këshilli Euroatlantik për Partneritet.</p> <p>1994 – Shqipëria i bashkangjitet Partneritetit për Paqe (PFP).</p> <p>1996 – Forcat shqiptare i bashkangjiten forcës paqeruajtëse SFOR në Bosnje e Hercegovinë të udhëhequr nga NATO-ja.</p> <p>1999 – NATO themelon një bazë logjistike në Tiranë për ta përkrahur operacionin aleat në Kosovë.</p> <p>2000 – Shqipëria është nikoqire e ushtrimit të Pfp “Adventure Express” [Aventura Eksprese] në prill, dhe të atij “Cooperative Dragon” [Dragoi Bashkëpunues] në qershor.</p> <p>2001 – Shqipëria është nikoqire e fazës nismëtare të ushtrimit të Pfp “Adventure Express 01” [Aventura eksprese 01] në prill dhe maj.</p> <p>2002 – Themelohet Shtabi i Përgjithshëm Tirana i NATO-s për ta asistuar Shqipërinë në jetësimin e reformave të aftësive të veta mbrojtëse si dhe për t’i kontribuar komandimit dhe kontrollit të KFOR-it.</p>	<p>1993 – Në prill NATO fillon Operacionin Mohimi i Fluturimeve për t’a parandaluar ndërhyrjen ajrore mbi Bosnje e Hercegovinë.</p> <p>1994 – Më 28 shkurt katër aeroplanë luftarakë që e shkelin zonën e ndalimit të fluturimit u rrëzuan nga aeroplanët e NATO-s në angazhimin e parë luftarak të Aleancës.</p> <p>1995 – Në gusht, sulmet aleate ajrore në pozitat e serbëve të Bosnjes ndihmuan për t’i shtyrë palët ndërluftuese kah negociatat paqësore. Marrëveshja Paqësore e Dejtonit nënshkruhet më 14 dhjetor. Forca Implementuese e udhëhequr nga NATO me 60.000 trupa pozicionohet për të zbatuar aspektet ushtarake të marrëveshjes paqësore. IFOR është operacioni i parë paqeruajtës i NATO-s.</p> <p>1996 – Në shtator mbahen zgjedhjet e para në Bosnje e Hercegovinë; Aleatët pajtohen për ta mbajtur një prani sigurore në vend për ta ndihmuar rindërtimin e vendit. Në dhjetor IFOR zëvendësohet me Forcën Stabilizuese (SFOR).</p> <p>2003 – Themelimi i strukturës komanduese në nivelin shtetëror mbi</p>	<p>1994 – Diplomatat e lartë kroate shprehin publikisht interesimin për t’iu bashkangjitur Partneritetit për Paqe.</p> <p>1999 – Kroacia lejon shfrytëzimin e hapësirës së vet ajrore për operacionin Forca Aleate, dhe ofron përkrahje logjistike për KFOR-in.</p> <p>2000 – Kroacia i bashkangjitet Këshillit Euro Atlantik për Partneritet (EAPC) dhe Partneritetit për Paqe (PFP). Kroacia i bashkangjitet Procesit Planifikues dhe Shqyrtues të Pfp-së (PARP).</p> <p>2001 – Kroacia e zhvillon Planin e vet të parë Individual të Partneritetit (IPP).</p> <p>2002 – Kroacia e merr ftesën për t’iu bashkangjitur Planit Aksional të Anëtarësimit (MAP). Kroacia e dorëzon Programin e vet të parë Vjetor Kombëtar në kornizën e MAP-it. Kroacia është nikoqire e ushtrimit të planifikimit dhe asistimit civil të emergjencave të Pfp-së.</p> <p>2003 – Forcat kroate i kontribuojnë Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë në Afganistan (ISAF). Kroacia është nikoqire e ushtrimit “Angazhimi Bashkëpunues 2003”</p>	<p>13 tetor 1998 – Pas përkeqësimit të situatës, Këshilli i NATO-s autorizoi Urdhërat Aktivizues për sulmet ajrore.</p> <p>10 qershor 1999 – Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të KB (UNSCR) 1244 u përvetësua më 10 qershor 1999.</p> <p>12 qershor 1999 – Elementet e para të Forcës së Kosovës të udhëhequr nga NATO, apo KFOR, hyjnë në Kosovë. Deri më 20 qershor përbushet tërheqja e forcave serbe. Misioni i KFOR-it:</p> <ul style="list-style-type: none"> • T’i kontribuojë një mjedisi të sigurtë dhe ta krijojë sigurinë dhe rendin publik. • T’i përkrahë dhe koordinojë përpjekjet humanitare ndërkombëtare dhe praninë civile. • Ta përkrahë zhvillimin e një Kosove stabile, demokratike, multi-etnike dhe paqësore. • Përkrahja e zhvillimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës. <p>20 qershor 1999 – Demilitarizimi dhe transformimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës – UÇK.</p> <p>20 shtator 1999 – Themelimi i Trupave Mbrojtëse të Kosovës.</p> <p>12 qershor 2008 – NATO pajtohet të fillojë implementimin e detyrave shtesë në Kosovë, p.sh.,</p>	<p>1995 – Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë i bashkangjitet Partneritetit për Paqe.</p> <p>1996 – Vendi është nikoqir i ushtrimit të vet të parë në Pfp, “Shpëtimtari” [Rescuer].</p> <p>1999 – Vendi e luan një rol kyç në përkrahjen e operacioneve të NATO-s në Kosovë, dhe Aleatët i ofrojnë asistencë për ta lehtësuar krizën humanitare ndërkohë që refugjatët nga Kosova vërshuan në të.</p> <p>Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë i bashkangjitet Planit Aksional për Anëtarësim (MAP) të NATO-s dhe Procesit Planifikues dhe Shqyrtues (PARP) të Pfp-së.</p> <p>2001 – Dhuna ndizet në perëndim të vendit. NATO e luan një rol kyç në ndihmën për negociatat për armëpushim, që u arrit në qershor. Aleatët e pozicionojnë një forcë për të grumbulluar armët nga ish luftëtarët dhe për ta përkrahur Implementimin e Kornizës së Marrëveshjes së Ohrit.</p> <p>2002 – Vendi e pozicionon personelin në përkrahje të Forcës Ndërkombëtare për Asistimin e Sigurisë (ISAF) në Afganistan.</p> <p>2003 – Misioni i mbikëqyrjes</p>	<p>2003 – Republika Federale e Jugosllavisë zëvendësohet nga një union shtetëror më i shlrshëm i quajtur Serbia dhe Mali i Zi.</p> <p>2006 – Mali i Zi voton për pavarësinë më 3 qershor. Vendi i bashkangjitet Partneritetit për Paqe në dhjetor.</p> <p>2007 – Në përkrahje të përpjekjeve të NATO-s për ta pajisur dhe ushtruar Armatën Kombëtare Afgane, Mali i Zi dhuron armatim dhe municione.</p> <p>2008 – Udhëheqësit e Shteteve dhe të Qeverisë pajtohen për të filluar një Dialog të Intensifikuar me Malin e Zi për aspiratat e tij për anëtarësim dhe për reformat e ndërlidhura. Mali i Zi fillon të punojë me NATO-n në Planin e vet Individual Aksional për Partneritet (IPAP) për të cilin arrihet pajtimi me NATO-n në korrik 2008.</p> <p>2009 – Vlerësimi i parë i IPAP në dhjetor, ministrat e jashtëm të NATO-s e ftojnë Malin e Zi për t’iu bashkangjitur Planit Aksional për Anëtarësim.</p> <p>2010 – Në shkurt, Mali i Zi vendos t’i kontribuojë Forcës Ndërkombëtare të Asistimit të Sigurisë në Afganistan (ISAF). Verë 2010, Mali i Zi largohet nga procesi IPAP. Vjeshtë 2010, Mali i Zi e dorëzon Programin e vet të parë Vjetor Kombëtar, nën Planin Aksional për Anëtarësim.</p>	<p>1999 – Fillon fushata ajrore 78-ditëshe e NATO-s e shkaktuar nga dhuna në Kosovë. Forca paqeruajtëse e Kosovës e udhëhequr nga NATO (KFOR) pozicionohet për ta ruajtur sigurinë dhe për t’i përkrahur përpjekjet për rindërtim. KFOR-i dhe Forcat e Armatosura Serbe e nënshkruajnë Marrëveshjen Ushtarake-Teknike (Marrëveshja e Kumanovës).</p> <p>2001 – NATO dhe qeveria e re e zgjedhur e Republikës Federale të Jugosllavisë bashkëpunojnë në operacionet e menaxhimit të krizës në Serbinë jugore.</p> <p>2003 – Beogradi aplikon formalisht për anëtarësim në Pfp. Republika Federale e Jugosllavisë zëvendësohet nga një union shtetëror më i shlrshëm i Serbisë dhe Malit të Zi. NATO-ja e përmbush një trust fond të Pfp-së për projektin e shkatërrimit të suficitit prej 28.000 armësh të vogla dhe të lehta në Serbi.</p> <p>2005 – Serbia është nikoqire e tryezës së rrumbullakët të fondit të trustit të Pfp-së. NATO dhe Serbia gjatë reduktimit të përbashkët të veglave suficitare të pasigurta të luftës, në Beograd e nënshkruajnë marrëveshjen kalimtare për forcat e KFOR-it.</p> <p>2005 – NATO-ja e nis</p>

<p>2003 – Forcat shqiptare pozicionohen në përkrahje të Forcës Ndërkombëtare për Asistimin e Sigurisë (ISAF), të udhëhequr nga NATO në Afganistan.</p> <p>2005 – Shqipëria i bashkangjitet Konceptit të Aftësive Operacionale. Një ekip i kombinuar mjekësor i tre vendeve të MAP i bashkangjitet në gusht forcave të udhëhequra nga NATO në Afganistan. Shqipëria është nikoqire e ushtrimit të PFP “Cooperative Engagement 05” [Angazhimi Bashkëpunues 05] në shtator.</p> <p>2007 – Shqipëria është nikoqire e takimit të Grupit Këshillues Politik Euro-Atlantik të EAPC-së në maj.</p> <p>2007 – Shqipëria është nikoqire e ushtrimeve të PFP “Cooperative Longbow 07” [Harku shigjetar bashkëpunues 07] dhe “Cooperative Lancer 07” [Heshtari bashkëpunues 07]</p> <p>2008 – Në prill 2008 Shqipëria ftohet për t’i nisur me Aleancën bisedimet për hyrje. Aleatët e NATO-s i nënshkruajnë protokolet për hyrjen e Shqipërisë në Traktatin Veriatlantik më 9 korrik 2008.</p> <p>2009 - 1 prill 2009, Shqipëria bëhet anëtare e plotë e Aleancës.</p>	<p>ushtritë e dy entiteteve në dhjetor.</p> <p>2004 – Në dhjetor forca paqeruajtëse e Unionit Evropian (EUFOR) e merr përgjegjësinë për mbajtjen e sigurisë në Bosnje e Hercegovinë.</p> <p>2005 – Marrëveshja për t’i shkrirë ushtritë e dy entiteteve në një forcë të vetme ushtarake, Forcat e Armatosura të BeH, më 1 janar 2006.</p> <p>2006 – Bosnja e Hercegovina i bashkangjitet PFP-së dhe merret vesh për Programin e parë Individual të Partneritetit (IPP).</p> <p>2007 – Bosnja e Hercegovina i bashkangjitet Procesit Planifikues dhe Shqyrtues (PARP) të PFP-së.</p> <p>2008 – Në prill vendi ftohet nga NATO për të filluar Dialogun e Intensifikuar për një brez të plotë çështjesh politike, ushtarake, financiare dhe të sigurisë, lidhur me aspiratën e saj për anëtarësim. Në shtator Bosnja e Hercegovina merret vesh për Planin e saj të parë Aksional Individual për Partneritet (IPAP) me NATO-n.</p> <p>2009 – Bosnja e Hercegovina i pozicionon oficerët në Forcën Ndërkombëtare të Asistimit të Sigurisë në Afganistan (ISAF).</p> <p>2010 – Në prill Bosnja e Hercegovina ftohet për t’iu</p>	<p>[Cooperative Engagement 2003].</p> <p>2004 – Kroacia ëshë nikoqire e një numri seminaresh për menaxhimin e katastrofave të PFP-së.</p> <p>2005 – Kroacia merr pjesë në ushtrimin e vet të parë për menaxhimin e krizave të PFP-së.</p> <p>Një ekip i kombinuar mjekësor i tre vendeve të MAP i bashkangjitet në gusht forcave të udhëhequra nga NATO në Afganistan.</p> <p>Kroacia është nikoqire e seminarit të PFP-së për luftën bregdetare dhe e një konference për lëvizje dhe transportim.</p> <p>2006 – Kroacia është nikoqire e ushtrimit në projektin për Evropën Juglindore për menaxhimin e katastrofave.</p> <p>Kroacia është nikoqire e takimit të Grupit Këshillues Euroatlantik për Politika të EAPC-së në maj.</p> <p>2007 – Parlamenti Kroat e pranon propozimin për ta rritur kontributin e vendit për ISAF.</p> <p>Kroacia është nikoqire e ushtrimit të reagim ndaj katastrofave “IDASSA 2007” në maj.</p> <p>Kroacia është nikoqire e ushtrimit detar të PFP-së “Noble Midas 2007” nga fundi i shtatorit deri në</p>	<p>asistimi në tërheqjen e Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) dhe në themelimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), si dhe si një strukturë civile për ta mbikëqyrrur FSK-në. Detyrat në vijim janë implementuar në koordinim dhe konsultim të ngushtë me autoritetet relevante lokale dhe ndërkombëtare.:</p> <p>TMK-ja ishte konceptuar si një arranzhim tranzicional i pas-konfliktit, nën përgjegjësinë e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Mandati i tyre ishte të ofrojnë shërbime në reagimin ndaj fatkeqësive, të bëjnë gjurmim dhe shpërtim, të ofrojnë një aftësi për asistencën humanitare në zonat e izoluara, ta asistojnë deminimin dhe të kontribuojnë në rindërtimin e infrastrukturës dhe të komuniteteve.</p> <p>20 janar 2009 – TMK i pushon aktivitetet operacionale më 20 janar 2009, dhe shpërbëhet formalisht në qershor 2009. Paralelisht, zhvillohet Forca e Sigurisë së Kosovës për të siguruar që këto aftësi kyçe të jenë në dispozicion për situatat emergjente.</p> <p>21 janar 2009 – Fillon fushata e parë gjithë-kosovare e rekrutimit për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK).</p> <p>9 korrik 2013 – NATO-ja e shpall Aftësinë e Plotë Operacionale (FOC – Full</p>	<p>së paqes i udhëhequr nga NATO në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë i dorëzohet Unionit Evropian.</p> <p>2005 – Një ekip i kombinuar mjekësor i tre vendeve të MAP në gusht i bashkangjitet forcave të udhëhequra nga NATO në Afganistan.</p> <p>2007 – Vendi është nikoqir i Forumit të Sigurisë të EAPC në Ohër.</p> <p>2008 – Në prill 2008, Aleatët pajtohen që ish Republika Jugosllave e Maqedonisë të ftohet për t’i filluar bisedimet për hyrje sapa një zgjidhje reciprokisht e pranueshme për çështjen e emrit të vendit të arrihet me Greqinë.</p> <p>2010 – Sekretari i Përgjithshëm e viziton Shkupin në qershor 2010.</p> <p>2012 – Kryeministri Gruexhi i drejtohet Këshillit Veri-Atlantik më 25 janar.</p>	<p>2011 – Në qershor, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s në Mal të Zi e përcjell një takim të Kartës së Adriatikut dhe e mban një fjalim të rëndësishëm “NATO dhe Ballkani Perëndimor.”</p> <p>2012 – Kryeministri Luksic i drejtohet Këshillit Veri Atlantik më 21 mars.</p>	<p>projektin e fondit të trustit të PFP-së për të zhvilluar mjete alternative të jetesës për personelin e mëparshëm të forcave të armatosura të Serbisë ndërkohë që shërbimi zvogëlohet.</p> <p>2006 – Serbia i bashkangjitet Partneritetit për Paqe. NATO e hap Zyren Ushtarake për Ndërlidhje në Beograd.</p> <p>2007 – Serbia i bashkangjitet Procesit Planifikues dhe Shqyrtues të PFP-së (PARP). NATO e kompletton projektin e fondit të trustit të PFP-së që në mënyrë të sigurtë i largon 1,4 milion mina kundër-njerëzore nga territori i Serbisë. Në shtator Serbia e dorëzon Dokumentin e vet të Paraqitjes të PFP-së në NATO.</p> <p>2009 – Serbia merret vesh për Programin e vet të parë Individual të Partneritetit me NATO-n.</p> <p>2010 – Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, takohet me Presidentin e Republikës së Serbisë, Boris Tadic ndërkohë që ishin në Nju Jork.</p> <p>2011 – Në prill, Këshilli Veri Atlantik e aprovon kërkesën e Serbisë për ta ndërmarrë Planin Aksional Individual për Partneritet (IPAP) me NATO-n. Në qershor Serbia është nikoqire e Konferencës së</p>
---	---	---	---	--	--	--

	<p>bashkangjitur Planit Aksional për Anëtarësim, që mbetet pezull për shkak të çështjes kyçe lidhur me pronën e palëvizshme mbrojtëse.</p> <p>2011 – Në shkurt Bosnja e Hercegovina merret vesh për IPAP e vet të dytë me NATO-n.</p> <p>2012 – Në maj, në Samitin e Çikagos të NATO-s, udhëheqësit aleatë e mirëpresin marrëveshjen politike të arritur në Bosnje e Hercegovinë më 9 mars 2012 për regjistrimin e Pronës së patundshme mbrojtëse si pronë shtetërore. Ata i nxisin udhëheqësit politikë për ta zbatuar marrëveshjen pa vonim për t'i mundësuar vendit fillimin e pjesëmarrjes në Planin Aksional për Anëtarësi.</p>	<p>mesin e tetorit.</p> <p>2008 – Në prill 2008, Kroacia ftohet për t'i filluar bisedimet e hyrjes në Aleancë.</p> <p>Aleatët e NATO-s i nënshkruajnë protokolet për hyrjen e Kroacisë në Traktatin Veri-Atlantik më 9 korrik 2008.</p> <p>2009 – Më 1 prill 2009 Kroacia hyn në Aleancë.</p>	<p>Operational Capability) për FSK-në. FOC don të thotë që NATO-ja e konsideron FSK-në plotësisht të aftë për t'i kryer detyrat dhe misionet e përcaktuara në pajtim me standardet e parashtruara nga NATO.</p> <p>Shpallja e FOC nuk do ta ndikojë misionin e FSK-së; detyrat e FSK-së do të vazhdojnë t'i përfshijnë operacionet e gjurmimit dhe shpëtimit; heqjen e pajisjeve shpërthyes; kontrollimin dhe spastrimin e materialeve të rrezikshme; zjarrfikjen dhe detyrat e tjera të asistencës humanitare.</p>			<p>Komandës Aleate për Tranformim të Partnerëve Strategjikë Ushtarakë, një nga ngjarjet më të mëdha të partneritetit të NATO-s që mbahet çdo vjet.</p> <p>2012 – Në një takim të Këshillit të Partneritetit Euro Atlantik më 11 dhjetor, ambasadorët e mbajnë një minutë heshtje në kujtim të Ambasadorit Serb në NATO, Branislav Milinkovic, që kishte vdekur një javë më parë.</p> <p>2013 – Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen e mirëpret Marrëveshjen Beograd Prishtinë për Normalizim, më 19 prill, duke i përgëzuar të gjitha palët për qasjen e tyre konstruktive në gjetjen e një zgjidhjeje të qendrueshme përmes bisedave të ndërmjetësuar nga UE. Ai thekson që NATO do të vazhdojë ta garantojë një mjedis të sigurt dhe të mbrojtur në të tërë Kosovën, dhe qëndron e gatshme për ta përkrahur implementimin e kësaj marrëveshjeje të fundit.</p> <p>Në qershor, Këshilli Veri Atlantik e pranon ofertën e Serbisë që Qendrën e vet për Trajnim Kimik, Biologjik, Radiologjik dhe Bërthamor (CBRN) në Kushevac ta bëjë një Qendër të Partneritetit për Trajnim dhe Edukim, duke i hapur aktivitetet e veta ndaj Aleatëve dhe partnerëve.</p>
--	--	---	---	--	--	---

4. Dilemat e sigurisë dhe sfidat e mbrojtjes të Kosovës

4.1. Hyrje

Më tepër se gjashtë vjet pas Shpalljes së Pavarësisë, Kosova përballet me dy sfida kryesore të sigurisë: me atë të mungesës së sigurisë politike për shkak të integritit të papërfunduar në bashkësinë ndërkombëtare, që e përfshin anëtarësinë në organizatat kyçe ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara dhe OSBE, si dhe rrugët e bllokuara drejt integritimeve euro-atlantike, dhe me atë të konflikteve rreth shtetësisë së vet që i ka me Serbinë.

Në marrëdhëniet ndërkombëtare, Kosova është duke i jetuar dy realitete, realitetin e një entiteti të pavarur, dhe atë të një shteti sovran. Kjo, nga njëra anë, trajtohet si entitet i pavarur në marrëdhëniet me institucionet euro-atlantike dhe me shumicën e shteteve që nuk e kanë njohur, në të njëjtën kohë kur Serbia atë e trajton, edhe si një territor të veçuar që udhëhiqet nga Rezoluta 1244 e KS KB, edhe si pjesë të veten. Nga ana tjetër, si shtet sovran Kosova trajtohet vetëm në nivelin bilateral, nga shtetet që e kanë njohur pavarësinë e saj.

Ashtu siç u përmend në kapitujt e mëparshëm, me përjashtim të Serbisë, Kosova nuk përballet me ndonjë kërcënim të drejtpërdrejtë të sigurisë apo ushtarak nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Prandaj, siguria ushtarake e Kosovës mbetet në masë shumë të madhe e varur nga prania e NATO-s. Pos kësaj, në qoftë se vie deri te tërheqja e KFOR-it në rrethanat e anëtarësisë në KB, atëherë, në rast të ndonjë konflikti të armatosur me Serbinë, mbrojtja e Kosovës nga e drejta ndërkombëtare do të jetë tejet e cenueshme. Për më tepër, në një situatë të tillë, shikuar nga perspektiva e tashme, përfundimi i Misionit të KFOR-it të NATO-s do të mbetet peng i marrëdhënieve të pazgjdhura midis Prishtinës dhe Beogradit, dhe atë posaçërisht për shkak të mungesës së ndonjë perspektive të Kosovës për t'iu bashkangjitur PFP-së dhe për ta siguruar anëtarësinë në Aleancë.

Për më tepër, pavarësisht nga ajo që është anëtare e Partneritetit për Paqe dhe që ka aspirata për t'iu bashkangjitur Unionit Evropian, "neutraliteti ushtarak" që e pretendon Serbia nuk ka ngjashmëri me neutralitetin e shteteve anëtare të UE-së, si Suedia dhe Finlanda. Serbia është e vetmja shfrytëzuese falas e sigurisë në rajon që është duke e forcuar bashkëpunimin ushtarak me Rusinë, në të njëjtën kohë kur Perëndimi është në drejtimin e një përplasjeje të fuqishme me Kremlinin. Ky bashkëpunim mund të ketë pasoja të rënda për sigurinë, edhe të Kosovës, edhe të rajonit, posaçërisht nëse Serbia dhe Rusia ndërmarrin bashkarisht hapa në drejtimin e gabuar.

Për të përmbledhur, i vetmi kërcënim për Kosovën përftohet nga politikat armiqësore të Serbisë në fushën mbrojtëse dhe të sigurisë, që forcave të saj ushtarake ua japin drejtimin politik. Prandaj, është e vështirë për t'u besuar që Beogradi nuk ka planifikimin ushtarak për situata të paparashikuara kundër Kosovës. Në të vërtetë, është e qartë që Kosova, as që paraqet, qoftë tash, qoftë në ndonjë të ardhme të parashikueshme, ndonjë kërcënim ushtarak për Serbinë, pavarësisht nga "sigurizimi" i kësaj çështjeje inekzistente nga Beogradi, gjë kjo që, në thelb, është pasojë e mungesës së gatishmërisë së Beogradit për ta njohur shtetësinë e Kosovës. Pos kësaj të tërës, dialogu Prishtinë–Beograd, i ndihmuar nga Brukseli, nuk i ka prekur masat për ndërtimin e besimit midis dy vendeve në çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes. Arritja e një normalizimi domethënës të marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë, që do të shkonte madje edhe deri te njohja e ndërsjellë, është e paparamendueshme pa adresimin e konfrontimit të tashëm doktrinar midis dy vendeve si dhe pa lëvizjen e tyre drejt bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes.

4.2. Dilema Serbe e sigurisë e Kosovës

Dilemën e sigurisë së Kosovës lidhur me Serbinë e shkaktojnë synimet armiqësore politike të Beogradit, jo aftësitë e tij ushtarake. Kosova, nga njëra anë, Serbinë zyrtarisht nuk e përcakton me armiqësi, dhe, nga tjetra, kjo as që ka potencial për të ndërtuar çfarëdo kapacitetesh kërcënuese ushtarake. Megjithatë, me fuqinë e vet ushtarake, Serbia mund ta dëmtojë Kosovën në një mënyrë të vrazhdë, nëse zgjedh që ta sulmojë atë, ndërkohë që, Kosova, me forcat konvencionale që i posedon, nuk mund ta mbrojë efektivisht integritetin dhe sovranitetin e vet territorial. Mirëpo, këtu duhet vërejtur atë që Presidenti serb Nikoliq e ka përjashtuar mundësinë e luftës përderisa ai ta ushtrojë detyrën e vet, veçse ai po ashtu e bëri të ditur që lufta nuk përjashtohet si mundësi në të ardhmen, nëse qytetarët e Serbisë e marrin këtë vendim, duke e zgjedhur ndonjë udhëheqës "që do të riblente armë, në vend se të ndërtojë shtëpia."⁸⁰

Prandaj, çështja kyçe, përgjigja në të cilën është pothuaj e pamundur, është ajo se sa interes do të mund të kishte Serbia për ta përdorur forcën kundër Kosovës, në rrethana ndërkombëtare që nga këndvështrimi i tashëm mund të duken të pamundshme, por që në të ardhmen mund të dalin si të favorshme. Nëse ky interes i Serbisë del të jetë i lartë, atëherë ajo duhet ta mobilizojë qeverisjen e vet për ta hyrë rrezikut të luftës, ashtu që të mos përballlet me opozitë politike. Politikat aktuale zyrtare të sigurisë dhe të mbrojtjes së Serbisë nuk e përjashtojnë ndonjë mundësi të tillë, mirëpo, është e vështirë të vlerësohet aftësia për mobilizimin politik të

⁸⁰ Nikolic: 'Dok sam ja Predsednik, Srbija nece ratovati,' Srbija Danas, 28 qershor, 2014, <http://www.srbijadanas.com/clanak/nikolic-dok-sam-ja-predsednik-srbija-nece-ratovati-28-06-2014>

qeverisë për rikthimin e dhunshëm të Kosovës në kuadrin e sovranitetit të saj. Një çështje tjetër e rëndësishme është ajo e llojit të strategjisë që Beogradi do ta shfrytëzonte në sulmin kundër Kosovës: sulmi konvencional,⁸¹ barbaria,⁸² apo ndonjë kombinim të tyre. Sidoqoftë, çfarëdo që të jenë rrethanat e dhëna, gjasat janë shumë të mëdha që Serbia nuk do të ndërmerr kurfarë sulmi kundër Kosovës pa një përkrahje të fuqishme ruse, dhe/ose pa ndonjë përçarje të qartë brenda NATO-s dhe UE-së, ngjashëm me strategjinë që Millosheviqi e zbatoi gjatë viteve 1990.

Nëse Serbia si strategji ushtarake e zgjedh sulmin konvencional, atëherë gjasat janë të mëdha që qëllim politik do të jetë aneksimi i Veriut të Kosovës, meqë në pjesën tjetër të vendit Serbia do ta ketë të pamundur t'i fitojë "shpirtrat dhe mendjet" e popullatës shqiptare. Nuk ka dyshim që Serbia do ta fitojë këtë luftë të kufizuar, duke e patur parasysh disbalancin e plotë të aftësive ushtarake të Kosovës për mbrojtjen konvencionale të territorit të vet. Për më tepër, për shkak të asaj që kjo pjesë e territorit të Kosovës banohet kryesisht nga pjesëtarët e komunitetit serb, Prishtina nuk do ta ketë mundësinë e organizimit të ndonjë lufte guerile për zbrapsjen e pushtimit të kufizuar nga ana e Serbisë.

Nga ana tjetër, nëse si strategji sulmuese ushtarake zgjedhet barbaria, atëherë qëllimi politik i Serbisë do të jetë i njëjtë me atë që Millosheviqi e kishte gjatë luftës 1998-1999: pushtimi i pjesës më të madhe të territorit të Kosovës, së bashku me shpopullimin e tij nga shumica shqiptare. Në këtë rast, strategjia e Kosovës kundër sulmit të Serbisë, sipas të gjitha gjasave, do të jetë lufta guerile e kombinuar me forca konvencionale.

Së fundi, nëse Beogradi i shfrytëzon të dyja strategjitë, atëherë qëllimi politik i tij do të mund të jetë pushtimi i pjesës Veriore dhe Qendrore të Kosovës, shpopullimi i shqiptarëve nga këto

⁸¹ Shih shpjegimin e termit në: Ivan Arreguin-Toft, *How the Weak Win Wars: A Theory of Asymmetric Conflict*, Cambridge University Press, 2005, fq. 30-31: "Sulmi konvencional don të thotë shfrytëzim i forcave të armatosura për t'i zënë rob apo shkatërruar forcat e armatosura të armikut, duke e fituar në këtë mënyrë kontrollimin e vlerave të kundërshtarit (popullata, territori, qytetet, apo qendrat jetike industriale dhe komunikuese). Qëllimi është të fitohet lufta me një angazhim vendimtar, apo me një varg angazhimesh të tilla, duke e shkatërruar aftësinë psikike të kundërshtarit për të kundërshtuar. Në modelin më të shpeshtë të një strategjie të sulmit konvencional, forcat e sulmuesit përparojnë për t'i zënë vlerat apo pasuritë strategjike të mbrojtësit – të themi, kryeqytetin, qendrën industriale apo komunikuese, apo ndonjë urë a fortesë – ndërkaq, mbrojtësi vepron për t'i zbrapsur këto përpjekje. Rrjedhimisht, do të pasojë një betejë, apo një varg betejash, dhe këto, nganjëherë shënohen me qetësime që mund të zgjasin për sezona të tëra, përderisa njëra palë të mos e pranojë disfatën."

⁸² *Ibid*: fq. 31. "Barbaria është dëmtim i paramenduar dhe sistematik i jo-luftëtarëve (p.sh., dhunimet, vrasjet dhe torturat), në ndjekje për përmbytjen e ndonjë qëllimi ushtarak apo politik. Për dallim nga strategjitë e tjera, barbaria shfrytëzohet për të goditur edhe vullnetin e kundërshtarit, edhe aftësinë e tij për të luftuar. Në një fushatë strategjike bombarduese, për shembull, kur qëllim është të goditet vullneti i kundërshtarit, aktori i fuqishëm përpiqet ta detyrojë kundërshtarin e vet më të dobët që ta ndryshojë sjelljen e vet duke i shkakuar atij dhimbje (përmes shkatërrimit të vlerave të tij). Në një fushatë kundër-rebeluese (COIN – Counter Insurgency), kur shënjestër është vullneti, aktori i fuqishëm mund të përpiqet t'i përmbajë ata që do të mund të bëheshin kryengritës përmes, të themi, një politike të reprezaljeve kundër jo-luftëtarëve. Mirëpo, aktorët e fuqishëm në një kundër-rebelim mund ta marrin në shënjestër, po ashtu, edhe aftësinë fizike të aktorit të dobët për ta përballuar rezistencën, përmes, për shembull, politikës së krijimit të kampeve të përqendrimit. Historikisht, format më të shpeshta të barbarisë janë vrasja e jo-luftëtarëve apo civilëve gjatë operacioneve luftarake, kampet e përqendrimit, dhe, që nga viti 1939, bombardimi i caqeve që kanë fare pak apo aspak vlerë ushtarake."

territore, dhe krijimi i “tampon zonës së shkatërruar” në pjesën tjetër të vendit. Përgjigja e autoriteteve të Kosovës, sipas të gjitha gjasave, do të jetë një kombinim i mbrojtjes konvencionale⁸³ me atë guerile.⁸⁴

Nëse ndonjë nga këto mundësi të Serbisë zbatohet në të ardhmen, testi kyç për Kosovën do të jetë trajtimi i komunitetit serb në jug të Ibrit. Nëse autoritetet kosovare vendosin ta bëjnë dallimin midis Serbisë dhe anëtarëve të komunitetit serb në Kosovë, atëherë gjasa për ta fituar përkrahjen e NATO-s dhe përfshirjen e saj gjithsesi do të jenë më të mëdha. Çfarëdo që të jenë mundësitë strategjike që Serbia mund t’i shfrytëzojë nëse vendos ta sulmojë Kosovën, përpos ofensivës konvencionale për aneksimin e territorit në veri të Ibrit, vështirë që këto do të mund ta përcaktojnë fituesin e luftës. Për më tepër, pavarësisht nga tipi i strategjive ofensive dhe defansive që do të shfrytëzohen nga Serbia dhe Kosova, në një konflikt të stërzgjatur, sipas të gjitha gjasave, që të dyjat do ta kenë të përbashkët, pak a shumë, një cenueshmëri të njëjtë të brendshme dhe të jashtme politike.

Prandaj, çfarëdo konflikti i madh i armatosur midis Serbisë dhe Kosovës, sipas të gjitha gjasave do ta krijojë paradoksin e balancit të forcave, që në një mënyrë të mrekullueshme e ka perceptuar James J. Writz: “tendencën e shpërthimit të luftës gjatë konfrontimeve midis shteteve të dobëta dhe atyre të fuqishme – luftra këto që shtetet e fuqishme duhet të përpiqen t’i shmangin dhe që shtetet e dobëta realisht nuk mund të presin se do t’i fitojnë.”⁸⁵ Fuqia e dobët – në këtë rast, Kosova – nuk do ta pranojë pushtimin si akt të kryer, dhe kjo mund të hyjë në konfrontimin e armatosur me kundërshtarin shumë më të fuqishëm – domethënë, me Serbinë – për shkak të supozimit të saj që fuqia shumë më e madhe (Serbia) nuk do të jetë në

⁸³ *Ibid*: Mbrojtja konvencionale është shfrytëzim i forcave të armatosura për t’i zbrapsur përpjekjet e kundërshtarit për zënien apo shkatërrimin e vlerave, të tilla si territori, popullata dhe resurset strategjike. Si edhe strategjitë e sulmit konvencional, këto i marrin në shenjë forcat e armatosura të kundërshtarit. Synim këtu është dëmtimi i aftësive fizike të kundërshtarit përmes sulmit dhe shkatërrimit të forcave të tij avancuese dhe të afërta. Shembujt i përfshijnë shumicën e strategjive me synime të kufizuara, mbrojtjen statike, mbrojtjen e avancuar, mbrojtjen në thellësi, dhe mbrojtjen mobile.

⁸⁴ Strategjia e luftës guerile (G#S – Guerilla #arfare Strategy) është organizim i një pjese të një shoqërie me qëllim që kundërshtarit t’i imponohen kosto, përmes shfrytëzimit të forcave të armatosura të ushtruara për t’i shmangur konfrontimet e drejtpërdrejta. Këto kosto përfshijnë humbjen e ushtarëve, të furnizimeve, të infrastrukturës, të qetësisë mendore, dhe, më e rëndësishmja, të kohës. Edhe pse G#S i merr në shënjestër kryesisht forcat e armatosura kundërshtare dhe resurset e tyre përkrahëse, qëllimi i tyre nuk është shkatërrimi i aftësisë, por i vullnetit të sulmuesit. G#S ka nevojë për dy elemente thelbësore: (1) strehat (fizike, p.sh. moçalet, malet, pyjet e dendura, apo xhunglat – dhe politike, p.sh., zonat kufitare me rregullim të dobët të kontrolluara nga shtete dashamirëse), dhe (2) popullatën përkrahëse (për t’u ofruar luftëtarëve inteligjencë, furnizime dhe zëvendësime). G#S nuk është strategji për arritjen e mposhtjes së shpejtë të forcave kundërshtare. Për më tepër, meqë guerilat nuk mund të mbajnë apo të mbrojnë zona të veçanta (pos zonave të izoluar për baza), këto nuk ofrojnë siguri për familjet e tyre në kohën kur janë në operacione, apo të demobilizuara, në pritje të detyrave të reja. Për këtë arsye G#S është një strategji që vlerat kyçe (p.sh., feramat, familjet, vendet fetare apo kulturore, dhe qytetet) i vë drejt e në duart e kundërshtarit. Atëherë, logjikisht, kostot më të rëndësishme të përvetësimit të G#S varen nga qëllimi dhe vetëpërmbytja e kundërshtarit. Kur forcat pushtuese nuk tregojnë ndonjë vetëpërmbytje gjatë ushtrimit të forcës, apo kur objektivi i tyre politik është shkatërrimi, dhe jo nënshtrimi i popullit të aktorit të dobët, G#S mund të shndërrohet në strategji mbrojtëse që kushon për së tepërmi shumë.

⁸⁵ James J. #ritz, Balance of Power Paradox, Balance of Power: Theory and Practice in the 21st Century, Stanford University Press, Stanford, California, 2004, fq.128.

gjendje t'i shpërndajë të gjitha forcat e veta në konflikt, dhe, po ashtu, edhe për shkak të kufizimeve që i imponohen nga bilanci i forcave, si rreziku që ndonjë fuqi tjetër shumë më e madhe (SHBA-të apo NATO-ja) do të hyjë në konflikt si aleat i fuqisë së dobët.⁸⁶ Shteti i fuqishëm – në këtë rast Serbia – mund të synojë të përqendrohet në mosbalancin e fuqive midis vetes dhe kundërshtarit të dobët – Kosovës – por kjo mund të mos ia dalë të kuptojë atë që kundërshtari i dobët mund të perceptojë shkaqe për vetëbesim që janë përtej efektit strategjik të paradoksit të balancit të fuqive, gjë kjo që të dyja palët i bënë të jenë tejet të prirura për t'i hyrë rrezikut.⁸⁷

Supozimet e përmendura më sipër të paradoksit të balancit të fuqive janë të zbatueshme me ose pa angazhimin e fuqive të tjera në konflikt si aleate të Prishtinës. Serbia, praktikisht, nuk mund t'i lejojë vetes asnjë herë që të gjitha forcat ushtarake që aktualisht i ka në dispozicion t'i pozicionojë në Kosovë, gjë kjo që mundësinë e pushtimit dhe të mbajtjes së përhershme të të tërë territorit të Kosovës, apo të pjesës më të madhe të tij, e bënë të pamundshme.

Sidoqoftë, në realitet, politikat dhe synimet armiqësore kundër Prishtinës në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, bëjnë që forcat tokësore të Beogradit, të ndërtuara rreth katër brigadave të kombinuara të blinduara, dhe të përkrahura nga një njësi e aviacionit ushtarak,⁸⁸ të jenë kërcënimi më serioz ushtarak ndaj Kosovës. Nga ana tjetër, edhe përkundrejt disparitetit shumë të madh në aftësitë ushtarake, forcat ushtarake të Serbisë në realitet mund të jenë të efektshme vetëm në një intervenim të kufizuar, që mund të jetë, ose i pastër konvencional, ose i përzier, në trajtë të aneksimit të territorit në veri të Ibrit, dhe të sulmit në pjesën tjetër të Kosovës.

Së fundi, balancimi i fortë i Kosovës kundër Serbisë nuk është mundësi që ekonomikisht dhe ushtarakisht është racionale, dhe që do ta siguronte mbrojtjen e saj të suksesshme dhe përmbajtjen e synimeve të mundshme ofensive të Beogradit. Prandaj, vetëm normalizimi i marrëdhënieve të mbrojtjes midis Prishtinës dhe Beogradit, së bashku me anëtarësimin e Kosovës në PfP, do ta hapin rrugën për një largim të KFOR-it që do të lente pas vetes stabilitet dhe siguri për Kosovën, Serbinë, dhe të tërë rajonin.

⁸⁶ *Ibid.*

⁸⁷ *Ibid.*, fq. 129.

⁸⁸ The Military Balance 2014, International Institute for Strategic Studies, London, janar 2014, fq. 132-133.

4.3. Rruga përpara marrëdhënieve mbrojtëse Kosovë–Serbi: Nga “Sulmi doktrinar” në bashkëpunimin mbrojtës

Në pajtim me politikën e vet të mosnjohjes, Serbia Kosovën e ka projektuar si kërcënimin kryesor të sigurisë në pothuaj të gjitha aspektet, përfshirë këtu edhe atë ushtarak. Nga ana tjetër, Kosova formalisht – por, po ashtu, edhe jorealisht – ka vendosur që Serbinë të mos e konsiderojë si të tillë. Kjo zgjedhje politike e Kosovës mund të ketë qenë rezultat i: (a) mendimit të udhëhequr nga dëshirat, (b) mbrojtjes së ofruar nga KFOR/NATO, që e zhdoktrin frikën ekzistuese, apo (c) sygjërimeve të dhëna nga disa nga qeveritë perëndimore që e përkrahin shndërrimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në Forcat e Armatosura të Kosovës (FAK). Mirëpo, kjo zgjedhje nuk e zgjidh këtë problem vetvetiu, pavarësisht nga “detanti i brishtë” midis Kosovës dhe Serbisë, që është rezultat i dialogut të ndihmuar nga Unioni Evropian. Prandaj, do të mund të vinim në përfundimin që marrëdhëniet mbrojtëse Kosovë-Serbi janë joekzistente, dhe që këto, në thelb, janë në shkallën e “sulmit doktrinar,” nga ana e Beogradit, dhe të mosreagimit politik, nga ana e Prishtinës.

Kosova si shtet i pavarur dhe sovran ka të drejtë të plotë për t’i patur forcat e veta të armatosura. Megjithatë, pavarësisht nga ajo që transformimi i FSK-së në FAK është inicuar nga Qeveria e Kosovës, Kuvendi i Kosovës nuk i ka bërë ndryshimet e domosdoshme kushtetuese për formalizimin e kësaj ambicijeje. Ndryshimet përkatëse të Kushtetutës së Kosovës varen nga përkrahja e komuniteteve minoritare të përfaqësuar në Kuvend, përfshirë këtu edhe shumicën e kualifikuar të përfaqësuesve të komunitetit serb. Është vështirë e besueshme që përfaqësuesit e komunitetit serb do të votojnë për ndryshime të tilla kushtetuese pa përkrahje nga Serbia. Kësisoj, formalizimi i transformimit të FSK-së në FAK, në realitet, mbetet peng i gatishmërisë së Beogradit për ta miratuar këtë transformim.

Përfshirja e pjesëtarëve të komunitetit serb në Forcën e Sigurisë të Kosovës nuk është, as sukses, dhe as dështim. Edhe përkundrajt asaj që Forca e Sigurisë së Kosovës pothuaj se e ka përmbushur kuotën për komunitetet pakicë,⁸⁹ numri i oficerëve nga komuniteti serb mbetet tejet i ulët (1,83%),⁹⁰ kryesisht për shkak të kundërshtimit dhe ndikimit negativ të Beogradit. Sidoqoftë, pavarësisht nga ajo që njëri nga postet e Zëvendësministrit të Forcës së Sigurisë së Kosovës i takon përfaqësuesit politik të komunitetit serb,⁹¹ nuk ka kurfarë justifikimi për atë që

⁸⁹ Raporti Vjetor 2013 i Ministrisë së Sigurisë së Kosovës, http://www.mkssf-ks.org/repository/docs/RAPORTI_VJETOR_2013_i_publicuar_23_12_2013_shqip.pdf, 14 janar, 2014.

⁹⁰ Donika Emini, “Inclusion or Exclusion? Minorities in the Security Sector in Post-Independence Kosovo”, Kosovo Center for Security Studies, http://www.qkss.org/repository/docs/Inclusion_or_Exclusion_Minorities_In_The_Security_Sector_In_PostIndependent_Kosovo_223772.pdf, mars 2014, fq.17.

⁹¹ Zëvendës Ministër i tashëm i Forcës së Sigurisë të Kosovës është zonja Jasmina Vasiq, Raporti Vjetor 2013 i Ministrisë së Sigurisë së Kosovës,

grada më e lartë e një oficeri serb në FSK është ajo e oficerit në krijim.⁹² Kjo çështje duhet të adresohet seriozisht nga forcat e ardhshme të armatosura të Kosovës. Një model i dobishëm që mund të shfrytëzohet këtu është praktika maqedone e kohëve të fundit, ku, qoftë pozita e Ministrit të Mbrojtjes, qoftë ajo e Komandantit të Gjeneralstabit i takon komunitetit shqiptar. Po ashtu, paraqitja e veshjeve ceremoniale të FSK-së, të bazuara në veshjet kombëtare shqiptare,⁹³ në vetë thelbin e vet është kundër frymës së Kushtetutës dhe të karakterit multi-etnik të Kosovës, dhe kjo, në një trajtë simbolike, e nxjerr në shesh mungesën e vizionit dhe/ose të gatshmërisë për të ecur përpara, të udhëheqësisë së saj. Për më tepër, ky veprim popullist i rrezikon marrëdhëniet me NATO-n dhe me përkrahësit e transformimit të FSK-së në FAK, dhe i tjetëron edhe më shumë pjesëtarët e komunitetit serb, pa e përmendur ndikimin e madh që e ka në forcimin e armiqësisë së Serbisë lidhur me krijimin e Forcave të Armatosura të Kosovës.

Shkaku kryesor i kundërshtimit të Serbisë për krijimin e forcave të armatosura të Kosovës, dhe i përpjekjeve të saj për ta “sigurizuar” Kosovën si një kërcënim të ngurtësuar, qëndron në zhdukjen graduale të shpresave të saj për një dështim të mundshëm të shtetësisë së Kosovës, si dhe në mbajtjen e partneritetit strategjik me Rusinë, duke ua dhënë një strofull interesave energjetike dhe ushtarake të Moskës në Ballkan. Sido që kjo të jetë, Serbia, në instancë të fundit, do të duhet ta bëjë zgjedhjen midis Brukselit dhe Moskës, dhe kjo zgjedhje gjithsesi do ta ketë çmimin e vet.

Edhe pse në shikim të parë kjo mund të duket paradoksale, konsolidimi i arkitekturës së sigurisë së Kosovës, në thelb të vetin është në interesin e Serbisë. Së pari, meqë kjo do ta hapë rrugën që Kosova të ndërtojë marrëdhënie partneriteti me NATO-n, gjë kjo që, më tutje, do ta mundësojë zhvillimin e FAK nën udhëheqjen e Aleancës. Si një vend që aspiron anëtarësimin në Aleancë, Kosova në këtë mënyrë nuk do të ketë madje as gjasa teorike për ta ndërtuar ndonjë ushtri kërcënuese, apo për të ndërmarrë çfarëdo veprimesh armiqësore kundër Beogradit. Së dyti, pjesëmarrja e serbëve lokalë në forcat e armatosura multi-etnike të Kosovës do ta krijojë besimin e pjesëtarëve të komunitetit serb në këto forca, që do të jetë i ngjashëm me atë që ata e kanë ndaj Policisë së Kosovës – dhe kjo në mesin e tyre gëzon një mirëbesim të konsiderueshëm.⁹⁴ Po ashtu, oficerët e komunitetit serb do të duhen të marrin pjesë në planifikimin mbrojtës, dhe është e paparamendueshme që ata do të pajtohen me çfarëdo planifikimi, apo që do të binden për të zbatuar çfarëdo urdhërash, në rast se këto do të jenë

http://www.mksf-ks.org/repository/docs/RAPORTI_VJETOR_2013_i_publicuar_23_12_2013_shqip.pdf, 14 janar, 2014, fq. 4.

⁹² Intervistë e KIPRED-it me KFOR-in Francez, gusht 2014.

⁹³ FSK-ja, me uniformë tradicionale, <http://www.zeri.info/artikulli/41876/fskja-me-uniforme-tradicionale-foto>, 15 korrik, 2014.

⁹⁴ Policia e Kosovës e gëzon besimin e 27,9% të pjesëtarëve të komunitetit serb, ndërkohë që me punën e Forcës së Sigurisë së Kosovës këta, ose nuk janë të kënaqur (25%), ose nuk kanë kurrfarë opinioni (61,60%). Donika Emini, “Inclusion or Exclusion? Minorities in the Security Sector in Post-Independence Kosovo”, Kosovo Center for Security Studies, http://www.qkss.org/repository/docs/Inclusion_or_Exclusion_Minorities_In_The_Security_Sector_In_PostIndependent_Kosovo_223772.pdf, mars 2014, fq. 20-21.

armiqësore ndaj Serbisë. Dhe, së treti, përmes bashkëpunimit mbrojtës me Kosovën, Serbia, si anëtare e Pfp-së, dhe si një vend që aspiron të integrohet në mekanizmat e Politikës Evropiane të Sigurisë dhe të Mbrojtjes, mund ta japë kontributin e vet për përmbylljen e kapitullit të fundit të pambyllur të sigurisë dhe të stabilitetit në Ballkanin Perëndimor. Ky bashkëpunim do t'i ndihmojë rajonit për të evoluuar në drejtimin e një komuniteti të sigurisë, të ngjashëm me atë të vendeve nordike, që i bën bashkë NATO-n dhe shtetet anëtare neutrale të Pfp-së.

Kësisoj, hapja e dialogut midis Kosovës dhe Serbisë lidhur me masat për ndërtimin e besimit mbrojtës, është një hap i domosdoshëm drejt normalizimit të plotë të marrëdhënieve midis dy vendeve. Veçse, këtij dialogu mund t'i nevojitet ndryshimi i formatit të tashëm të ndihmës nga Unioni Evropian. Përfshirja e NATO-s, si një organizatë që është sipërore në çështjet e sigurisë, është instrumentale për jetësimin e çfarëdo marrëveshjeje që do të arrihet midis Prishtinës dhe Beogradit. Prandaj, për shkak të rëndësisë që e ka dhe për shkak të interesave të larta, ky dialog duhet të udhëhiqet bashkarisht nga Përfaqësuesi i Lartë i CFSP-së të UE-së, dhe nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s.

Ky dialog është i domosdoshëm për t'i adresuar modalitetet lidhur me masat për ndërtimin e besimit midis dy vendeve, që mund të mbështeten në modelin e OSBE-së për Ndërtimin e Masave për Besim dhe Siguri,⁹⁵ dhe posaçërisht në ato për Reduktimin e Rrezikut,⁹⁶ për Njoftimin Paraprak të Veprimtarive të Caktuara Ushtarake, si dhe për Vëzhgimin e Veprimtarive të Caktuara Ushtarake. Duke e marrë parasysh atë që NATO-ja është e pranishme edhe në Kosovë (KFOR-i, Ekipi Ndërlidhës dhe Këshillues i NATO-s, dhe Ekipi Këshillues i NATO-s), edhe në Serbi (Zyra Ushtarake Ndërlidhëse e NATO-s në Beograd), si dhe atë që Kosova nuk është anëtare e OSBE-së, nuk ka kurrfarë dyshimi që NATO-ja është organizata më e përshtatshme për t'i ndihmuar arranzhimet e tilla midis Prishtinës dhe Beogradit.

Edhe një çështje tjetër e një rëndësie të lartë që duhet adresuar në këtë dialog është ajo e bazave ushtarake të Serbisë dhe të Kosovës. Demilitarizimi i njëkohësishëm i Veriut të Kosovës dhe i Luginës së Preshevës nga forcat e armatosura të të dyja palëve, përderisa Kosova të mos e merr nga NATO-ja Planin Aksional për Anëtarësim, dhe përderisa Serbia të mos bëhet anëtare e UE-së, është një tjetër masë e domosdoshme për ndërtimin e besimit. Pasi të ndërmerren nga të dyja vendet, këto masa do t'u ofrojnë të dyjave sigurinë që vendi tjetër nuk do t'i shfrytëzojë kërcënimet ushtarake si mjet për zgjidhjen e mospajtimit të mundshme midis tyre, dhe ky do

⁹⁵ Vienna Document 2011 on Confidence and Security-Building Measures, Organization for Security and Cooperation in Europe, FSC.COC/1/11, Vjenë, 30 nëntor, 2011.

⁹⁶ *Ibid*, Risk Reduction Section: Mechanism for Consultation and Cooperation as regards unusual Military Activities, Cooperation as regards Hazardous Incident of a Military Nature, dhe Voluntary Hosting to Dispel Concerns about Military Activities, fq. 12-14.

të jetë hapi i parë dhe më thelbësor drejt një rënieje përmbajtësore të frikës në mesin e minoritetit serb në Veriun e Kosovës, dhe të minoritetit shqiptar në Serbi.

Dhe, së fundi, një komponentë tejet e rëndësishme e dialogut, që duhet të adresohet në një paket të vetëm, është ajo për ndryshimin e politikave të sigurisë dhe të mbrojtjes së Beogradit – të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë dhe të Strategjisë së Mbrojtjes – pastaj për përfaqësimin e pjesëtarëve të komunitetit serb në forcat e ardhshme të armatosura të Kosovës, si dhe për anëtarësinë e plotë të Kosovës në Ministrorin Mbrojtës të Evropës Juglindore. Adresimi i këtyre çështjeve në një paket të vetëm, mosbesimin dhe armiqësitë e tashme do t'i shndërrojë në një detant, që do t'i hapë rrugë bashkëpunimit dhe partneritetit të ardhshëm midis dy vendeve në çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes.

4.4. Çfarë tjetër: Ndërtimi i bashkëpunimit zyrtar të NATO-s me Kosovën

Pothuaj shtatë vjet pas Shpalljes së Pavarësisë, dhe pesëmbëdhjetë vjet pas fillimit të misionit paqeruajtës të NATO-s, Kosova mbetet i vetmi vend në zonën më të gjerë euro-atlantike që nuk ka bashkëpunim zyrtar me Aleancën. Ndërkohë që Unioni Evropian ia ka dalë të ndërtojë marrëdhënie kontraktuale me Kosovën,⁹⁷ pavarësisht nga mosnjohja e saj nga pesë vende anëtare të tij,⁹⁸ NATO-ja nuk e ka bërë madje as edhe një hap të vetëm formal në këtë drejtim.

Edhe përkundrejt aspiratave të fuqishme që i ka për t'u bashkuar me Aleancën, perspektivat e Kosovës për t'iu bashkangjitur Programit të Partneritetit për Paqe, dhe për ta marrë Planin Aksional për Anëtarësim mbeten të pasigurta, si pasojë e mosnjohjes së saj nga katër vende anëtare të NATO-s (Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja). Mirëpo, pa bashkëpunim zyrtar me NATO-n, është vështirë të paramendohet zhvillimi i mëtejshëm i arkitekturës së sigurisë dhe themelimi i forcave të armatosura, si dhe transformimi i mëpastajmë i Kosovës nga konsumuesi i sigurisë në ofruesin e saj.

Sidoqoftë, dialogu zyrtar dhe strukturor mes NATO-s dhe Kosovës nuk është i pamundur. Ministri i Jashtëm i Latvisë, Z. Edgar Rinkevics, tashmë ka treguar që “Nëse Kosova dhe vendet e NATO-s janë të gatshme për të bashkëpunuar, atëherë mund të zhvillohet një dialog strukturor dhe formal. Një shembull i mirë për këtë është dialogu strukturor i Kosovës me Unionin Evropian, dhe kjo mund të bëhet, po ashtu, edhe me NATO-n”.⁹⁹ Mirëpo, ajo se çfarë një kesi

⁹⁷ Më 27 korrik 2014, negociatorët kryesorë të UE-së dhe të Kosovës inicuan Marrëveshjen e Stabilizimit Asocimit midis UE-së dhe Kosovës në Bruksel, http://ec.europa.eu/enlargement/countries/detailed-country-information/kosovo/index_en.htm.

⁹⁸ Qiproja, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja.

⁹⁹ “Dialogu i Kosovës me NATO-n është i mundshëm,” KOHAnet, <http://koha.net/?id=27&l=23095>, 26 gusht, 2014.

“dialogu strukturor dhe formal” do të sjellë, mbetet çështje thelbësore për perspektivat e Kosovës për anëtarësim në Pfp, dhe për integrimin e saj përfundimtar në NATO.

Së pari, gjatë kohës që Kosova nuk do të jetë anëtare formale e Partneritetit për Paqe, dialogu i NATO-s me Prishtinën, kësaj duhet t’i ofrojë, edhe asistencën, edhe vlerësimin e zhvillimit të sektorit të mbrojtjes, ngjashëm me Planin Aksional për Partneritet (PAP) për Ndërtimin e Institucioneve të Mbrojtjes (DIB), që u përvetësua në Samitin e NATO-s në Stamboll (qershor 2004).¹⁰⁰ Ndërtimi i Institucioneve të Mbrojtjes i përfshin, Kontrollin Demokratik të Veprimtarive Mbrojtëse, Pjesëmarrjen Civile në Zhvillimin dhe Implementimin e Politikës së Mbrojtjes, Mbikëqyrjen Legjislative dhe Gjyqësore të Mbrojtjes, Vlerësimin e Rrezeve të Sigurisë dhe të Kërkesave të Mbrojtjes Kombëtare, Menaxhimin e Mbrojtjes, Normat Ndërkombëtare në Qeverisjen e Mbrojtjes, Menaxhimin e Personelit në Mbrojtje, Planifikimin Financiar në kuadrin e Bashkëpunimit në Mbrojtje dhe në Mbrojtjen Ndërkombëtare.¹⁰¹ Kjo kornizë për ndërtimin e institucioneve të mbrojtjes do ta sigurojë zhvillimin e një sektori demokratik dhe të qëndrueshëm të mbrojtjes së Kosovës.

Së dyti, dialogu duhet t’i përgatisë forcat e ardhshme të armatosura të Kosovës për operacione të përbashkëta me forcat e NATO-s. Modeli i Procesit të Partneritetit për Planifikim dhe Shqyrtim (PARP) ofron mekanizma të përshtatshëm për ta zhvilluar interoperabilitetin e forcave të ardhshme të armatosura të Kosovës me NATO-n, si dhe për vlerësimin e aftësive të këtyre forcave.¹⁰²

Jetësimi i suksesshëm i këtyre dy komponenteve të dialogut me NATO-n do ta përgatisë Kosovën për Planin Aksional për Anëtarësim, një herë pasi që të gjitha vendet anëtare të Aleancës ta njohin pavarësinë e saj, dhe pasi që kjo të bëhet anëtare e Partneritetit për Paqe. Ky dialog do ta jep po ashtu një sinjal të fuqishëm politik që NATO-ja derën për anëtarësimin e Kosovës e ka mirëfilli të hapur, dhe, si i tillë, ky do ta ketë një efekt shumë të madh në konditat e përgjithshme të sigurisë dhe të stabilitetit të Ballkanit Perëndimor.

Së treti, NATO-ja duhet ta merr në konsideratë hapjen e Zyres Ndërlidhëse Ushtarake në Prishtinë, në të njëjtën mënyrë siç ka hapur zyra të tilla edhe në vendet e tjera të rajonit. Ndërmarrja e këtij hapi formal është e domosdoshme, si për implementimin e dialogut të mundshëm strukturor dhe formal me Kosovën, ashtu edhe për t’i ndihmuar marrëdhëniet mbrojtëse midis Prishtinës dhe Beogradit. Ngjashëm, dhe për po të njëjtat arsye, si dhe për

¹⁰⁰ Temat e NATO-s: Partnership Action Plan on Defence Institution Building, http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_50083.htm.

¹⁰¹ Për shpjegim të mëtejshëm shih: Hari Bucur-Marcu, Essentials of Defence Institution Building, LAVAK, Vienna – Geneva, 2009.

¹⁰² Temat e NATO-s: Partnership for Peace Planning and Review Process, http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_68277.htm

përgatitjen e Kosovës për t'u bërë pjesë e Këshillit Euro-Atlantik për Partneritet, duhet mundësuar hapja e një përfaqësie ndërlidhëse të Kosovës në NATO.

Fundja, dialogu strukturor duhet të shihet vetëm si masë e përkohshme për ndërtimin e marrëdhënieve midis NATO-s dhe Kosovës. Vetëm anëtarësia e plotë në Pfp dhe në EAPC Kosovës do t'i mundësojë të bëhet pjesë e mekanizmit të bashkëpunimit për siguri dhe mbrojtje të udhëhequr nga NATO-ja. Kësisoj, Shtetet e Bashkuara së bashku me vendet e tjera anëtare të Aleancës duhen të ndërmarrin hapa guximtarë ashtu që Kosova ta arrijë, së pari anëtarësinë në Pfp, dhe, në fund, edhe në NATO, gjë kjo që do ta shënonte heqjen e vijës së fundit ndarëse në trevën evropiane, dhe që Serbinë do ta parandalonte që për veten ta ruajë rolin e shfrytëzuesit falas të sigurisë, në të njëjtën kohë kur është duke e ripërtëritur ndikimin rus në rajon.

5. Përfundimet

Sipas dokumenteve të sigurisë dhe të mbrojtjes kombëtare të vendeve të Ballkanit Perëndimor, rreziqet kyçe që mund ta destabilizojnë rajonin dhe të sjellin rishfaqje të konflikteve të armatosura, përfshirë këtu edhe reagimet konvencionale, janë kërcënimet e natyrës politike – nacionaliste/etnike dhe fetare, ato të shtet-formimit, si dhe ato të kufijve të kontestuar/të papërcaktuar. Po ashtu, një rrezik në vetvete paraqesin edhe kornizat e paqarta ligjore lidhur me përfshirjen e mundshme të forcave ushtarake të vendeve të Ballkanit Perëndimor në luftën kundër terrorizmit, për shkak të synimeve të mundshme që minoritetet të projektohen si një kërcënim i këtij lloji.

Ndryshimet gjeopolitike që ndodhën në Ballkanin Perëndimor gjatë 25 viteve të fundit krijuan qendra monopolare të serbizmit dhe të kroatizmit, dhe një shqiptarizëm bipolar, me dy qendra. Veçse, është një dallim midis kroatizmit dhe shqiptarizmit, nga njëra anë, dhe serbizmit, nga tjetra. Kroacia, Shqipëria dhe Kosova i inkurajojnë integrimet e kroatëve dhe të shqiptarëve në vendet ku ata banojnë, ndërkohë që Serbia nuk është duke e bërë të njëjtën me serbët që jetojnë jashtë saj, dhe posaçërisht me ata që jetojnë në Bosnje e Hercegovinë dhe në Kosovë. Në këto dy vende Beogradi është duke nxitur politika kundër-integruese, së bashku me një përkufizim normativ të territoreve ku minoriteti serb paraqet shumicë.

Ekzistojnë mospërputhje shumë të mëdha midis vendeve të rajonit sa u përket aftësive ushtarake dhe industrive të tyre mbrojtëse, dhe vetëm Serbia e Kroacia këto i kanë kredibile. Po ashtu, çdonjëri nga buxhetet mbrojtëse të këtyre dy vendeve është më i lartë se të gjitha buxhetet mbrojtëse të të gjitha vendeve të tjera të Ballkanit së bashku, gjë kjo që këto dy vende i bën fuqi mbizotëruese në rajon që janë të vetmet që janë në gjendje ta kundër-balancojnë njëri-tjetrin. Në një të ardhme të parashikueshme, vendet e tjera të rajonit nuk kanë kapacitete individuale për t'i dalë shoq Zagrebit dhe Beogradit. Projektimet e shpenzimeve të mbrojtjes për Kosovën janë simbolike dhe këto nuk mund t'i plotësojnë nevojat e transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forcat e Armatosura të Kosovës. Krijimi i Forcave të Armatosura të Kosovës nuk do ta ketë ndonjë ndikim domethënës në barazpeshën ushtarake rajonale, dhe si i tillë, ky nuk do të paraqesë ndonjë kërcënim ushtarak për cilindo nga fqinjët e Kosovës.

Përfshirja ushtarake e NATO-s në Ballkanin Perëndimor, si forcë prapësuese dhe stabilizuese i ka shkurajuar konfliktet ushtarake dhe e ka transformuar rajonin nga një trevë e shoqërive të dërrmuara nga lufta, me marrëdhënie fqinjësore armiqësore, në një që është relativisht stabile, vendet e të cilës i aspirojnë integrimet euro-atlantike. Sidoqoftë, përderisa të mos arrihet normalizimi i plotë i marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës, prania ushtarake e NATO-s në Kosovë do të mbetet vendimtare për stabilitetin dhe sigurinë e Ballkanit Perëndimor.

Mekanizmat e bashkëpunimit dhe të integritit të NATO-s e kanë patur një ndikim thelbësor në reformat rrënjësore të politikë-bërjeve mbrojtëse të vendeve të rajonit. Përfshirja e NATO-s i ka shkatërruar të gjitha ëndërrat që elitat politike ekstremiste të vendeve të rajonit mund t'i kenë patur menjëherë pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, për ta kthyer rajonin prapa në një gjendje të ngjashme me atë të Luftës Ballkanike të fillimit të shekullit XX. Pas kësaj, NATO e pati një ndikim vendimtar në ndryshimin e modeleve të balancimit të fortë dhe të doktrinave të ushtrive masive që bazoheshin në mbrojtje territoriale dhe në prapësim, që më pas u transformuan në ushtri profesionale, ndërkohë që në një masë domethënëse i hoqi aftësitë ofensive që këto i kishin kundër fqinjëve të tyre. Më e rëndësishmja, Partneriteti për Paqe u dha fund të gjitha shpresave për një bashkëpunim kundërbalancues bilateral apo rajonal në fushën e mbrojtjes, duke e shndërruar bashkëpunimin ekskluzivisht përmes Brukselit në një çmim të pranimit në Aleancë. Edhe përkundrejt asaj që në këtë drejtim do të mund të arrihej një përparim më i madh, çmimi strategjik i Nenit V mbetet garanti përfundimtar i stabilitetit. Kjo është ajo që Partneriteti për Paqe, pavarësisht nga ajo se si është ndërtuar dhe institucionalizuar, dështon ta ofrojë, një fakt ky që, në thelb, është dëshmuar nga aneksimi i pjesëve të territoreve të Gjeorgjisë (2008) dhe të Ukrainës (2014) nga Rusia.

Ftesat përkuese për anëtarësim që u janë bërë Shqipërisë dhe Kroacisë nga NATO-ja, dhe Shpallja e Pavarësisë së Kosovës e vitit 2008, patën ndikim thelbësor në përmbylljen e kufijve të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Anëtarësimi në NATO i shoi ambicjet e një pjese të elitave të shqiptarëve në Kosovë për t'u bashkuar me Shqipërinë, dhe të një pjese të elitave të kroatëve në Bosnje e Hercegovinë për t'u bashkuar me Kroacinë. Rasti i bashkimit gjerman i vitit 1990 e ka dhënë një precedent brenda Aleancës sa i përket bashkimit të dy vendeve të pavarura, në rastin kur njëri prej tyre është anëtar i NATO-s. Këtu së pari u desht që të gjithë anëtarët e NATO-s ta jipnin miratimin e tyre për bashkimin e Republikës Federale Gjermane me Republikën Demokratike të Gjermanisë, dhe vetëm pas kësaj Gjermaninë e Bashkuar e mirëpritën në NATO. Nëse kjo do të zbatohet për, të themi, rastin e ndonjë bashkimi hipotetik të Shqipërisë me Kosovën, atëherë për këtë do të nevojitet miratimi paraprak i të gjithë anëtarëve të NATO-s, gjë kjo që është pothuaj e pamundur të arrihet. Kjo don të thotë që bashkimi i Shqipërisë me Kosovën do të jetë i mundshëm vetëm nëse Tirana vendos që së pari të heq dorë nga anëtarësia në NATO, gjë kjo që do të ishte në kundërshtim me interesat e sigurisë të që të dyjave, edhe të Shqipërisë, edhe të Kosovës.

Kosova është e përballur me një mjedis që është i favorshëm, por, po ashtu, edhe kompleks. Fqinjët e saj të drejtpërdrejtë, Shqipëria dhe Maqedonia e përjashtojnë mundësinë e çfarëdo kërcënimi të drejtpërdrejtë që do të mund të vinte nga Kosova, ndërkohë që Mali i Zi këtë e sheh si një rrëfim të papërfunduar sa i përket stabilitetit dhe sigurisë rajonale; ndërkaq, Serbia

këtë e projekton si kërcënim të drejtpërdrejtë konvencional dhe si entitet shtetëror problematik, në vend se si fqinj me të cilin ende nuk i ka zgjidhur marrëdhëniet, dhe me të cilin e ka të përbashkët synimin e njëkohësishëm të anëtarësimit në Unionin Evropian.

